

## Një intervistë e pabotuar **KADARE:** Shkrimtari e ka një pjesë të jetës së tij pikërisht pas mbarimit të saj, domethënë në vdekje. (Ajo që në mënyrë emotive quhet pavdekësi.)

Bisedoi **Alketa Spahiu**



Kadare në Bar Juvenija: 28 janar 2024, Foto Bujar Hudhri

## Në Tiranë dhe në Paris, me dhe pa Kadarenë

Nga **Bashkim Kuçuku**  
- Kujtesë, përjetime-

Me Ismail Kadarenë, një pjesë e lexuesve shqiptarë, kanë pasur edhe komunikime dhe marrëdhënie të drejtpërdrejta: miqësi e kolegëri, takime, biseda, debate, shëtitje, foto. Sidoqoftë, me veprën letrare dhe bëmat qytetare, ai ka qenë dhe mbetet në qenien intelektuale dhe shpirtërore të shqiptarëve...

(fq. 2)

## NË PERIFERINË E ISMAILANDIT

Nga **Matteo Mandalà**

(fq. 7)

Idėja për t'i mbledhur bashkë këto studime shpjegohet qysh në titullin e vëllimit, i cili është imenduar si një homazh për shkrimtarin e madh shqiptar, në kujtim të takimeve dhe telefonatave të shpeshta që kanë shoqëruar marrëdhëniet tona personale dhe profesionale. Duke filluar nga takimet e para sporadike me raste ngjarjesh përkujtimore publike, si njëqindvjetori i vdekjes së Jeronim De Radës (1903-2003) ose akordimi i titullit *Doktor Honoris Causa* nga Universiteti i Palermos në vitin 2009, deri te takimet e shumta kryesisht private të këtyre dekadave të fundit, mbeten të pashlyeshme mbresat dhe përshtypjet që më ka lënë mprehtësia dhe thellësia e mendimit të Ismail Kadaresë. Le të vlejë ky homazh modest i një lexuesi të tij si shenjë mirënjohjeje *post mortem*.

Kadare: Duke lexuar "Milosaon", 1963

Një shkrim në formatin  
e Manifestit Letrar

Nga **Ymer Çiraku** (fq. 5)

Çështje të marrëzisë dhe Kisha  
e Shën Sofisë: vepra-alegori të  
ringjalljes së religjionit

Nga **Lili Sula** (fq. 8)

Një histori me Kadarenë  
në Paris

Nga **Roland Tasho** (fq. 9)

KODI KADARE

Nga **Roland Gjoza** (fq. 10)

### SHËNIME MBI LIBRAT

Romani i Fate Velajt

"MOSSANGA" - ROMANI  
NDRYSHE I LETËRSISË  
SHQIPE

Nga **Odise Kote** (fq. 11)

Ribotohet vepra  
e dom Nikollë Mazrrekut

Nga **Prof. dr. Tefë Topalli** (fq. 16)

Shoqata Tropoja ju fton

Takim me shkrimtarin tonë  
**BESNIK MUSTAJ**

E shtunë, 25 janar | Ora 11:00  
Hotel Tirana International

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" dhe  
Shëtitja botuese "Onufri"  
ju ftojnë në promovimin e librit

"Porosia e kullës"


nga

**PASHKO R. CAMAJ**

E diel, 26 janar | Ora 11:00  
Biblioteka e Universitetit të Vlorës  
Rruga Kasova, Vlorë

LIBRI I PARË I BOTIMEVE TRISHTIL  
**Jonathan Santlofer**  
**Misteri i fundit i  
Mona Lizës**

Përktheu **Vladimir Bica** (fq. 23)



### BIBLIOTEKË

— **Abdullah Zeneli** (fq. 14)

*Rapsodia e gjetheve*

— **Enver Kushi** (fq. 12)

*Kronika muzgjeshe*

— **Odhise Çerkezi** (fq. 18)

*Vija e verdhë*

— **Dije Demiri-Frangu** (fq. 20)

*Rrenë asht molla e Adamit*

— **Nurie Emrullai** (fq. 21)

*Letërsia, kjo shpëtimtare*

— **Arben Meksi** (fq. 24)

*Karikatura e së shtunës*

Fjalë përuruese për filmin  
"Pasaporta" të regjisorit  
**Eduart Grishaj**

Nga **Akademik Gjovalin Shkurtaj**

Filmi "Pasaporta" vjen si një hap tjetër i sigurt, por tashmë me një temë aktuale, realizuar në mënyrë sa mbrësëlënëse e me theksime të aktualitetit të dhimbshëm të plojës njerëzore e shpirtërore që shkakton largimi në masë i të rinjve nga Shqipëria e nga trojet shqiptare. (fq. 17)

**Friedrich Dürrenmatt**  
**Takime**

Përktheu nga gjermanishtja  
**Dr. Elda GJANA-BORIÇI**

(fq. 22)

Njeriu, në fëmijëri-adoleshencë, lidhet me të afërmit, me motrat dhe vëllezërit dhe me të tjerë radhazi, nëpërmjet asaj që quhet lidhje "gjaku", e cila shpesh ruhet edhe pas saj, gjatë gjithë jetës. Nuk përjashtohet gjenetika, e padukshme, "lidhja e gjakut", prejardhja, familjare e fisnore, e përbashkët, me rolin e vet ndikues, të vetvetishëm. Rëndësi përcaktuese, ka të jetuarit e përbashkët, marrdhëniet e afërta, ngjarjet e shënuara të kësaj periudhe, sidomos përjetimet dhe kujtimet e përbashkëta. Edhe në faza të tjera të jetës, ngjarjet, kujtimet dhe përjetimet e përbashkëta i afrojnë dhe i lidhin njerëzit. Me shkrimtarët, aq më e fortë me më të pëlqyerit, lidhja është tjetër lloj, më e brendshme, zakonisht, pa komunikime a marrdhënie të drejtpërdrejta dëgjimo-pamore. Ajo përftohet së brendshmi, nëpërmjet komunikimit psiko-emocional dhe intelektual, edhe nëse me ta nuk kemi pasur komunikime a marrdhënie të drejtpërdrejta, sikurse, nuk kemi pasur me Eskilin, Danten, Shekspirin, Servantesin, Naimin, Fishtë, De Radën, Lasgushin. Me Ismail Kadarenë, një pjesë e lexuesve shqiptarë, kanë pasur edhe komunikime dhe marrdhënie të drejtpërdrejta: miqësi e kolegëri, takime, biseda, debate, shëtitje, foto. Sidoqoftë, me veprën letrare dhe bëmat qytetare, ai ka qenë dhe mbetet në qenien intelektuale dhe shpirtërore të shqiptarëve, duke i shoqëruar përherë në jetë, mendërisht dhe emocionalisht, ndriçuar, qytetëruar dhe europianizuar në breza, prej viteve 1960, kur, mes shkrimtarëve të tjerëve, u shfaq mjaft i dallueshëm me mendime, botëvështrime, shprehësi sintetizuese, origjinale, të panjohura në letërsinë shqipe.

### E shkuara, e pandashme

Në epokën e rrafshimit të personalitetit njerëzor, qytetar e profesional, institucionalisht nuk bëheshin veprimtari për përvjetorë të shkrimtarëve dhe të artistëve, për sa ishin gjallë, me arsyetimin, se krijohej kulti i tyre, si në Perëndim, me anë të të cilit, punëtorët dhe fshatarët, që ishin heronjtë e kohës, ktheheshin në qenie inferiore. Fare rrallë mund të gjendjen, vetëm urime telegrafike, në përvjetorë datëlindjesh për shkrimtarë dhe artistë, edhe ato nga vitet 1960-fillimvitet 1970, pa mbërritur fryma e Revolucionit Kulturor Kinez. Datëlindjet e tyre nuk dihejshin, për t'i uruar, tek e fundit, gojarisht. Për kolegët, miqtë e afërt dhe punonjësit e Lidhjes dihej datëlindja e Dritëro Agollit (13 tetor 1931), për të cilën ndjente krenari, sepse, sikurse thoshte, kishte lindur në të njëjtin muaj dhe datë me Migjenin (13 tetor), dhe, po në atë muaj, që pat vdekur Naimi (20 tetor), duke lenë të nënkuptohej, se ishte vazhdues i tij. Dhe kjo, dihej, nga që, ai, e festonte në shtëpi, me vizita e urime nga kolegë, miq e të afërt, aty-këtu, edhe figura të larta politike. Datëlindja e Ismail Kadaresë, thuajse, nuk dihej. Edhe, nëse e kishim dëgjuar ndonjëherë, nuk na ishte ngulitur në kujtesë. Shkruesi i këtyre radhëve e ka mësuar, dhe i u ngulit në mendje, nga libri *Ftesë në studio*, në të cilin, Kadareja ka shkruar: «Kur në letra të ndryshme (anketa, kërkesë për vizë, etj.) shënohet datën e lindjes, 28 janar 1936, vetëtimthi më shkollon nëpër mend fjalë «e mërkurë». Ti ke lindur të mërkurë, më thoshte shpesh im atë, thua se kjo kishte një rëndësi më vete. Kur ishte në qejf, çka ndodhte rrallë, shtonte se atë të mërkurë, usta Vasili, që e kishin fqinj dhe që na riparonte pullazin e pjesës perëndimore të shtëpisë, porsa e kishte lënë punën për të ngrënë drekë, dhe, ndërsa zbriste nga shkalla, e kishte uruar babanë: me një djalë! Disa minuta më pas, në dhomën e dimrit, që ndodhej pikërisht në atë pjesë të shtëpisë, pullazi i së cilës riparohet, lënda unë. Ndonëse nuk e shpjegonte, kuptohej që babai i jepte një kuptim të jashtëzakonshëm urimit

# NË TIRANË DHE NË PARIS, ME DHE PA KADARENË

nga Bashkim Kuçuku

- Kujtesë, përjetime-



të mjeshtër, që ishte duke vendosur pllakat e gurta, krejt si një mburojë sipër meje, në kohën që unë vija në jetë.» (Ismail Kadare *Ftesë në studio*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, 1990, faqe 314.)

Në datëlindjet, pas 1991, miq dhe kolegë, lexues të shumtë rendnin ta takonin, të ishin e të ndjeheshin pranë tij. Ata, që, nuk mund ta takonin, i uronin me zë, në telefonin e shtëpisë, ndërsa, në kohën e modernizimit teknologjik, me *WhatsApp* dhe *Email*.

Për kundërvënien psikologjike dhe veprimi, për të plotësuar diçka në mungesat tona të kulturës letrare e qytetare, nga një shtytje e vetvetishme, më 1996, me nisativën time, dhe përkrahjen e disa kolegëve, profesorë e studiues, organizuam një *Sesion Shkencor* me rastin e 60 vjetorit të tij të lindjes, në sallën e *Piramidës*. Bërthama e shtytjes ishte bibliografia e botimeve të tij në gjuhë të tjera, e cila, më kishte befasuar dhe më kishte dhënë kënaqësi të madhe, sepse pata mbledhur, aq të dhëna, sa nuk më shkonte ndërmend. Bibliografia e atëhershme, e cila doli në *Drita*, në vite u pasurua dhe u shumëfishua. Krahas shkrimtarëve, miqve, studiuesve dhe profesorëve, ishin të ftuar njanshmërisht, edhe deputetë, figura politike të Partisë Demokratike: Pjetër Arbnori, atëherë, kryetar i Kuvendit Popullor, Neritan Ceka, deputet, etj., një lloj servilizmi politik i ri i kohës, ende i pranishëm në ndërgjegjen tonë, pasojë e frikës ndaj pushtetit, pasi Partia Demokratike zotëronte Kuvendin dhe qeveriste.

28 janari i këtij viti, 2025, për herë të parë, është pa shkrimtarin njëmendësisht të madh, edhe më i madh për Shqipërinë dhe krejt botën shqiptare, që mbetet e vogël, edhe duke qenë tërësore e me gjithsej. Ai nuk është më fizikisht, nuk bisedojmë dot me të. Nuk dëgjojmë as hapat me këpucët e rënda dystabane, që, pesëdhjetë vjet më parë, kërcisnin kumbueshëm, në oborrin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, te *Rruga e Kavajës*, saktësisht në orën 12.10-12.20. Pasi mbaronte orarin e të shkruarit, në studion në shtëpi, vinte atje. E kishte orar pushimi dhe shlodhjeje. Donte të dinte, se ç'bëhej në redaksinë e

*Dritës* dhe të revistës *Nëntori*, në Lidhje, në botime, përkthime, shtëpinë botuese *Naim Frashëri*, për këtë dhe atë shkrimtar e artist, shoqëruar, të dhënat, që merrte, dhe me mendimin e vet. Herë-herë hynte dhe në redaksi, më tepër, për t'u hedhur romuze redaktorëve, që, rrallë i shihte të aftë, prandaj, i ironizonte "*Edhe, ju ...!*", "*Mjerë, ju!*". Meqë nuk ishte i kafeneve, atje, në oborrin e Lidhjes, e linte të takohej me Lasgush Poradecin për kënaqësi bisede, me Jusuf Vrionin, apo, Vedat Kokonën, që sillnin përkthimet për revistën *Les Lettres Albanaises*, të cilën e drejtonte prej themelimit të saj. Me kolegët e afërt bënte humor, çuditej me të madhe nga ato që i tregonin, ose, qeshte. Takohej dhe me shkrimtarë dhe artistë të tjerë, më pak të njohur, që i "zinin rrugën", dhe rrallë, me dashje dhe pa dashje, pranonte, që fotografi i gazetës *Drita*, Fatos Maliqi, t'i bënte foto me ta.

Edhe në ditët e vështira, të mosafritimit ndaj tij, pas goditjes, që i dhanë, më 1975, (për poemën e pabotuar *Pashallarët e Kuq/ Në mesditë Byrojtë Politike u mblodh*), vinte në Lidhjen e Shkrimtarëve, ndonse, rrinte në oborr, përshëndetej dhe e përshëndesnin ftohtë, dikush edhe me një tundje koke, ndonjë ndalej dhe këmbente disa fjalë me të. Lart, në zyra, nuk ngjitej. Shfaqej sa për të marrë rrogën, në zyrën e Llogarisë, ose, në mbledhjet e Kryesisë së Lidhjes, dhe, në to, që mos t'ia merrnin për kundërvënien. I heshtur dhe fjalëpak, edhe në mendimet, që shqiptonte në mbledhjet e Kryesisë. Vinte vetëm dhe kthehej vetëm në apartamentin te *Rruga e Dibrës*, sot *Muzeu Kadare*, duke kaluar përmes sheshit të madh *Skënderbej*, i shoqëruar nga hija e vet dhe kumbimi i hapave me këpucët e rënda, në kontrast të madh me më parë, kur, shkrimtarë, të rinj e të vjetër, nuk i shqiteshin pa mbërritur te hyrja e ndërtesës, ku banonte.

### Intimizëm në takim me lexuesin e vet, të natyrshëm

Pas 1992-it, në ecje për te *Kafe Piazza* dhe *Juvenilja*, hapat nuk i kumbonin,

se këpucët e dysta ishin me lëndë sintetike të butë. Njerëzit të njohur dhe të panjohur, kolegë dhe pa qenë kolegë, intelektualë të profesioneve më të ndryshme, i rrinin para e mbrapa, majtas e djathas, i zinin shtëpinë me orë të tëra, në biseda e diskutime të pandërprera deri në mesnatë. Dhe, i pranonte me durim e tolerancë të pazakonshme për të. Ankohej: "*Vijnë me orar e pa orar, dhe shtrohen në muhabet deri vonë! Harrojnë që të tjerët* (për veten dhe familjen) *kanë edhe punë! Nuk u them dot mos e jani!*" Bisedat dhe diskutimet ishin krejt të lira e për gjithçka.

Gjatë qëndrimeve në Tiranë, në fillim më shpesh, institucione të ndryshme e ftonin në takime me lexues. Rrallë nuk kam qenë i pranishëm. Nga më interesantët ka qenë takimi në tetor, 2000. Disa pjesë nga shënimet e asaj kohe: "E premte, 27 tetor, ora 17.00, 2000. Qendra Ndërkombëtare e Kulturës (Piramida). Salla e madhe *Odeoni* kishte më shumë njerëz se në janar për librin *Kohë barbare* dhe *Ra ky mort dhe u pamë*, në të cilin kishin ardhur, që nga presidenti i Republikës, ambasadorë, kryetarë partish, deputetë dhe ministra. Takimi që i ftohtë dhe me pak pyetje, biseda eci me vështirësi, sa Ismaili tha hapur, duke i fyer ata, se ky ishte takim me lexuesit, pjesëmarrja e politikanëve e zyrtarizoi atë.

Në bisedën e sotme vazhdonin të vinin të tjerë, sidomos studentë dhe nxënës. Ismaili i u kujtoi takimin e paradisamujve, që nuk kishte qenë i gjallë, duke u thënë, se ky takim është thjesht për të biseduar me ju. Mund të pyesni për çfarë mendoni. Unë jam i kënaqur që jam këtu, sepse, ju jeni lexuesit e mi të natyrshëm. Unë shkruaj në gjuhën që flisni dhe lexoni ju, dhe unë jam shkrimtar i këtij vendi. Përveç kësaj, edhe pse kam biseduar shpesh me lexues në shumë vende të tjera, gjithmonë e kam thënë, dhe jam i mendimit, se lexuesi shqiptar është lexuesi më i kulturuar, më i mençur. Ai gjykon me mençuri të madhe për letërsinë. Ca kohë u duk se po lëkundej dëshira për të lexuar, siç ndodhi në të gjitha vendet e Lindjes komuniste, por fakti, që ju jeni këtu, tregon se tek shqiptarët është kthyer dëshira për të lexuar. Prandaj, unë jam midis jush për të biseduar. Mos të thoni pastaj, pse nuk e pyeta, kur ishte këtu. (Salla qesh).

*Në fillim pyeti një zonjë: Romanin nuk e kam lexuar, por, me që jam grua dhe, që, 8 marsi është Dita e Gruas, dhe unë kam shkruar diçka për të, mos ka lidhje me gruan? Së dyti: pse lulet e ftohta?*

*Ismaili: Të them të vërtetën, që të jem i sinqertë, kur kam shkruar romanin, vetëm kjo nuk më ka shkruar në mendje, 8 marsi i grave! (Salla qesh. I pëlqeu shumë sinqeriteti, miraton këtë lloj bashkëbisedimi). Po të nisesh nga titulli, marsi në simbolikën shqiptare është muaji i trimërisë. Marsi vjen nga perëndia mars, perëndia e luftrave, por, romani nuk ka lidhje me këto. Ju pyesni, pse lule të ftohta. Si t'ju a them, ashtu janë lulet e marsit, lule të ftohta, se dhe muaji është i ftohtë, janë lule të ngrira, prej akulli.*

*- Titulli lulet e ftohta, mos ka ardhur nga që është shkruar në Francë?*

*- Jo. E vërteta është, se romani është shkruar në Paris dhe në Tiranë. Me që më pyetët për këtë, po ju them, se diçka është shkruar edhe në Japoni. Në Japoni është shkruar përmbytja e qytetit, që sheh personazhi në ëndërr. Ndoshta, nga që, në Japoni, bien shumë shira, atje pata nxitje më të madhe, dhe shkrova për përmbytjen.*

*Një lexuese: Pse nuk jetoni në Tiranë, tani, që Shqipëria ka nevojë për intelektualët e saj, pasi shumë prej tyre janë larguar?*

*- Ismaili: Edhe më përpara kam thënë që do vij të jetoj në Tiranë. Këto kohë, siç e keni parë, kam ardhur më shpesh. Por, natyrisht, herë pas herë do të shkoj në Paris, sepse kam punë me botuesin tim, që ka edhe të drejtën e botimit në gjuhët e huaja. Për këtë duhet të kem një banesë të përshtatshme. Sapo të*

rregulloj punën e banesës, do të rri më tepër në Tiranë.

*Një gjuhëtar: Gjuhën shqipe, ju e rendisni tek gjuhët kryesore të Europës. Nga niseni që e vlerësoni kaq shumë?*

- *Ismaili:* Shqipja, dihet, që hyn te gjuhët kryesore të Europës. Këtë renditje nuk e bëj unë, por e bëjnë gjuhëtarët, studiuesit e gjuhësisë së përgjithshme. Në çdo libër themelor të gjuhëve, në çdo atlas serioz, shqipja renditet krahas gjuhëve kryesore, krahas gjuhëve neolatine, anglo-saksone, sllave, baltike, etj. Shqipja, greqishtja dhe armenishtja quhen gjuhë jetime, janë të veçanta dhe të pangjashme me të tjerat.

- *Nuk jeni lodhur, duke pritur, Nobelin?* - ishte një pyetje.

- *Ismaili:* Ju, ndofta, më merrni inat, me që ju prisni, dhe unë nuk e marr Nobelin, sikur unë nuk dua ta marr, e filloi përgjigjen. (Salla qesh). Po, sigurisht, nuk jam fajtor. Të them, që nuk kam dëshirë ta marr, nuk ju them të vërtetën. T'ju them, se mendja më rri te Nobeli, edhe kjo nuk është e vërtetë. Natyrisht, të marrësh Nobelin është një vlerësim i madh, është zyrtarizim i vlerave, kur vepra ka vlera të vërteta. Edhe vlera e Nobelit është kur u jepet shkrimtarëve që e meritojnë, se kur u jepet shkrimtarëve të panjohur nuk ka vlerë. Vjet, që e mori Gunter Gras, dhe, parvjet Saramago, Nobeli u është dhënë shkrimtarëve, që e meritojnë. Megjithatë, kur e merr Nobelin asgjë nuk ndryshon, as te vepra, as te shkrimtari. Ka vende, që janë indiferente ndaj Nobelit, sikurse ka dhe vende, që e mbiçmojnë. Ju duket si diçka qiellore. Para se të vija në Shqipëri, isha në Kore. Me që ishin të pakënaqur, pse nuk e mori Nobelin një koreanojugor, duke e ditur se jam pretendent, pyetja e parë, që më bënë, ishte, pikërisht, për Nobelin. Ata, thajse, ishin të sëmurrë për Nobelin. Përgjigja ime i çuditi, sepse u thashë, që, nuk është fatkeqësi të mos e marrësh Nobelin.

*Një pyetje tjetër. A jeni i kënaqur nga përkthimi i veprës suaj në frëngjisht prej Jusuf Vrionit. Po nga përkthimi në gjuhët e tjera, jeni i kënaqur?*

- *Ismaili:* Jam shumë i kënaqur nga përkthimi i Jusuf Vrionit në frëngjisht. Ai është përkthyesi i veprës sime. E ka filluar përkthimin me nisjativën e tij, dhe nuk e ka porositur askush, p. sh., *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Në fillim e përktheu thjesht për kënaqësinë e vet. Vetëm *Viti i mbrapshtë* nuk ka qenë i suksesshëm. Për këtë nuk është faj i përkthyesit, por është lloji i veprës. Siç e dini, atje përzihen tre stile: një stil i lartë, kur flitet për shtresat e larta, një stil tjetër për komitet, dhe një stil i përzier me barbarizma, kur flitet për shqiptarët e çoroditur dhe të prapambetur. Për t'ju përgjigjur këtyre stileve, përkthyesit do t'i duhej të studionte, p. sh., një herë frëngjishten mesjetare, e kështu, me radhë. Kjo është punë e gjuhëtarit dhe jo e përkthyesit. Me aq kohë, që ka përkthyesi në dispozicion nuk mjafton për këtë lloj përkthimi, as nuk ia vlen t'i hysh një studimi të tillë vetëm për një përkthim. *Lulet e ftohta të marsit*, p. sh., në frëngjisht, është përkthyer *Lulet e ftohta të prillit*, sepse, marsi për francezët ka kuptim tjetër, dhe, do ta merrnin me atë kuptim, pra, do ta keqkuptonin. Prilli për francezët ka atë kuptim, që ka për ne marsi. Unë vërtet jam me fat, që kam një përkthyes si Jusuf Vrioni.

Edhe në gjuhë të tjera, përkthimi është shumë i mirë: spanjisht, gjermanisht. Tani, edhe në anglisht ka përkthime të mira. E quaj veten me fat në përkthime, sepse jo rrallë janë të dobëta e me probleme. Ka përkthime të dobëta, që nuk të vete mendja të përkthehet ashtu. Kundera, kur pa në frëngjisht përkthimin e romanit *Shakaja*, u tronditi sa u stresua, pasi mendimet ishin përkthyer tjetër për tjetër.

Në anë të sallës, Bujari (Bujar Hudhri, botuesi i veprave të Ismailit) kishte vendosur një stendë me botime të reja të veprave në

gjuhë të huaja, të cilat nuk i kisha parë gjatë. Ishin të viteve 1999 dhe 2000. Kur po i shikoj me vëmendje erdhi dhe Ismaili.

- Shikoi, se për ty janë, - më tha.

- Më interesojnë vërtet, se këto botime nuk i di.

Fotografi Agron Kruti lëvizte sa atej-këtej. Merrte në fotografi Ismailin me ata që takohej dhe bisedonte. Ndoshta, më ka fotografuar dhe mua me të.

Bujarit i këshillova t'i regjistronte biseda të tilla të Ismailit me lexuesit. Më shpjegoi, se e kishte marr përsipër ta regjistronet Agron Kruti. Uroj ta ketë regjistruar këtë bisedë shumë interesante.»

Viteve të fundit, vendi i takimeve dhe bisedave, tanimë, të shkurtra dhe me pak veta njëherësh, ishte *Kafe Juvenilja*, te fundkodra e pyllit të Liqenit Artificial, i shoqëruar përherë prej të respektueshmit, Bujar Hudhrit. Shumë shkrimtarë dhe artistë, shqiptarë e të huaj, kanë marrë foto atje, një pjesë të publikuara në gazeta e rrjete sociale.

### Në Paris, mes librave, kulturës, historisë

Mungesa e tij fizike, është, së pari, në shtëpi dhe në familje, pastaj, te *Kafe Juvenilja*, në Tiranë, dhe *Café Rostand*, në Paris, në Akademinë Morale e Politike të Francës, te *Fayard*, shtëpia botuese e veprave, ku shkonte shpesh, si dhe në shtëpitë e tjera botuese dhe institucione me të cilat kishte marrdhënie letrare e miqësore. Por, Parisi, miliona banorësh dhe miliona të tjerë turistë, vizitorë e kalimtarë në vit, është i pandjeshëm, se nuk është sentimental. Pandjeshmëria, përftohet edhe, për arsye, se, në të, shkrimtarët e vet, të njohur botërisht, disa prej tyre nobelistë, francezë dhe të huaj, të natyralizuar në francezë, nuk janë një e dy. Megjithatë, mediat, thajse, të gjitha, madje, dhe lokale, për humbjen e tij, shkruajtën dhe folën gjerësisht, me vlerësime të larta. Nga një kërkim i paplotë, doli, se, njoftimi dhe vlerësimet për të ishin në 32 revista, gazeta, portale, ndër to *Le Monde*, *Le Monde des Livres*, *Radio France*, *Le Figaro*, *Le Parisien*, *La Croix*, *Éditions Fayard*, *L'express*, *Le Matin*, *Le Telegramme*, *Le Progrès*, *TeleRama*, *Courier International*, *France 24*, *Centre Europeen*, *France TV Info*, *Livres Hebdo*, *Paris Match*, etj. Përveç frëngjishtes, për veprën dhe personalitetin e tij kishte edhe në anglisht, spanjisht, italisht, gjermanisht, apo, të marrë prej mediave të tjera jo franceze. *Service de Presse e Elysée-së*, Zyra e Shtypit e presidentit të Francës, Emmanuel Macron, në emër të tij, publikoi e para një vlerësim të gjatë për jetën,

personalitetin, veprën dhe rëndësinë e saj në kohët e sotme moderne.

«Sot vdiq një shkrimtar, që, me jetën, me veprën dhe personalitetin e vet, mishëronte pasurimin e dialogut, forcën e frymës europiane dhe prirjen pritëse të Francës. Shkrimtari franko-shqiptar, Ismail Kadare, na la këtë të hënë. Ai ishte nga ata, për të cilët të shkruarit ishte një betejë... Ai na ndërmend parreshtur se si Europa është kontinenti i përbashkët, se si historia e saj është një histori e përbashkët. ....»

\*\*\*

Në vitet 1992-1996, Ismail Kadareja ka jetuar në 40, *Rue Violet* 75015 Paris, pranë *Avenue Émil Zola*. Pjesën më të madhe të jetës pariziane e ka kaluar në apartamentin e një pallati, në krye të *boulevard-it Sait-Michel*, n° 83. Lart portës, anash, në një tabelë mermeri, është e shkruar: Paul Mounet/tragédien né le 5 octobre 1847 à Bergerac/mort dans cette maison le 10 février 1922.

Vendndodhja e atij pallati, tanimë, historik për shqiptarët dhe kulturën shqiptare, është në të djathtë të *Place Édmond Rostand*, me rrethqarkullimin e automjeteve, përbri *Jardin du Luxembourg*-ut, më i njohuri dhe më i shëtitur prej vizitorëve, me skulptura të perëndive të lashta e mbretëreshave. Në të është Senati i Francës. Ajo pjesë e lagjes është një nga qendrat kryesore, kulturore e urbanistike, të kryeqytetit francez, në mos parësore, edhe në se konkurose e saj do të vihej, *Champs-Élysée*-ja, shëtitorja e famshme, shekullore, disa kilometra e gjatë, me vepra arti, arkitekture, parqe dhe sheshe të ngjarjeve historike tronditëse. Njëmendësisht, qendra e atjeshme është zemra kulturore dhe historike e Parisit. Pas pallatit, disa dhjetra metra, në *Rue Soufflot*, është *Panteoni*, dhe, ngjitur me të, biblioteka, e veçantë për nga pasuria dhe ndërtesa karakteristike qindravjeçare, *Sainte-Geneviève*, dhe, *Faculté de Droit à l'Université Paris*. Në anën tjetër, djathtas, ndërtesa madhështore e hijerëndë e universitetit *Sorbonne*, me *Rue des Écoles*, përshkuar në breza nga këmbimi i përjetshëm i liceistëve dhe i studentëve. Më tej *Quartier Latin*, lagjja e parë, zanafilla historike e Parisit, me rrugë e rrugica marramendëse, me restorante të kulturave më të ndryshme, europiane, aziatike, latino-amerikane, afrikane, me përjashtim të asaj shqiptare, ku gëlojnë në çdo stinë dhe muaj, natën dhe ditën, turistë nga e gjithë bota. Një nga rrugët spërdredhse të asaj lagjeje të ngucur në çdo gjë, është dhe *Rue de la Huchette*, në të cilën ndodhet *Le Théâtre de la Huchette*, me një sallë fare të vogël, që

të ndërmend kinema *Agimi*-n, në Tiranë, madje, më e vogël dhe më modeste, si teatër familjar. Pa reklamat e zakonshme, me oraret e shkruara me shkrim dore, ose, të printuara, në të janë luajtur për herë të parë (1952) dhe vazhdojnë të luhen pandërprerje, dramat *La Cantatrice chauve/Këngëtarja tullace/*, *La Leçon/Mësimi*, dhe drama të tjera të Eugène Ionsco-s dhe të autorëve të tjerë bashkëkohorë të poetikës së absurdes, ndër më risueset e teatrit modern europian të gjysmës së dytë të shekullit XX. Jo larg, buzë Senës, është *Notre-Dame de Paris*. Përqark pallatit, majtas e djathtas, janë disa shtëpi botuese të njohura: *José Corti*, *Flammarion*, *Odile Jakob* me të cilat Ismail Kadareja kishte lidhje botimi dhe njohjeje.

Në fund të *boulevard Saint-Michel*, tej kryqëzimit me *boulevard Saint-Germain*, nga perëndimi, po aq i njohur, dhe me lëvizje të madhe automjeteve e njerëzish, ka pasë qenë *Librairie Gibert Jeune*. Në kohërat e leximit, tërhiqte me qindra e mijëra lexues, sidomos studentë dhe profesorë, sepse ishte e specializuar për librin universitar të fushave më të ndryshme, ndërsa, sot, në kohërat e braktisjes së leximit, prej vitesh është e mbyllur, e kthyer në gërmadhë keqardhse. Më lart, për nga *Jardin du Luxembourg*, është *Librairie Gibert Joseph*, dikur shemër e fortë e *Gibert Jeune*. Duke mbetur e vetme, në përmasa të tilla, të mëdha, është fuqizuar, pa ndërje rrezik rivalizmi. Në anën tjetër, të *Saint-Michel*, te *Place de la Sorbonne*, ka qenë *Presses Universitaires de France*. Sa herë shkoja në Paris, vrapi i parë ishte të shihja librat e rinj të fushës së letërsisë, psikologji-psikanalizës e të dijeve, që lidheshin me letërsinë. Në të kam marrë shumë libra. Ishte e mirëorganizuar, me shërbim shembullor si të kohëve, kur libri lexohej, madje, nderohej e çmohej edhe nga ata që nuk lexonin. E pësoi më keq, se *Gibert Jeune*, gërmadhë. Nja njëzet vjet më parë, me krejt fondin e pasur të librave, e dogjën turmat e irrituara, ngritur në demonstrata të pa kontrolluara. Pas djegies nuk u bë më kurrë librari. E kthyen në dyqan xhinsesh (!). Sot është një lloj gjellëtoje moderne «europiane». Klientët, me laptop përpara, duke ngrenë, njëkohësisht, rrëmojnë në *Internet*.

Në këtë pjesë lagjeje, gjesur e ngjitur, me universitete, biblioteka, teatro, librari, shtëpi botuese, muze, në mes tyre, ndodhet *Place de la Sorbonne*. Sheshi duhet të jetë po i vjetër, qindravjeçar, ndoshta, që nga themelimi i *Sorbonne*-ës, apo, diçka më pas, sepse, emërtimi i tij është në vartësi të emrit të vet universitetit. Shesh i vogël, me disa vepra arti, me dy librari, edhe sot, një e librit filozofik dhe tjera e librit të shkencave



të natyrës, nuk është as njëqind metra nga banesa e Ismail Kadaresë. Hapësira e tij, mbyllur, me ndërtesa vazhdim i njëra tjetrës nga tri anë, zotërohet nga monumenti i filozofit Comte Auguste-it, i cili përbëhet nga tri skulptura. Lart është busti i Comte August-it. Anash, në të djathtë, më poshtë bustit, është skulptura e një femre në madhësi natyrale. Në dorën e djathtë mban një fëmijë, në të majtën ka një pendë shkrimi. Djathtas është skulptura e një mashkulli me libër. Përballë është Café-Bar-Restorant-i i famshëm *L'écritoire*. Deri nga vitet 2000 vazhdonte të ishte kafe e parapëlqyer e shkrimtarëve, filozofëve, profesorëve, shkencëtarëve, aristokracisë intelektuale. Punonin, atje, me orë të tëra, edhe gjithë ditën, diskutonin mes tyre, drekonin e darkonin, pinin kafe, çaj, birra. Kishte një interior të këndshëm, klasik, me mobilie druri, ngjyrë kafe e errët, me tryeza larg njëra tjetrës dhe me qetësi, sikur nuk kishte njerëz. Bisedohej me zë të ulët. Prej vitesh interieri tradicional është shndërruar në një interior Bar-Restorant të zakonshëm. Hyn e del kushdo. Të hapësh letrat e të shkruash a të lexosh është e pazakonshme.

### Tirana në Café-Rostand dhe Dalloyau

**C**afé Rostand, tanimë, e mirënjohur nga libri i vet Ismail Kadaresë *Mëngjeset në Kafe Rostand, motive të Parisit*, nga pikurat, që kanë bërë piktorët shqiptarë dhe fotot e publikuara, është, sapo kalon *boulevard Saint-Michel*, në anën tjetër të tij, në *Rue de Médecins*, përbri *Jardin du Luxembourg*. Parakafja, në trotuar, është e zakonshme, si shumë e shumë të tjera në Paris. Mjedisi brenda është i madh, përsëgjati, me tryeza e karrige cilësore për dy dhe katër veta, me ndriçim të fortë. E qetë, ku secili është më vete, dhe në punën e vet, të jep dhe të detyron qetësi. Në ato karrige, ai ulej edhe dy-tri herë në ditë, dhe, në ato tryeza ka shkruar qindra faqe, *sikurse* ka pohuar në libër. «Në këtë kafe kisha shkruar qindra faqe dhe po aq shënime për motive e sinopse, pa u kujtuar asnjëherë për atë vetë, kefenenë.» (Ismail Kadare *Mëngjeset në Kafe Rostand, motive të Parisit, Onufri, Tiranë, 2014, faqe 26*). Sigurisht, atje kanë pasë shkruar dhe shkruajnë edhe shkrimtarë të tjerë, s'dihet se sa, të shquar e nobelistë, francezë dhe nga vende të tjera.

Në kafe, në Paris, për herë të parë, e kam takuar jo te *Rostand*, por te *Dalloyau*, ngjitur me të, në vitin e mbrapshtë 1997, siç u quajt në përngjasim me titullin e romanit të tij *Viti i mbrapshtë*. Ka qenë një takim i rastit, tepër i rënduar psikologjikisht nga ngjarjet, që kishin ndodhur në Shqipëri. Kemi folur me sinqeritet të plotë nga dhimbja e madhe, e përbashkët. Po japim disa pjesë nga biseda, sipas shënimeve të asaj kohe.

“Paris, 13 maj 1997, ora 19.30

Mora krahun e djathtë të *boulevard-it Saint-Michel*, për të kapërcyer rrugën për në *Jardin du Luxembourg*. I lëshuar nga lodhja, se kisha ecur dhe ndenjur gjatë në këmbë, duke kërkuar libra te *Gibert Jeune* dhe *Hachette*, që nuk ishin shumë larg njëra tjetrës, me një qese (sac) me libra, mendoja të çlodhesha te ndonjë ndenjësë e parkut. Pa kapërcyer për te *Jardin du Luxembourg*, befaz, te kafe *Dalloyau* më zuri syri Ismailin, ulur, bashkë me Helenën. Thuajse, në të njëjtën kohë më panë dhe ata, të cilët u çuditën, sikurse dhe unë, për shfaqjen time të papritur, e, sidomos për takimin e rastit, që është tepër e rrallë të ndodhë në Parisin e madh, me lëvizje perpetum. Buzëqeshja e lehtë te të dy ishte shenjë e mirëpritjes së një takimi të tillë. Në dhjetor kisha qenë në shtëpinë e tyre. Kishim biseduar gjatë për letërsi dhe politikë, për ngjarje e bëma, dramatike e qesharake, dashakeqëse e cinike, me emra konkretë të «personazheve» të njohur në Tiranë. Mirëpo, prej shkurtit të atij



Yashar Qemal, Ismail Kadare dhe Alain Bosquet

viti, të zi, shqiptarët, kudo që ishin, qenë tmerruar nga ngjarjet e rënda në Shqipëri, që përmbysën pushtetin, qeverinë, dhe shkatërruan Shqipërinë. Kështu, që, biseda kundër politikës dhe politikanëve, ishte e hapur midis nesh.

Karriget e tyre ishin ngjitur te dera e kafes, fare afër njëra tjetrës dhe në rresht. Terrasa ishte e ngushtë për tryezat dhe karriget që kishte. Në një tryezë nuk mund të rrinin më shumë se dy veta, prandaj, u ula edhe unë në rresht, i treti, në tryezën përbri, e cila çalonte, se dyshemeja prej çimentoje ishte me gropa dhe gunga. Përballë nuk mund të rrija. Në atë anë ishte komariorthi i ngushtë në të cilin qarkullonte kamrieria dhe njerëzit, që hynin dhe dilnin.

I pyeta për shëndetin. Ismaili, as nuk u përgjigj, dhe as nuk bëri pyetjet e para të mirësjelljes në çdo takim. Ende pa u ulur unë, tha:

- Ç'bëhet atje?! - sikur ajo, atje, t'i përkiste një bote tjetër lloj, të shenjuar nga e keqja, ku s'mund të shkonte dot, ose, ata, që vinin prej andej, të ishin ndryshe, të dalë prej vorbullës së saj.

Tepër i trishtuar, madje i stresuar, nga ngjarjet tragjike të janar-shkurt-marsit 1997, fola shumë e papushim. Ismaili, herë pas here, bënte pyetje të shkurtëra, duke më nxitur të flisja për ato që i interesonin, e, po ashtu, shprehte shkurt mendimet e veta.

Unë: Lëre, mos pyet se ç'bëhet! Më e keqja është bërë! Ndodhi, ajo, që as në mend nuk na shkonte të ndodhte!

Ai: Të gjithë janë tradhtarë! Të gjithë do t'i dënojë historia! Filluan kush e kush të shante më shumë vendin dhe njëri tjetrin, dhe e sollën në këtë gjendje.

Unë: Një tradhëti, që nuk ka ndodhur asnjëherë në historinë e Shqipërisë.

Ai: Vetë e bënë. Erdhën forcat e huaja në Shqipëri të vendosin rregull e qetësi! Turp i madh! Japin televizionet e huaja, si kalojnë,

në sheshin *Skënderbej*, tanket e huaja, me snajper!

Unë: Ushtarët grekë, të vendosur në Kombin (në lagjen e ish Kombinatit të Tekstileve *Stalin*) , “ruajnë” Tiranën!! Njerëzit nuk dinë ku të shkojnë. Kur hapet ndonjë shteg nisen nga sytë këmbët.

Ai: Edhe aviatorët tradhëtuan. Asnjë nuk ka bombarduar. Gënjejnë, që të justifikojnë arratisjen. Vajtën në Itali për më mirë, por Italia po i torturon në burgje. Edhe ata tradhtarë janë. Dhe pa e ndërprerë fjalën: - Ç'janë këto komitete të *Shpëtimit Publik*? Kush është në to? Po, socialistët i përkrahin? Po *Forumi për Demokraci* ç'rol luan?

Unë: Për ato kam dëgjuar të përmenden në Televizion dhe në gazeta, por nuk di se cilët janë në to dhe çfarë bëjnë.


Ai: *Forumi për Demokraci* ka për heronj miqtë e Hysni Kapos. Ata që besonin tek Hysni se do t'i shpëtonte nga Enver Hoxha! Lexo për ta, të marrësh vesh cilët janë! Edhe politikanët nuk janë më të mirë.

Ai: Po Nanua, ç'thotë tani?

Unë: Nanon nuk e kam simpatizuar asnjëherë. Madje, më duket i rrezikshëm dhe egoist. Mbase, e teproj. Për mua është kozmopolit. Mendjen e ka te Greqia, prej nga mund të na vijë e keqja më e madhe. Sa doli nga burgu ia mbathi në Greqi. Thanë, se ka fëmijët dhe familjen atje. Po pse e ka, pikërisht, atje?! E ndihmon Greqia familjen e tij dhe atë?! Pse e ndihmon? Korrespondenti i BBC-së atje, thoshte, se ruhej me blind, sa grekët habiteshin me superruajtjen e tij. Pse ruhej? Ai nuk u kërcënu në Shqipëri, që të ikën koka kot, jo më në Athinë. Të gjithë hanë ku të mundin. Ky është një stres kombëtar, një marrëzi e përgjithshme! Saliu duhet të kishte dhënë dorëheqjen.

Ai: Po nuk do të ishte më keq? Nuk do të destabilizohej më shumë vendi?

Unë: Jo, nuk do të destabilizohej më shumë. Do binte qetësi. Ka uretjtje masive



për të. Nga frika, para se të vinin forcat e huaja, nuk ruhej nga Garda e Republikës, por nga mercenarë, kryesisht, nga krahina e vet. Në muajt e parë, kaloja çdo ditë para Presidencës për të shkruar në Fakultet. Nuk më besohej, kur i pashë për herë të parë! Vinin qark Presidencës, të parruar e të paqethur, veshur me rroba ushtarake, pa kapele dhe shenjat e ushtrisë, një lloj me ushtarët e liruar dikur, që ktheheshin në shtëpi. Për të m'u ngulitur në kujtesë, që më vonë mos të dyshoja, se qe vegullia/shajnina ime, kaloja për t'i parë në ishin të vërtetë/realë. Ishin realë, mercenarë të vërtetë! Ai armatosi PD-në. ....

Ai: Këtë e dinë të gjithë, që armatosi PD-në.

Unë: Flisni, se kanë nevojë të dëgjojnë dikë të mençur dhe me mendje të kthjellët.

Ai: Jo. Tani nuk kanë nevojë për asgjë dhe nuk duan të dëgjojnë.

Unë: Jo. Ka shumë që dëgjojnë. Shqiptarët e ndershëm, sot, janë si një familje e madhe, që u ka rënë gjëma dhe e kanë humbur toruan, prandaj kanë nevojë për një mendje gjakftohtë, të mençur, që t'i ndihmojë të vijnë në vete, të përmenden e të kuptojnë se ç'po bëhet dhe ç'po bëjnë.

Ai: Më duket, se nuk kanë më nevojë për mendje.

Për të ndryshuar bisedën për politikën, e cila ishte aq stresuese, e kalova bisedën tek letërsia.

Unë: Kujtoj shpesh veprat tuaja në të cilat keni ngritur lart vetitë e shqiptarit, të kthyer në virtyte. Ndërsa, këto kohë, sa herë kam thënë me vehte: “Mirë ke shkruar, o Ismail, i ke bërë shqiptarët perëndi, por, a je i ndërgjigjshëm se si janë katandisur?!”. Ai: Unë nuk jam dakord me ata që thonë, se e keqja shqiptarëve u ka ardhur nga që në letërsi janë lavdëruar. E keqja nuk vjen nga lëndat, nga himnizimi. Në kohën e Gëtes, gjermanët ishin bajgë, ishin mizerje, as dinin të jetonin mirë, as kishin. Gëtja shkroi dhe krijoi shpirtin gjerman. Muzhiku rus, në kohën e Pushkinin, ishte bajgë fare. Pushkini shkroi dhe krijoi shpirtin rus. Prandaj, janë ngritur e janë bërë të tillë, si janë sot.

Unë: Ju uroj për *Spiritus*. Vazhdim dhe plotësim i linjës së *Koncertit*. Kam bërë një shkrim për të.

- Del ndonjë gjë atje? Ç'pyes kot! Atje është mbyllur çdo gjë.

- Drita rifilloi të dalë. Dhe revista *Universi Shqiptar i Librit*.

- Dhe prapë me atë fjalor, që akuzojnë njëri tjetrin, të ngjallin uretjtje.

.....

Unë: Keni shkruar ndonjë gjë të mirë, këto kohë?

Ai: Asgjë nuk kam shkruar. Kush të lë të shkruash?! Ku të shkruash me këto që ndodhin?

- Ngrihemi, - i tha Helenës, se zuri shiu. Dhe këto (pëlhurat e hapura të tendave) i mblodhën. - Edhe ti, ik, tani, m'u drejtua mua, se të zuri shiu. Faleminderit, dhe mirupafshim!

U habita. Pse më tha “faleminderit!?” Kafën e pagoi ai. Ishte i hutuar, apo, më falenderoi për bisedën?! Ndërkohë, midis kaloi një vajzë, që erdhi dhe i takoi. U puthën, këmbyen disa replika me të, pastaj, u ulën përsëri.

### Vazhdimësi e ribotimeve

Në nëntor 2024 isha në Paris. Nga forca tërheqëse e përhershme ndaj librave shkova përsëri edhe te *Gibert Joseph*. Në katin e letërsisë ishte këndi kushtuar Ismail Kadaresë, kulturë nderuese për çdo autor të njohur, që ndërron jetë, veprat e të cilëve i kanë në librari. Ishte foto e portretit të tij, CV-ja me disa nga çmimet e mëdha botërore, që ka fituar. Ishin dhe disa nga ribotimet e fundit të veprave në frëngjisht:

1. *Qui a ramené Doroutine?*

Zulma/Z, 2022

Livre de Poche

Në ballinën e parë, një fashetë e gjelbër mbështjell librin, me shënimin “Një tregimtar mjeshër/Un magistrat (?) conteur», marrë nga *Libération*, shkruar vite më parë.

2. *Les tambours de la pluie*

Fayard, 2023

Collection Folio Livre de Poche

3. *Le Palais des Rêves*

Fayard, 2024

Biblio Livre de Poche

4. *Chronique de la ville de pierre*

Gallimard, 2024

Folio Livre de Poche

Në faqen e Fayard-it gjenden edhe këto ribotime të reja:

1. *Disputes au sommet/Grindje në kulm/19. 01. 2022*

2. *Avril brisé/11. 10. 2023*

3. *Palais de Rêves/30. 10. 2024*

Edhe pse këto të dhëna nuk janë të plota, ribotime me ritmikë të tillë, tanimë, pas gjysëmshekulli, apo, dyzet e tridhjetë vjetëve të botimeve të para, janë shenjë e leximit në vazhdimësi të veprave të tij nga brezat e rinj të lexuesve dhe të studiuesve, prani e pandërprerë e përjetimeve të tyre prej saj.

**Kujtesa, domosdoshmëri qeniesore/ekzistenciale e identitetit kombëtar**

Në pallatin, ku ka banuar Ismail Kadareja, sipas shënimit te porta, mes shekujve XIX dhe XX, ka pasë jetuar një tragjedian. Të shënuarit e banesave, ndërtesave të vendeve të punës, dhe, brenda në to, të zyrave, laboratorëve, etj. është në kulturën e francezëve, mënyrë e nderimit dhe e ruajtjes së kujtesës kombëtare. Me të gjitha gjasat, është e natyrshme, dhe plotësisht e mundshme, që, te porta të shkruhet, që ka banuar edhe Ismail Kadareja. Po, ashtu, në traditën e kulturës franceze, është, që, me emra figurash të shquara botërore, emërtojnë sheshe dhe vendosin buste të tyre. Për të gjitha gjasat, edhe emërtimi i një sheshi dhe vendosja e bustit të tij, është i natyrshëm dhe plotësisht i mundshëm. Qeveria shqiptare, me institucionet e veta përkatëse, në mirëkuptim e bashkëpunim me institucionet franceze, ta marrë këtë nisjativë misioni, para se ta kryej Franca pa e përfillur Shqipërinë.

Figurë të letërsisë botërore Ismail Kadarenë e kanë bërë kultura dhe institucionet franceze, që e interpretuan dhe propaganduan, pandërprerë e dendurisht, veprën e tij gjatë një gjysëmshekulli. E përkrahën, e mbrojtën dhe i dhanë strehim politik, kur, në Shqipëri, jeta e tij ishte tepër e rrezikuar. Akademia Morale dhe Politike e pranoi anëtar të saj dhe disa presidentë të Republikës e kanë nderuar me Urdhëra nga më të lartat të shtetit.

Presidenti Emmanuel Macron, në *Fjalën*, që mbajti, në Pallatin e Brigadave, në Tiranë, 17 tetor 2023, pati theksuar: “Që atëherë, nga kryeqyteti i Francës, në kryeqytetin e Shqipërisë ... ju keni ndarë ekzistencën tuaj mes fjalëve dhe gjërave, njerëzve dhe vendeve, në një lëvizje luhatëse mes dy kombeve tona drithma e fundit e së cilës nuk rresht së afruari e së ndërtuari. .... Për këtë rol, si poet i Ballkanit, rapsod i Europës, lajmëtar i lirisë, për këtë lidhje drithëruese, që ju mishëroni kaq çmueshëm mes Shqipërisë dhe Francës, kam nderin, sot, t’ju ngrej në gradën e Oficerit të Lartë, në Urdhërin e Legjionit të Nderit.» Prandaj, ai, tanimë, i përket edhe kulturës franceze dhe vet Francës. Në njoftimin e Zyrës së Shtypit të presidentit Emmanuel Macron, dhe në shumë gazeta, revista e portale informative Ismail Kadareja përcaktohej shkrimtar franko-shqiptar. Edhe në të dhënat biografike qytetaria e tij përcaktohet: shqiptare, franceze, ose, Shqipëri, Francë, dhe anasjellas. Ismail Kadareja ligjërisht e kulturalisht mbetet edhe francez.

Tiranë, 10. 01. 2025

**Kadare: Duke lexuar “Milosaon”, 1963**

**Një shkrim në formatin e Manifestit Letrar**

Nga Ymer Çiraku

Padyshim është shenjë prestigji për çdo letërsi, që në vijimësinë e zhvillimit të vet, të ketë të pranishme “manifestet letrare”, të cilat, janë programe estetike - mbi të cilat projektohen e zhvillohen lëvizje të caktuara letrare. Mund të kujtojmë në letërsi të gjuhëve të ndryshme europiane manifestet e bujshme të romantizmit, të simbolizmit, dadaizmit, futurizmit, hermetizmit, surealizmit etj.

Po në letërsinë shqipe a i kemi të shfaqura këto manifeste - apo programe letrare?

Në revistën e njohur *Albania* (1897-1909), e cila, nisi të dalë nga fundi i shek. 19-të, kishte zënë vendin e vet dhe një rubrikë periodike, e titulluar *Kohëtore e letrave shqipe*, ku vet botuesi i saj, Konica, përmes shkrimeve të veta, konceptoi *modelin kritik* në gjykimin dhe vlerësimin e letërsisë shqipe – përkundrejt *modelit romantik* (kryesisht vlerësues e himnizues) të deriatëhershëm. Po kështu, brenda një vizioni modern letrar, ai apelonte rreth vetmjaftueshmërisë së vlerave estetike për të përcaktuar statusin mirëfilli të letërsisë. *Atdhësia dhe letratyra janë dy gjëra*, do të shprehej dikur Konica dhe me këtë, kishte parasysh se patriotizmi në vetvete nuk do të thoshte asgjë, po qe se ai nuk do të ishte i tretur në inde dhe vlera letrare. Ky koncept ishte një sfidë *ala koniciane* për mjaft shkrime skriptomanësh të asaj kohe e më pas, të cilët, mungesën e talentit, ngreheshin që ta kompensonin (në të ashtuquajturat vepra të tyre) me lumin e deklaratave patriotike (!).

Tërë krijimtaria e një niveli të lartë si ajo e De Radës, mund të konsiderohet gjithashtu një lloj manifesti letrar, që e udhëhoqi në lartësi estetike një degë të fuqishme të letërsisë shqipe, siç ishte ajo arbëreshe. Vepra e tij *Parime të estetikës* (Napoli, 1861), përtej funksionit rutinë të një manuali klasik mbi estetikën, gjente rastin që të konstruktonte me tendencë edhe një argument nga problematika e kulturologjisë shqiptare. Konkretisht, këtu ai sjell në vëmendje pikëpamjen e teoricienëve të linguistikës europiane të kohës se gjuhët në vetvete, janë struktura unike e misterioze dhe se në çdo stad të tyre, edhe në ato më të hershme e me volume sado inferiore strukturore e leksikore, ato gjuhë mund të ngjizin me magmën e tyre shprehëse kryevepra letrare. As më shumë e as më pak, kjo ishte mbështetje teorike, apo një program letrar nxitës - për të marrë guximin, siç e mori vet De Rada e të tjerë autorë arbëreshë, për të bërë letërsi të madhe edhe nën hijen e një dialekti relativisht të kufizuar e arkaik, siç ishte ai arbëresh. Përmes kësaj letërsie, në fakt u mbajt gjallë kjo gjuhë e rrezikuar për shuarje nga rrethanat historike, duke u



bërë kështu krijesa e saj (letërsia) – edhe një rojtare e sigurt e kësaj vijimësie gjuhësore.

Më 1963, kur ishte vetëm 27 vjeç, I. Kadare botonte në gazetën *Drita* shkrimin: “Duke lexuar *Milosaon*”. Duke marrë shkas nga 150 vjetori i lindjes së De Radës, shkrimtari i ri gjente rastin të shprehte disa pikëpamje estetike, që jo vetëm dëshmonin vlerësim të lartë për këtë ikonë të traditës letrare shqiptare, por mbi të gjitha, ajo që ka më shumë rëndësi, është se ato përcillnin apele të forta për aktualitetet letrare në Shqipërinë e saj kohe, madje, që trondisnin nga ato tema e skema, që konsideroheshin tabu. Ajo që vlerësohej guximshëm tek ky autor (De Rada), ishin pikërisht dimensionet e *munguara* apo të *ndaluara* në kontekstin e soc.realizmit në Shqipëri, madje theksoheshin, pikërisht në kohën kur doktrina e realizmit socialist, ishte në stadin e vet më të rehatuar.

Konkretisht, në këtë shkrim, Kadareja e çmonte De Radën dhe vinte theksin në vlerësimin e tij si novatori i madh i letërsisë shqipe, kur aso kohe, autorë si ai, mjaftohej të konsideroheshin kryesisht si kontribues brenda arealit letrar të traditës dhe, sa për novatorizëm, ai nuk mbetej veçse atribut i soc.realizmit (!) Kadare në këtë shkrim mes të tjerash shkruan: “De Rada ishte novator i madh i poezisë sonë dhe novator i poezisë në përgjithësi. Ai e ndjente këtë gjë dhe prandaj edhe romanin e hap me vargje, që pohojnë se ai do të këndohej diçka të re në gjuhën e moçme të poezisë. Dhe vërtet, ai krijoi një gjë të re. “*Milosaon*” është e mbushur me imazhe dhe figura, jo vetëm të panjohura për krejt poezinë tonë, por edhe të freskëta e të guximshme në gjithë poezinë e asaj kohe. Gjëja e parë që të bie në sy tek *Milosaon*, është konceptimi figurativ i botës, një konceptim aq i pasur sa dhe i sigurt, me nuanca ngjyrash, tingujsh dhe emocionesh, që rrallë e kanë shoqen... Të ngjan sikur je shtrirë përdhe, ke vënë veshin mbi tokë dhe po dëgjon zërat e brendshëm e të përjetshëm të dheut.”

Më tej akoma, në atë shkrim, vlerësohej lart fryma universale e kësaj vepre, kur kritika zyrtare trumbetonte për vlerë, para



së gjithash frymën dhe dekorin nacional e lokal të letërsisë. Sipas gjykimit të Kadaresë, në këtë vepër të poetit arbëresh, vrehet një konçizitet, që arrin deri në virtuoizitet dhe madje De Rada, vlerësohet si pararendësi i *parimit të ajsbergut*, i cili do të shfaqej si prirje letrare shumë vite më pas në letërsinë europiane. Dhe ky tipar, vihej në dukje pikërisht atëherë, kur letërsisë shqipe të kohës i imponohej dhe i vlerësohej qartësia e thjeshtësia maksimale e ligjëritimit. “...Ajo që tek De Rada është quajtur *errësim me dashje nga disa studiues, është forca e tij e madhe sintetizuese. Poeti ka lënë në vargjet e tij vetëm muskuj, duke hedhur çdo gjë të tepërt...*”, shkruan autori i këtij shkrimi dhe jo vetëm implikohet i pari në përcaktimin e llojit zhanror të kësaj poeme, duke e quajtur atë të parin roman lirik në vargje në letërsinë shqipe, por edhe si bashkëkohëse të denjë me vepra të njohura të Bajronit, Pushkinin, Lamartinit.

Moderniteti i kësaj vepre vlerësohet prej Kadaresë edhe prej faktit se këtu, ka mjaft koinçizitet dhe përkorje stilistike. Është mënjeluar çdo gjë e tepërt dhe e panevojshme. Poeti ka futur mes vargjeve dhe këngëve “heshtjen”, si një lëx të fuqishëm artistik. Midis vargjeve, lexuesi ndjen dhe vargjet e pashkruar, midis këngëve dhe këngë të tjera të pathëna. Dhe kështu, vepra duket më e madhe dhe më e gjerë se vëllimi real i saj, “ashtu si qyteti që duket më i madh dhe më i papërcaktuar në mbremje, kur ka rënë mjegulla. Pikërisht një fluiditet i tillë i derdhur në vepër, e bën veprën në vargje *Milosaon* të gjallë, me shpirt”.

Duke pohuar se kjo vepër *hyri në pallatin e poezisë si një vajzë e bukur dhe e freskët, por mjerisht e belbër dhe nga një vend i humbur*, shkrimtari i ri shtronte indirekt kërkesën për t’i dhënë zë letërsisë shqipe, në kontakt me publikun botëror, dhe kjo mund të bëhej përmes veprave të verifikuara si vlerë nga lexuesi dhe jo atyre të rekomanduara nga institucionet zyrtare. Duke e çmuar këtë vepër, që vinte nga bota arbëreshe e përtejdetit si një trajtë mirëfilli artistike, Kadare e konsideronte atë edhe si urë të mbarë komunikimi mes kësaj ane d.m.th. letërsisë shqipe - dhe metropolit perëndimor kulturor e letrar. Pra, këtu ai takohej (si mes të mëdhenjve) me tezën që kishte hedhur vite më parë E. Çabej, se letërsia arbëreshe, ishte lëndë ballkanike (shqiptare) e derdhur në formë romane, pra, një letërsi që stilistikisht, e kishte kapërcyer periferinë dhe mbetej e hapur dhe e ballafaquar me artin europian.

Ky shkrim-manifest, me tërë spektrin e ideve qarkulluese në të, ishte atakues me atë arsenal sofizmash që përmbante programi zyrtar i kohës për letërsinë, që tek e fundit, e limitonte rolin dhe misionin e saj kryesisht brenda domeneve të propagandës. Duke shqyrtuar veprën *Këngë të Milosaos*, si poema për dashurinë dhe lumturinë, për iluzionet dhe humbjet, për dritat dhe hijet, për riprodhimin njerëzor, për vazhdimësinë e jetës, Kadareja i kujtonte lexuesit dhe opinionit imperativin për të mbrojtur statusin natyral të letërsisë. Pra, përcillej si nëntekst prej tij kërkesa, që letërsia s’ duhej kurrsesi t’i braktiste, apo t’i dobësonte strukturat e saj artistike, që në fakt, ishin aq të rrezikuara në rrethanat e asaj kohe.

Këto vizione emancipuese dhe refuzuese ndaj deformacionit dhe stanjacionit estetik, nuk mbetën brenda kornizave të një shkrimi në trajtë projekti letrar, por edhe u realizuan, u ngjizën në veprën e vet Kadaresë, në një vepër polifonike dhe me një ligjërim tejet modern dhe elegant, që i solli lexuesit shqiptar dhe atij botëror. Duke marrë prej këtij lexuesi të afër 50 gjuhëve, ku është botuar dhe ribotuar vepra e tij, vlerësimet të larta.

Në përmbyllje, mund të thuhet se ai shkrim i Kadaresë i vitit 1963, edhe pse nuk vrehet të jetë përmendur si referencë në qarkun tonë letrar, (thua sikur të mos egzistonte ndonjëherë), mbetet një shenjë e fortë në rrugën e letërsisë shqipe të pasluftës. Temat (çështjet) e nxehta estetike, që ishin artikulluar në të, në fakt, qenë *sirena*, që grishnin krijuesit e kohës - për ta mbajtur letërsinë sa më fort në *limanin* (territorin) e saj autentik.

Disa autorë shprehen se librat e tyre janë, në fakt, copëza, fragmente të një libri të vetëm, unik. A mund të pyesim nëse zhanret specifike të përdorura nga ju konfigurjnë ndonjë qëndrim tepër unifikues të tyre?

Kjo është një pyetje që rrallëherë mungon në intervistat, ndaj për autorët duhet të jetë e mërzitshme. Nuk më ka shqetësuar kurrë problemi nëse plotësoj të njëjtin libër. Gjithçka varet se nga ç'kënd pamjeje e sheh aventurën e të shkruarit. Nga një kënd tepër i largët, pra i epërm, pra nga një lozhë tepër e lartë, nuk është ndonjë befasi që jo vetëm librat e një autori të duken si të ishin një libër i vetëm, por gjithë librat e një kohe, të një populli, madje të gjithë kohërave e të gjithë popujve. Ne, në thellësinë e ndërjegjes sonë, e dimë këtë gjë, por ose nuk duam ta pranojmë, për të mos prishur një drejtpeshim të kahershëm, të vendosur nga tradita, shkolla ose nga përtacia jonë, ose kemi frikë prej saj, si nga një kataklizëm.

**Është tashmë e konsakruar (pas kaq dekada leximi dhe breza lexuesish) distanca juaj ndaj realizmit socialist. Në cilin lloj "religjioziteti" mund të punojë një autor që jeton mes dy sistemeve të kundërta dhe të vërtetë njëkohësisht kurajën e të qenit autor ndërkombëtar?**

Mendoj se ndoshta gjithçka varet nga mosha kur ti tërhiqesh prej letërsisë. Duhet të jetë ndryshe kur kjo ndodh kur je 12 vjeç, si më ka ndodhur mua, e ndryshe duhet të jetë 16 vjeç ose 32 vjeç.

Në rastin tim, bota nisi të ndahej në dy pjesë: në të mërzitshmen dhe në tërheqësen. Pjesa e mërzitshme e jetës sa vente më dukej edhe më e mërzitshme, madje e kotë dhe e panevojshme. Tjetra, ajo që ishte tërheqëse, që pa dyshim kishte lidhje me letërsinë, më dukej përherë e më e magjishme.

Ky radikalizim po më çonte një ditë drejt asaj që të habiteste me njerëzit që nuk merreshin me letërsi. Për mua ata ishin fatkëqij e të pashpëtueshëm.

Pas një gjendjeje të tillë nuk përbën asnjë problem distanca, ndarja me një doktrinë, si ajo e realizmit socialist. Përpara se të ishte e keqe (unë këtë s'e kuptoja kurrësesi), ajo ishte thjesht e mërzitshme. Në përgjithësi, socializmi ishte tepër i mërzitshëm, por për këtë nuk kam dëgjuar të flasë njeri seriozisht.

Kam mbaruar dy shkolla të larta dhe asnjëherë nuk e kam vrarë mendjen thellë për ato që mësoja për krijimin letrar. Për mua bota vazhdonte të ndahej gjithmonë në dy sfera: e artistikueshme (e romanizueshme, ose e poetizueshme, po të na lejoheshin këta terma) dhe e kundërta: aspak e tillë.

Kjo që thashë është baza e gjithçkaje. Të tjerat kanë rëndësi të diskutueshme.

Do të përsërisja diçka që e kam thënë ndoshta disa herë: Kur jam magjepsur pas letërsisë nuk e njihja lirinë. Kur je njëmbëdhjetë ose dymbëdhjetë vjeç kjo është e natyrshme, problemet e lirisë as nuk i kupton, as të interesojnë. Është letërsia që më ka çuar te liria, jo e kundërta. Kjo ka qenë rruga më e natyrshme.

**Në çfarë mase dhe si është i mundur transpozimi i epikës – një zhanër kolektiv dhe gati anonim – në një autorësi individuale të suksesshme, d.m.th. vetërealizimi në stil.**

# Një intervistë e pabotuar KADARE: Shkrimtari e ka një pjesë të jetës së tij pikërisht pas mbarimit të saj, domethënë në vdekje. (Ajo që në mënyrë emotive quhet pavdekësi.)

*Bisedoi Alketa Spahiu*

Besoj se nuk ka ndonjë kundërthënie në këtë transpozim. Gjinia kolektive përfshin vërtet mijëra autorë, por ky nuk është ndonjë avantazh për të. Është, përkundrazi, një pengesë. Meqenëse letërsia, ndërsa mbron në çdo rast demokracinë, ajo vetë nuk është demokratike, shkrimtari-individ ka gjithmonë përparësi mbi autorësinë kolektive.

**Si lexues tepër i hershëm i Shekspirit, cila është "fantazma" që del më shpesh në narracionin tuaj? Dhe çfarë figurash letrare mendoni se i lënë vendin njëra-tjetrës pas shumë vitesh krijimtarie dhe pas ndryshimeve të forta gjeopolitike të Shqipërisë dhe vetë botës.**



Fantazmat, ëndrrat, gjendjet transendentale sa ç'janë të pazakonshme në jetën e përditshme, aq janë të

zakonshme, si gjendje të natyrshme të letërsisë. Ato janë veglat tona të punës, që nuk i hyjnë në punë asnjë makine tjetër, veç makinës së letërsisë.

Fantazmat te Shekspiri kanë një pasurim, një ngritje niveli, në krahasim me hijet e mëparshme. Te *Hamleti*, te *Makbethi*, te *Jul Cesari* sidomos, ato i afrohen një fantazme të një tipi, të një misterit të ri. S'është fjala kryesisht për vrasje ndërjegjeje të mirëfilltë si te hija e Klitemnestrës, një nga të parat fantazma në letërsinë botërore (tek *Orestia*), por për krime të ndërlikuara, për çështje fronti, pushteti. Pra, gati-gati jemi përpara fantazmës politike.

Fjala politike do të më dukej varfëruese për letërsinë, veç në rastin e fundit, këtij që po flasim, fantazmës. Vrasjet politike, rrjedhimisht fantazmat, kanë një fuqi tronditëse për kohën. Rendi komunist, ndërsa varfëroi çdo gjë, e rriti frymën e tyre tronditëse. Jam përpjekur t'i përdor disa herë në veprat e mia.

**Një lloj trishtimi është shpesh atmosferë në librat tuaj, por pa qenë saktësisht një bezdi (ennui) përfundimtare. Shpesh vdekja në librat tuaj u kundërvihet realizmave falsë e shterpë. Në këtë mënyrë, mund të themi se shpesh te ju vdekja është mekanizëm i aksionit, i verbit. Çfarë motivesh mund ta mendojnë një gjë të tillë dhe në ç'mënyrë shkojnë ato drejt një libri?**

Do apo nuk do shkrimtari, vdekja bën pjesë në dosjen e tij. Nuk ka në këtë shprehje asgjë patetike. Është në radhë të parë një çështje që lidhet me vetë mjeshtërinë, me thelbin e të shkruarit. Lidhjet me të janë të natyrshme. W's'ka asgjë vanitoze ose turpëruese në një pohim të tillë. E kundërta do të ishte ashtu. Shkrimtari që nuk do t'ia dijë nëse letërsia e tij do të rrojë apo jo, mund të dyshohet për një pragmatizëm të tillë, që çon te mungesa e çdo skrupulli. Përparësia e letërsisë, e artit dhe e çdo krijimi vlerash shpirtërore, qëndron pikërisht te lidhjet e tij me të ardhmen. Ato nuk mund të jenë veç shpirtërore, pra idealiste.

Nuk po zgjatëm te raportet e tjera me vdekjen, ato që, sado e çuditshme të tingëllojë, mund të quhen të sferës teknike. Është fjala për teknikën e të shkruarit. Rituale mortore kanë dëshmuar lidhje të tilla qysh nga koha e teatrit antik. Kam shkruar për këtë në një sprovë për teatrin e Eskilit.

Alketa Spahiu

**KADARE,  
bashkëkohës i epikes**

Onufri



## Dy fjalë për lexuesin

Ky vëllim përmbledh disa shkrime që këto vitet e fundit i kam kushtuar veprës së Ismail Kadaresë. Bëhet fjalë kryesisht për kontribute të rastit, si parathënie romanesh a kumtesa të mbajtura në konferenca shkencore, si edhe një hyrje që ka shoqëruar botimin kritik të dorëshkrimit të romanit *Dimri i vetmisë së madhe*. Me rastin e botimit të këtij libri të gjitha tekstet janë ripunuar, plotësuar dhe zgjeruar. Vlen të theksohen këtu ripunimet e parathënieve të romaneve *Kështjella* dhe *Ura me tri harqe*, të cilat po i risjellim në një trajtë të re, krejt të ndryshme nga ajo origjinale dhe më afër natyrës së studimeve kritike, çka dëshmon synimin hermeneutik për të vënë në pah disa tema specifike të poetikës së Kadaresë. Pikërisht këtij synimi i përgjigjet kreu i parë i kësaj përmbledhjeje, që jo rastësisht mban titullin *Sprovë për një interpretim diakronik të veprës së Ismail Kadaresë*. Një version i parë i këtij studimi u botua në vitin 2018 nga shtëpia botuese Onufri me rastin e tetëdhjetë vjetorit të shkrimtarit shquar, ndërsa një version i dytë u përdor në vitin 2021 si hyrje e përgjithshme e botimit të veprës së plotë në tetë vëllime të Kadaresë, përgatitur me kujdes të posaçëm nga botuesi Bujar Hudhri. Në të dyja rastet teksti iu nënshtua ripunimeve pak a shumë të thella që pasqyrohen në versionin përfundimtar të përfshirë në këtë vëllim. Një nga ndryshimet ka të bëjë me vendimin për ta ilustruar tekstin me disa piktura të Bashkim Ahmetit Izanos. Arsyeja e këtij kombinimi nuk është vetëm një homazh për talentin artistik të këtij piktori të jashtëzakonshëm, por edhe kontributi hermeneutik që "leximi" i tij i prozës kadareane i jep analizës tekstore dhe vetë teorisë së letërsisë. Personifikimi koherent dhe i vazhdueshëm me të cilin paraqitet prania e autorit në veprë sanksionon një pikëpamje interpretuese që theksohet nga një përsëritje e vazhdueshme, e cila pikërisht për këtë arsye përjashton çdo dyshim rastësie. Në të vërtetë Ahmeti Izano te romanet e Kadaresë ka rrokur ndoshta më mirë se shumë studiues të letërsisë atë anë të padepërtueshme dhe enigmatike që e bën të veçantë prozën e Ismail Kadaresë, atë anë që e përfshin atë plotësisht në një optikë moderniste dhe në një linjë me prirjet e narrativës bashkëkohore. Për këtë arsye e kam përmbysur enkas perspektivën ekfrastike, duke i vënë zbulimet spekulative të artit pamor në shërbim të hermeneutikës letrare.

Nga ana e tyre, dy studimet me natyrë filologjike që u shkuan, përkatësisht, i pari, për një botim të ardhshëm kritik të *Nëpunësit të pallatit të ëndrrave* dhe i dyti, për të trajtuar problemet e përkthimit italisht të veprave të Kadaresë, përbëjnë një përjashtim, pasi bëhet fjalë për shkrime që e morën shkas nga dy konferenca shkencore. Studimi i parë bën pjesë në një projekt në zhvillim e sipër i cili, falë një sistemi përpunimi informatik, synon të nxjerrë në dritë variacionet tekstore në botimet e ndryshme të të gjitha veprave narrative të Kadaresë. Qëllimi kryesor është vlerësimi kritik i këtyre ndryshimeve tekstore, si edhe identifikimi i arsyeve që e shtynë autorin t'ia hyjë, sidomos pas

NË PERIFERINË  
E ISMAILANDIT

Nga Matteo Mandalà

ndryshimit të kontekstit politik që pasoi rënien e regjimit totalitar në Shqipëri, një rishikimi të gjerë dhe sistematik të veprës së tij narrative. Studimi i dytë, duke identifikuar te përkthimet një nga arsyet e jashtme të suksesit të veprës së Kadaresë në Itali, analizon në rrafshin diakronik ndërmjetësimet e ndryshme gjuhësore dhe vë në pah meritat dhe të metat e tyre.

Kreu i fundit është ripunimi i një kumtese të mbajtur në konferencën e organizuar më 28 janar 2022 nga Akademia e Shkencave me rastin e ditëlindjes së Kadaresë. Meqenëse në atë tubim u paraqit botimi shqip i librit *Kadare - një disidencë letrare* të mikut Jean-Paul Champseix, një ndër studiuesit më të mprehtë të veprës së shkrimtarit të shquar, e pashë me vend të parashtroja në vija të përgjithshme disa çështje themelore të poetikës kadareane, të cilat do të shtjellohen gjerësisht në një monografi që do të botohet së shpejti.

Idea për t'i mbledhur bashkë këto studime shpjegohet qysh në titullin e vëllimit, i cili është menduar si një homazh për shkrimtarin e madh shqiptar, në kujtim të takimeve dhe telefonatave të shpeshta që kanë

shoqëruar marrëdhëniet tona personale dhe profesionale. Duke filluar nga takimet e para sporadike me raste ngjarjesh përkujtimore publike, si njëqindvjetori i vdekjes së Jeronim De Radës (1903-2003) ose akordimi i titullit *Doktor Honoris Causa* nga Universiteti i Palermos në vitin 2009, deri te takimet e shumta kryesisht private të këtyre dekadave të fundit, mbeten të pashlyeshme mbresat dhe përshtypjet që më ka lënë mprehtësia dhe thellësia e mendimit të Ismail Kadaresë. Le të vlejë ky homazh modest i një lexuesi të tij si shenjë mirënjohjeje *post mortem*.

\*\*\*\*\*

Duke dorëzuar për shtyp këtë libër, më duhet të shtoj se niveli i lartë i shqipërimin të këtyre teksteve është meritë e mikut dhe kolegut Gëzim Gurga, të cilit i jam mirënjohës për sensin e spikatur të maturisë dhe pjekurinë e gjykimit mbi çështje të ndryshme albanologjike, përfshirë interpretimin e veprës kadareane. I jam gjithashtu mirënjohës edhe Bashkim Ahmetin Izanon, që më autorizoi të përdor pikturat e tij për të ilustruar librin.

Hora a Arbëreshëvet, dhjetor 2024

## Matteo Mandalà

## Në periferinë e Ismailandit



## In memoriam Ismail Kadare

Onufri

PËRSIAT JE MBI NJË  
VEPËR PËR MODELIN  
MË TË BUKUR TË  
FJALËS SHOIFE

Nga Andreas Dushi

Qysh student kam pasur fatin të kuptoj se në shumëpërmasshmërinë e saj vepra e Kadaresë zbërthehet më së miri nëpërmjet studimeve të profesor Matteo Mandalà-së, duke gjetur ndër këto studime çelësa leximi që më kanë shoqëruar përgjatë gjithë formimit tim dhe vazhdojnë edhe sot, si model për mënyrën që duhet ndjekur në laminë e studimeve filologjike. Te profesor Matteoja më ka mahitur përherë njohja e thellë e shqipes dhe gjithë paradigmat të saj, nga çasti kur ajo zë fill deri në konsolidimin e vonë. Për këto dy arsye dhe jo vetëm, u ndjeva i nderuar prej befasisë së bukur të telefonatës së tij në të cilën më kërkoi të shkruaja këto pak fjalë për veprën "Në periferinë e Ismailandit".

Dëshira e profesor Matteos për t'i përmbledhur studimet e

deritanishme mbi Kadarenë në një libër vjen si një prej gurëve kilometrikë të një pune shumëvjeçare që vazhdon ende, ku trajtohen problematikat kryesore që kjo veprë ka ngjallur dhe mund të ngjallë si në interpretim prej studiuesve, ashtu edhe në lexim prej lexuesve. Profesori kështu arsyeton se si *Ismailandi* nuk është një truall i veçuar diku larg, por pjesë e oqeanisë së narrativës bashkëkohore dhe Kadareja jo vetëm pjesë e saj, por akoma më shumë: një përfaqësues i rëndësishëm i tipareve që i jep kësaj narrative veçanësinë e vet.

Marrja në secilin kapitull ose e një veprë përfaqësuese nga krijimtaria e Kadaresë, ose e një problematike sikurse, për shembull, përkthimi i tij në gjuhën italiane, i jep këtij libri që keni në dorë një natyrë enciklopedike që arrin të nxjerrë në sipërfaqe dhe të vështrojë çështje të kompleksitetit gjenial që personaliteti letrar i Ismail Kadaresë ngërthen brenda vetes. Prandaj, kështu më forcohet edhe më tepër bindja se e mira më e madhe që fati mund t'i rezervojë një shkrimtari është të ketë një studiues si profesor Mandalà-ja për veprën e tij.

Por jo vetëm kaq. "Në periferinë e Ismailandit" është shembulli se si, nëpërmjet qasjeve sinkronike dhe diakronike, mund të vështrohet krijimtaria e një shkrimtari si shprehje estetike dhe njëkohësisht, si ravijëzim edhe i vendit të atij shkrimtari në historinë e letërsisë, po ashtu i mënyrës si historia kombëtare dhe historia letrare komunikojnë njëra me tjetrën.

Me këtë veprë, profesor Matteo Mandalà na siguroi sërish se është më i zoti ndër topografë për krijimin e një harte të *Ismailandit*.

Shkodër, janar 2025

Romani *Çështje të marrëzisë* dhe tregimi *Kisha e Shën Sofisë-murale* pikëtakohen për filtrin e përpunimit artistik të shpërfaqjes së përkatësisë së krishterë të shqiptarëve. Rrafshi i substancës së përmbajtjes e bart këtë problematikë të rrafshit identitar në tri shtresa historike: e para, te *rrënjët e hershme identitare kristiane*; e dyta, një cak i një *gjendjeje të ndërmjetme*, që lidhet në më të shumtën e herës me konvertimin, gjendje që bashkë me luhajat e mjegullitë do të bartë me vete tharmin e ringjalljes, e lajmërimit të rimishërimit të krishterimit (e treta), siç i shkon për shtat simbolikës së Shën Markut, jo më kot përzgjedhur nga Kadare në simbologjinë e miteve biblike.

Përkatësia religjioze e identitetit shqiptar del në pah nga loja rrëfimore e personazheve që i sendërtojnë ato estetikisht. Të dyja veprat e zbulojnë mekanizmin e kthjellimit të perspektivës historike nëpërmjet procesit të analizës psikologjike të personazhit: fati i personazhit vendoset në kushtet psikanalitike të anomalisë, duke kërkuar dhe gjetur shpjegime në rrafshin e fatit identitar të rrjedhave të historisë shqiptare. Nga pikëpamja e realizimit formal, përvijimi i dukurisë së shpërfaqjes së përmasës kristiane shpërfaqet herë e mbështjellë me trajta simboliko-alegorike e të aluzionit, me një petk mistik, te *Çështje të marrëzisë*, e herë përmes introspeksionit te *Kisha e Shën Sofisë*.

#### Udhëtim në viset psikike të marrëzisë

Dy rrëfimet kadareane sendërtojnë një gjendje të turbullt, të amullt, deliri e mëdyshëse për të realizuar më pas kalimin në alegorinë e ringjalljes së shtresave të thella të kujtesës, një konstelacion shenjash, me forcë graviteti drejt qendrës së përbashkët të përkatësisë religjioze. Një gjendje e vagullt, dehëse dhe e ëndërrt, plot shëmbëltime e fanepsje simbolike karakterizon rrëfimitarin gjimnazist të *Çështjeve të marrëzisë*, i cili si në terapi psikanalitike nyjëton forma ligjërimore mes hapsanës së prekshme, që kishte ndryrë histori të lashta e të reja dhe të fshehtë mistike të mjegullta dhe të padukshme. Nga sytë e tij, duket se do të zbardhet misteri mbi vëllanë e Babazotit, të cilin nuk e kishte parë askush; për të nuk flitej, por edhe kur zihej në gojë, kjo ndodhte me zë të mekët e fare shkurt. Procesi i zhvendosjes ndodh në një rrafsh psikanalitik të interpretimit të ëndrrave, gjendje që karakterizon personazhet e të dyja veprave. Frojdi na kujton se përgjigjet që personazhet kërkojnë në anomalitë e marrëzisë dhe artit, janë përgjigje që lexuesi, nëpërmjet mekanizmit të zhvendosjes, kërkon dhe gjen në rrafshin e historisë. Përgjatë një zinxhiri asociativ hasen dy raste të shkëmbimit të shprehjes gjuhësore dhe i njëjti proces zhvillohet në nivele të ndryshme psikike. Si rezultat i kësaj zhvendosjeje ndodh: *zëvendësimi* i një elementi me një tjetër ose *shkëmbimi* i formulimit verbal të një elementi me atë të një tjetri (S. Freud, *L'interpretazione dei sogni*, Edizione del Kindle, p. 388-389).

Filli i rrëfimit romanit *Çështje të marrëzisë* mund të kapet nga dy faqet e fundit të veprës e të ndiqet për kah fillimi duke ndjekur e shpleksur gjithë dëshpërimin që ka pllakosur të pranishmit për ikjen nga kjo jetë të Babazotit, rrëfyer me dromca humori dhe autoironie, naiviteti fëmijëror dhe ngjyresa mistike, ku duket se për t'i dhënë lamtumirën e fundit të vëllait, merr pjesë edhe Dom Zef Dobi, dalë si nga një kohë-hapësirë tjetër, me zhgun të zi e me kryq të madh në kraharor. Kjo linjë e zbehtë rrëfimore nyjëton linjat e tjera të romanit, ndodhi të pazakonta e të mistershme mes personazhesh që shtegtojnë nga një vepër në tjetër (Iliri, Babazoti, Nesibe Karagjozi, hallë Xhemoja, Shtinot, Kokobobot etj.) në një qytet e kohë të marrësh, mes njerëzve

## Çështje të marrëzisë dhe Kisha e Shën Sofisë: vepra-alegori të ringjalljes së religjionit


Nga Lili Sula

që jetojnë në dëshpërim, pezëm, broçkulla, habi, mëri të mbartura si ajo e Zekatëve me Babametot mbi treqindvjeçare, qysh nga koha kur këta të fundit kishin qenë të krishterë e të tjera përthyerje të forta ideologjike vetjake, familjare e shoqërore. Të çuditshme, plot me marrëzi e befasi dhe shëmbëltime shfaqen të gjitha situatat, të errëta, të ngatërruara dhe enigmatike, prej syve të djaloshit që rreket t'i shpjegojë nga një pikëvështrim naiv, që përlligj pëshjtjellimet e kohëve dhe personazheve të historisë me ato familjare. Dom Zef Dobi nuk kishte bërë asnjë turp për të qenë i mbuluar me mister, thjesht ai jetonte gjithmonë larg, në veri të Shqipërisë, i veçuar nga njerëzit, që janë si "të lojtur mendsh"; ai mban një tjetër gjuhë e një tjetër fe, në shprehje të ruajtjes së identitetit parak. Një degë e trungut të Dobatëve kishte mbetur katolike, siç kishte ndodhur edhe me disa shtëpi të tjera...

Në prozën tjetër, *Kisha e Shën Sofisë*, zëri i narrativit të gjithëdijshëm ndërkallet me zërin e arkitekt Arhond Kaur efendiut. Arkitekt Kauri që thirret *efendi*, shpreh një lloj hibridizimi në rrafshin asociativ, të përafrimit të një trajte të krishterë dhe një myslimane, përfiguruar në zanafillën e tij biologjike, njerëzore, e profesionale sa dhe në përcaktime, të tilla si: *deledash, sanatadita, dykaks, midisë*.

*Edhe dyzet e dy orë, tha me vete arkitekt Kauri. Ishte i shtrirë në shtratin e fortë, as i fjetur, as i zgjuar. Ca pamje, me të cilat fare lehtë mund të ndërtohej një ëndërr dhe po aq lehtë të rrezohej, i rrinin në sy. Përpigjej të merrte me mend se cilat ngrehina ishin rroposur ndërkaq dhe çdo të shkatërrohej ende...* (I. Kadare, *Kisha e Shën Sofisë*, Onufri, 1999, f. 83-84).

Gjendjet mëdyshëse të paralajmëruara që në datëlindjen e arkitektit, në përkatësinë gjinore të tij sa dhe në dilemën midis zbatimit të urdhrimit të sulltanit për të kthyer *kishën në xhami*, si mekët që s'do mund të shlyhej kurrë apo ruajtjes së përkatësisë fetare katolike të arkitekt Arhondit, krijojnë tension narrativ në tregim, botuar më 1994-



n, në vite të diskutimeve dhe ndryshimeve të fuqishme politike e kulturore. Ndërkaq, forma hibride shfaqet qartazi tek emërtimi i personazhit arkitekt Kauri, mishërim i procesit të konvertimit, i cili në gjendje deliri e makthi u vu para provës së ndërrimit, të shkulljes së krishterimit – për të propozur rrënjësisht *Kishën e Shën Sofisë*, që të ngadhënjejë islamizmi, një nyjëtim mes ligjërimin verbal dhe asaj bote shndërrimesh simbolike të kondensuar në një imazh të shumëfishtë vlerash.

*Roja e arkitektit u shfaq me fytyrë të llahtaritur.*

– Arhond, arkitekt efendi, sovran i kërkon.

Mëdyshjet e arkitektit mes kryerjes së urdhrimit dhe përkatësisë së tij kristiane, që ia vështirëson përmbushjen e detyrës, vihen në sfond të gjindjes, shikimet e së cilës e përcillnin me kureshtje (për shfaqjen e rrallë teatrale e, mbase më unikale, të konvertimit), dashakeqësi apo mosbesim (për sfidën e ndërmarrë nga një i krishterë katolik). Përveç atyre që mezi ç'prisnin që tempulli të ndërronte shpirt, dalloheshin dhe ata që luteshin se më mirë Kisha të rroposej fare sesa të shndërrohej në xhami. Gjenden në këtë sfond edhe të tjerë njerëz që duket se s'dinin ç'të bënin: *të gëzoheshin që s'u shemb apo të brengoseshin për përdhosjen*.

#### Zhvendosja në rrafshin e anomalisë historike

Realizimi plastik i idesë, në vepër është alegorizimi i përmasës fetare në sistemin e marrëdhënieve mes dy botëve që krijon vepra dhe që korrespondojnë në nivel narrativ me një rrjedhë të dyfishtë e të shumëfishtë kodimi e leximi prej alegorisë e anasjellas.

Te *Çështje të marrëzisë*, një nga mënyrat e depërtimit në kohët kristiane shënohet përmes njësive ndërtekstore që integrohen në rrëfim dhe bëhen motiv eksplorimi për rrëfimitarin, duke u kundërvënë me forma standarde të realitetit imponues e të dhunshëm të periudhës së diktaturës. Cilësori në trajtën gege e *mnershme* e patër Anton Harapit, një *tingëllim dyfish madhështor* verbal e muzikor – që kundërvihet me fjalën standarde e *tmerrshme që kishte përdorur Tito* në shenjë force e dhune politiko e shtetare – zgjon bashkëshoqërime kristiane të gjurmëve artistike, religjioze e kulturore, të kontributit

të klerit katolik në Shqipërinë e Veriut, të asaj zone të vendit që i pat mbijetuar më së shumti trysnisë së konvertimit prej praktikave të ligjërimin në shërbesa fetare e njëherësh *lavrimin* të saj si gjuhë librore e kulture identitare, po pikërisht në atë skaj verior që kishte mbështjellë me mister largimin dhe jetën e izoluar të Dom Zef Dobit.

Misteri i historive familjare, i figurës së Dom Zef Dobit dhe gjithë ai entuziazëm popullor, që vërshonte rrugëve dhe institucioneve (ndërkohë që *hebrejka* e bukur Graciela Jokoel, si shëmbëllim i Helenës së Trojës për të cilën ishte bërë gjithë ajo luftë e *mnershme* largohet, kthehet për në Izrael) e mbushte me shpresë djalin rrëfimtari, që strukej në mbretërinë e vet, njëfarë kthine e veçantë, *gjysmë dhomë e gjysmë mesore, midis* dy kateve e bashkë me llirin ishin zotër që sajnin kalin e drunjtë për t'i ngrënë kryet Trojës.

Nga ana tjetër, tejqyra e gjyshes për të vështruar të gjallët e varrezat e Vasilikoit, do të zhbirilojë në thellësi ligjërimore alegorike kujtime të fuqishme të kodeve ikonografike të njohura për të bashkuar në një rrjet të gjitha dijet e për të fiksuar, në këtë mënyrë, disa vlera që transmetojnë kujtesën e një kulture, atë gjuhë të shenjtë që po hiqej nga shkollat e fëmijët s'do kishin më mundësi të mësonin. S'do të mësonin më *latinisht*, gjuhën sakrale, as *frëngjisht*, shenjuesen e identitetit perëndimor, ndërkohë, që *greqishtja e vjetër* ishte hequr prej kohësh e tashmë të gjitha këto ishin zëvendësuar me *rusishten* dhe "Britmat: rroftë gjuha ruse! rroftë Stalin! dëgjoheshin përherë e më shpesh", ndërkohë që gjëmonin thirrjet *poshtë papa i Romës*.

Një sferë kodesh që lidhet me religjionin, periudhën antike, ligjërimin sakral e mitologjik, që depërtojnë thellë në kohëra të hershme politeiste e në ato të besimit të mëparshëm, simbolizuar prej Dom Zef Dobit dhe jehonave religjioze, kulturore e ideologjike të procesit të konvertimit, siç i aludon në çelësa psikanalitike Domi të nipit, "...të gjithë ne kishim vlarë diçka ose dikë dhe e kishim mbyllur pastaj thellë..." – një përthyerje identitare midisëse, në rrafshin ligjërimor *edhe...edhe* për t'u mbushur me realitetin socio-ideologjik të shtetit totalitar të ndryshimeve, mohimeve, përthyerjeve ideologjike, fetare e kulturore në nivel individual, familjar, social e institucional. Edhe pse në plan të përkatësisë së besimit fetar, ruhet një vatër thuajse misterioze në Veri me Dom Zef Dobin, ndihet asgjësimi i imponuar, ateizmi, për t'u kapërthyer me përmbysjet politike që ndryshojnë kahun nga Perëndimi në Lindje, që na përçohet përmes instrumentit muzikor, të *vijës melodike të violinave* që bien natën nën ritmin e *librave turqisht*, që lexohen ditën (*Çështje të marrëzisë*, Onufri, 2009, f. 115).

Në rrëfimin *Kisha e Shën Sofisë-murale* arrihet një tjetër kulm i ligjërimin simboliko-alegorik me ngjyra religjioze e njëherësh aluduese mbi këto ndryshime, shenjat e të cilave i mjegullon rrëfimi mbi një prej kryeveprave të artit religjioz dhe njëherësh shenjues i lulëzimit dhe rënies perandorake. Ndërsa për Shën Sofinë, dilema e arkitektit sendërtohet alegorikisht në frymën e shenjtë të figurave biblike, që nuk ia pret kush rrugën qiellore, të rrënjëve që mund të mbulohej, por jo të shndërrohen: *Përveç atyre që mezi ç'prisnin që tempulli të ndërronte shpirt, ishin ata që luteshin që më mirë të rroposej se të kthehej në xhami, e të tjerë që s'dinin ç'të bënin, të gëzoheshin që s'u shemb apo të brengoseshin për përdhosjen* (*Kisha e Shën Sofisë*, f. 90).

Edhe lysterja e mureve të kishës me gëlqere të tejpushme, që lejonte të përtejmen të ishte po aty me frymë e figurë, si qe në krye të herës, përmes simboleve biblike të *Krishtit, nënës së tij, kurorës* dhe *plagës së kryqëzimit*, përcjell përfytyrimin e

rrënjëve që mbulohen përkohësisht po nuk shpërbëhen sa dhe thirrjen për ngadhënjim mbi fazën tranzitore të konvertimit – ringjallje të krishterimit – e rikthim në identitetin e besimit të parë.

Walter Benjamini teksta flet për *veprën e artit në epokën e teknologjisë*, thekson karakterin unik të objektit estetik, që na shpie pas në rrënjët magjiko-simbolike. Çdo rifunksionalizim e distancon të riprodhuar nga sfera e traditës dhe e përditëson atë duke vendosur “një seri sasiore ngjarjesh në vend të një ngjarjeje të vetme, duke bërë të mundur që objekti i riprodhuar të takohet me personin që e përdor atë në situatën e tij të veçantë... gjë që çon në një përmbyse të dhunshme të traditës”, e nga ana tjetër, shpreh krizën aktuale (W. Benjamin: *L'opera d'arte nell'epoca della sua riproducibilità tecnica*, Einaudi, 2000, p. 23). Me fjalë të tjera, ajo që mungon në objektin e riprodhuar është *aura* e veprës artistike, *originaliteti* i saj përkundrejt përdorimit të imponuar të riprodhimit. Shkatërrimi i aurës së veprës së artit synon shkëputjen e saj nga tradita dhe integrimin në një tjetër traditë të huaj, e cila mund të zgjasë edhe pesë shekuj, duke mbetur gjithëherë e përkohshme.

*Lëndimthi ata kalonin furçat me gëlqere mbi fytyrën e Krishtit e të nënës së tij. Por gëlqerja ishte aq e hollë, sa që pas tharjes, rishfaqeshin, në krye, kurora me gjemba, që dukej se e griste e para pengesën, pastaj plagët e kryqëzimit e pas tyre gjithçka. Mjeshtrit vinin për t'i kumtuar me pyetjen e heshtur në sy: a do ta trashte, më në fund, gëlqeren?... Tani Krishti dhe Shën Mëria dukeshin si prapa një hukatjeje në qelq (Kisha e Shën Sofisë, f. 94).*

*Kisha e Shën Sofisë* për t'i dhënë peshë të posaçme ligjërimin që karakterizon krizën e identitetit në fazën e konvertimit si pararendës dhe shkak qenësor i kësaj krize, njëherësh thërret rrënjët më të thella identitare. Arti i Kadaresë, i referohet një gjendjeje “arkaike” antropologjike për të na çuar në thellësi të kohës njerëzore. Ajo që merret nga bota e jashtme, sendërtohet në konstelacion shenjash simboliko-alegorike, për të kondensuar në një imazh të shumëfishtë vlerash përfytyrimin e një përkatësie shpirtërore.

*Shumica, ashtu siç pritej, e kishin kuptuar këtë ndërrim si ngadhënjim të islamizmit. Një pjesë, më e vogël, përkundrazi, si qëndresë të krishterimit. Kurse disa të paktë kishin kapur në të një kumt të ri: kapërcimin e të pamundurës... Së fundi, e kishin kuptuar se e gjithë kjo ishte e kotë dhe asgjë s'mund t'i shkulte as dyshimin, as pyetjen nëse të dyja fetë e mbyllura në të njëjtin burg do të jetonin të dyja apo do të vdisnin të dyja (Po aty, f. 94).*

Në këtë udhëtim të shkurtër në linjën rrëfimore religjioze me Dom Zef Dobin e arkitekt Kaur efendiun, na përcillet thellësia e artikulimeve lakonike, të cilat pikëtakohen në shtresën arkeologjike të narracionit kadarean. “Humbja dhe rigjetja e kontinentit nënë” (*Identiteti evropian i shqiptarëve*, f. 59), siç e përcakton autori eksplicisht, përbën boshnin strukturor të veprave mes heshtjes dhe jehonave ideologjike e religjioze nga brenda e jashtë vendi.

Së fundmi, t'i kthehem sërish idesë së riprodhimit të veprës së artit sipas Benjaminit, për të cilin edhe pse funksioni magjiko-ritual i objektit artistik zhvendoset në një praktikë tjetër, mbi themele të politikës, për ta shndërruar në një gjendje të re antropologjike, megjithatë, vepra origjinale nuk e redukton të kaluarën e thjeshtë, atë rrënjësoren, as nuk e anulon atë brenda nesh. Zanafilla e saj - sado e ndërmjetësuar - është e dukshme qartësisht, ashtu si historia jonë zhvillohet në kohë të ndryshme të cilat mbivendosen në rrjedhë të përhershmerisë dhe arti jeton dhe na e dëshmon këtë.



**M**ë 1997 si rezident në Cite International des Arts hap një ekspozitë fotografike me ngjarje nga vendi ynë.

Megjithese shtëpia e Kadarese me vendin ku do hapja ekspozitën nuk ishte larg unë vendosa që çiftin Kadare t'i merrja me taksì.

Kur po zbrisnim nga taksia shoferi i taksisë që ishte kinez kapi nga biseda jonë emrin e Ismail Kadarese.

Në momentin kur po bëja pagesen ai më pyet që ai që zbriti është shkrimtari Kadare? Po, i thashë, ai është. Atë sikur e pickoi dikush u hodh përpjetë dhe nuk pranoi të më merrte pagesën. Po ku e njeh, e pyeta?

Unë kam qenë mësues letërsie dhe në Kinë i njohim veprat e Kadaresë.

I lumtur që në taksinë e tij kish hipur shkrimtarin e madh por dhe i merakosur që nuk arriti t'i jepte doren të paktën...

## NJË HISTORI ME KADARENË NË PARIS

Nga Roland Tasho



Në foto janë Helena dhe Ismail Kadare, presidentja e Cite Internationale des Arts, madam Bruno, drejtoresha në Bashkinë e Parisit, Antonia Bachetti dhe studenti Altin Lazaj në ekspozitën time.

Foto © Roland Tasho



Mos t'ju duket e çuditshme. Vite më vonë kur ndodhesha në Bukuresht, disa muaj para rënies së Çausheikut, mësova se rumunët flisnin me kod nga frika e securitas. Kadare na jepte leksionet e letërsisë moderniste. Vinte pak me vonesë. Nga rruga drejt e në sallë. Nuk hynte dot. Më kujtohet si tani ky moment tejet emocionues. Vinin për te dëgjuar leksionet e tij studentë nga shumë fakultete të tjerë: gjuhët e huaja, ekonomiku, gjeologjiku, histori-gjeografia dhe në heshtje prisnin me një ndjenjë frike se mos vinte ndonjë urdhër nga lart dhe i dëbonte. Kjo frikë e dëbimit i ngjante atij ankthit sflitës që na kaplonte në fëmijëri kur futeshim vjedhurazi në një seancë filmi ku ishte e ndaluar hyrja për fëmijë nën moshën 16 veç. Ç'bente Kadare? As e çante kokën. Nuk përshëndeste, as nuk thoshte më falni për vonesën. E pakta që mund të thoshte ishte kjo: "S'ma dha kryetari makinën e Lidhjes. Erdha më këmbë."

Salla nxinte 80 vetë, aty ishin më shumë se 140 studentë që kishin ardhur të dëgjonin çdo të thoshte Kadare për Kafkën e Sollzhenicinin. O zot, pse gjithë kjo kureshtje e llahtaruar, ku përzihej frika, misteri, mrekullia? Flitej për gjëra të ndaluara. Tabutë, si Shën Llazarin, Kadare i mbante në duar dhe u shpeshitillte fashot e pavdekësisë që t'i bënte të prekshëm, njerëzore. Po si ia arrinte këtij shndërrimi të vështirë, gati të pamundur? Me anë të kodit të tij, kodit Kadare, të leximit të dytë midis rreshtave, të zhvendosjes së tekstit, me mjeshtërinë e një alkimisti dhe përqëndrimin e vëmëndjes në kontekstin diskret. Ky manovrim delikat, i rrezikshëm, prej ekuilibristi në tel, nuk kishte si të mos zbulonte mendjen dhe shpirtin e bukur të Kadaresë. Atë nuk kishte se si të mos e shikoje të pasqyruar në 280 sy dhe në ato vështrime të etura dhe, për më tepër, s'kishte se si të mos shprehej në mënyrën më prekëse, dhënia, dorëzimi, ajo lutja e heshtur hamgjitëse: bëj me mua ç'të duash, jam rob yt. Më kuptoni, ju lutem, Kafkën dhe Sollzhenicinin po i interpretonte me kod Kadare, një shkrimtar i përmasave të tyre.

Sa herë kisha fatin të dëgjoja Kadarenë, më kujtoheshin tre rreshtat e parë me vajza të bukura. Jo, një dhe dy rreshtat, po tre, sepse ashtu donte ai. I ziu Rrap! Unë e njihja Kadarenë, se ai më kishte botuar shumë poezi te "Drita." Njëherë, pas leksionit, e pyeta për këtë manierë, trill artist. "Nuk është manierë." më tha «As trill, po një korrigjim nëpërmjet syve. Dihet se sytë e vajzave të bukura janë shumë shprehës. Njëra i ka jeshil me pak dritë diellore, tjetra të zinj, një tjetër blu. Ato sy janë në moshën e dashurisë. Në këtë moshë nuk ka falsitet, po natyrshmëri, sinqeritet. Unë jam rob i tyre, jo ato robinjat e mia, siç mund të pandehet. Pra, unë provoj veten, sa tërheqës jam, sepse te fjala është shpirti. Natyrisht, nuk duhet të keqkuptohem. Sepse po shoh që veprimet e mia dhe ato fare më të parëndësishmet, interpretohen me sens të keq. Pse kishte veshur Kadareja golf të bardhë, pse ishte aq i zymtë, mos i ka shkarë këmba dhe ne s'e kemi marrë vesh, pse nuk na foli? Merren shumë me privacinë. Kjo më trondit nganjëherë, sepse unë degjoj për veten gjëra që nuk i di.»

Kadare nuk ishte pedagogu i zakonshëm kur vinte për të na dhënë leksion. Ai nuk ishte pedagogu i skemës pedagogjike: regjistri në dorë, marrja e mungesave, fillimi i leksionit dhe studentet që mbajnë shënime. Ku pyeste artisti aristokrat Kadare nga këto idiotizma, sepse kështu i dukeshin më të drejtë, si mund të ulej ai në katedër dhe të thërriste emrat e 80 studentëve? As që imagjinohet. Ai nuk e honeste katedrën e mërzitshme, karriken që gërvinte, gërmuqjen në të, ai nuk ulej kurrë. Kadare e fillonte kështu leksionin: "Ata qentë e Sollzhenicinin më kanë lënë pa gjumë mbrëmë. Mos mendoni se në veprat e Sollzhenicinin nuk ka art të madh. Po menduat kështu ju keni minimizuar ndikimin revizionist. Ja, ky ishte kod i Kadaresë. Bufët le të gjuanin minj, dhelpat finoke le të përfitonin. Më duket se të gjithë përfitonin, pa e hapur gojën në një marrëveshje xhentëllmësh. Ne më mirë vriteshim, se

## KODI KADARE

Nga Roland Gjoza

të tradhtonim Kadarenë. S'pipërinte njeri në sallë. Një vajzë shumë e bukur, një nga ato të letërsisë, aq shumë u emocionua nga fjalët e tij, sa s'i ra të fikët. Kadare e uli në katedër. Ai kishte rënë ndonjëherë të fikët Elenes?

Ky ishte Kadare i bukur.

Po megjithatë Kadare seç kishte një çehre të prishur. Në përgjithësi shkrimtarët ishin të zymtë. Ne kishim shumë respekt për ta. E donim librin. Unë që trembëdhjetë vjeç futesha në librari (ka qënë një librari e madhe aty ku sot ndodhet Muzeu Historik Kombëtar dhe ngjitur me të kafeneja e preferuar e Dritëro Agollit, Shuteriqit, Musarajt, Petro Markos dhe e shumë shkrimtarëve të tjerë.) Aty brënda në librari rrija gati një orë dhe shikoja librat. Shikoja si llosh librat. Dhe mendoja për shkrimtarët. Sot nuk kanë respekt për shkrimtarët si atëherë. Unë çuditësha me zymtinë e shkrimtarit. Pse vallë të jenë kaq melankolikë? Ç'kanë? Ç'i mundon? Më kujtohet babai im, që më quante sakat ngaqë merresha me letërsi. Po këtë ma thoshte me përkëdhelje, me humor. Në atë kohë ai punonte infermier në Poliambulancën Qëndrore, në repartin e Neurologjisë.

"Kush është shkrimtari më i madh?" më pyeste për kureshtje, po më shumë për të më bërë qejfin. "Ismail Kadare" i përgjigjesha unë. "Po ky s'na ka ardhur asnjëherë në neurologji. Të gjithë shkrimtarët janë dukur, kanë marrë ilaçe, janë kuruar, ndërsa ky gjirokastriti nuk na ka ardhur akoma. Doktor Luzi mezi pret ta shohë" Më vonë kur shërbente te Kardiologjia, po ky avaz: "Kadare nuk po duket!" Kur shërbente te Urgjenca, që kishte rast t'i binte Tiranës kryq e tërthor dhe të hynte në çdo familje, më tha me keqardhje: "Ky i preferuari yt që s'po na e var trastën, s'qënka njeri" "Po pse, o baba,



akoma s'e takuat?" "Vdiq doktor Xhumari për t'i bërë një vizitë Kadaresë, plasi i ziu, po ai gjirokastriti s'vuaka nga asnjë sëmundje. Nuk është njeri, më dëgjo mua."

Po pse ishin të zymtë shkrimtarët? Kadare e kishte më të vështirë se të gjithë. Bisha kishte rënë në dashuri me bukuroshen. Ishte një dashuri e komplikuar, tejet e paparashkuar. Diktatori kishte gjetur përfituesin e vet. Nuk është pak që, ekspertët e letërsisë botërore, të thonë se, në Shqipëri, në këtë vend të izoluar e enigmatik, bëhet letërsi e madhe. Vepra e Kadaresë ishte makiazihi finosh dhe i pëlqeshëm për fytyrën e bishës. Po për këtë mos vallë e ka fajin Kadareja?

Ishte një miqësi nga larg, një pëlqim, po që mund të kthehej në urrejtje. Kujdes. Nuk dihet si agoni e nesërmja. Këtë të papritur që mund të sillte e nesërmja, e vuanin të gjithë shkrimtarët.

Gijotina herë afrohej, herë largohej. Duheshin koka që të justifikohesh revolucionin. Ne, brodueistët, kalonim poshtë pallatit kubist të Kadaresë, bënim adetin si çdo natë. U ktheje? Po, po është lart. Elena u shkëput për pak dhe bleu diçka. Ai e priti te bukinisti plak. Si dukej? Normal. E pyeti "Blokun" për atë vajzën? Jo. Nuk donte material sonte? Ajo historia e bllokut i pëlqeu.

Ç'ishte kjo histori brodueiste me bllokun? Bujar Kapexhiu kishte parë një vajzë me një bllok të bukur. Iu qep vajzës. Ajo e giorë nuk i rezistoi dot këmbënguljes së tij dhe pranoi të shkonin nga liqeni. Në kohën kur priste që ai t'i shprehte dashurinë, Bujari i kërkoi bllokun. Ajo ia dha. Dhe sërish priste prej tij deklaratën e dashurisë, po ai i «pafytyrë» i tha se e kishte ndjekur vetëm për t'i marrë bllokun.

Kadareja na begeniste nganjëherë. "E,



Molo," e thërrisnin brodueistët më të rritur, ata të brezit të dytë. Ne mezi prisnim ta shikonim nga afër. S'kishte njeri më të zakonshëm në botë. Po të mos që bërë shkrimtar me emër, padyshim do ta kishim midis nesh në Broduej. E, ç'bëhej aty. Kur kalonte ndonje cofinë, Tim Xhelaka thoshte "Po kalon kriza e përgjithshme e kapitalizmit." Saimir Kumburo, brodueisti më i bukur, që i ecte me femrat, kur kalonte ndonjë djalkë mamaje, thoshte: "Ky merret me sport të thatë (mansturbon.)"

Dhe aty pranë nesh ishte gijotina. Po ne budallenjtë e merrnim jetën si të na vinte. Prisnim Panajot Kanacin. Atë e donim, se blinte fara për pëllumbat dhe zogjtë. Ia blinte tërë qesen shitësit endacak, Gon Qepës, dhe i hidhte farat nëpër çati. Ai kishte mbjellë një hardhi në trotuar, që tani i kacavirej te dritarja. Beb Daliu e pyeste: "Panajot, t'u rrit rrushi?" "U rrit, u rrit, djema" Ai kurrë nuk e kuptoi se ata bënin shaka, se e hidhnin fjalën për tjetër gjë. Kadare i shikonte të gjitha, i dëgjonte të gjitha. Prandaj na pëlqente, se ai ishte si ne, e tërhiqte jeta jonë.

Po pse ishin të zymtë shkrimtarët? Pse ishte i zymtë Kadare? S'dihej si gdhiehej diktatori. Kur botoi romanin "Dimri i vetmisë së madhe", një roman i jashtëzakonshëm, ku dilnin hapur antipatia e Kadaresë për Ministrinë e Brëndshme, shefat e kuadrit, të paafët, ndodhi që të përmëndej Saturni, ai u bë gati të jepte vendimin fatal. Saturni po mendohej. Ishte e tmerrshme. Pothuajse të gjithë donin kokën e Kadaresë. Do të kishte qënë një shembull i madh i revolucionit proletar. Gijotina ishte afuar, ishte në hyrje të pallatit kubist. Po bëhej gati të ngjitej lart në katin e dytë. Kadare ishte mbyllur brenda. Bulevardi i Madh ngrysej dhe zbardhte pa ta, pa çifitin aq tërheqës Kadare.

Shefat e sigurimit donin kokën e tij, komunistët e shprehnin hapur pakënaqësinë dhe padurimin, sepse shikonin veten te shefi i kuadrit dhe te gjithë ajo ushtri të paafëtsh, që Kadare nuk ia kishte kursyer përbuzjen.

Spektakli popullor po merrte ngjyra tragjike. Ajo, gruaja e diktatorit, tejet e zhgënjyer dhe e zemëruar, pritej të jepte dënimin ekstrem. Ju kujtohet ajo kohë e trazuar? Ne pyesnim me zemër të dridhur: "Ka lajme të reja?" "Jo, po kësaj radhe nuk shpëton." "Mos, ç'thua!" Dëgjonim të thoshin: "E hëngri më në fund Kadareja. Shyqyr shpëtuam, se po na merrte më qafe ky shkrimtar i shitur." Me udhëzim të Komitetit Qëndror, u lejua që të kritikohesh vepra në shtyp. Ju kujtohet çfarë shkruhej? Kadare shkruan enkas që ta pëlqejë perëndimi. Ç'është kjo vetmi, ne s'jemi vetëm. Kritikati ishin shpartalluese. "Ç'thotë i madhi?" "Ende s'ka thënë gjë. Po u bënë shumë raste që ai e fal. Kësaj radhe nuk shpëton. Prej atij vinë të gjitha, prej Kadaresë. Po e fali dhe kësaj radhe, ai qoftë!"

Enver Hoxha e mbrojt, jo për ideale, po si përfitues. Ai donte që të mbyllej kjo katrahurë e rrezikshme, që po merrte përmasa politike. 30 mijë kopjet e librit ishin shitur brënda ditës. Kishte filluar fotokopjimi i tij. Kështu ndodhte me Kadarenë, shitej nen dore. Per librat e tij mbahej radhe që ne mengjes. E keni harruar?

Enver Hoxha shkoi vetë në një takim me punëtorët e metalurgjikut dhe pasi dëgjoji vërejtjet e tyre tejet të ashpra për romanin, tha pak a shumë këto fjalë, që u komentuan gjatë. "Po ju bëj një pietje, si klasë punëtoare, nga qelbet peshku? E, mo? Askush s'guxonte të fliste. Një nga ata të organizatës, që ruanin mureve në këmbë, i bëri shenjë dikujt, që u ngrit si me sustë dhe gjëmoi: "Nga koka, shoku Enver! "Po koka në roman është Sekretari i Parë i Partisë, jam unë, është partia. Kështu është! Kllasa nuk mendon ndryshe, apo jo?"

Gijotina u zhvendos sërish diku larg, midis Bulevardit të Madh dhe Lidhjes së Shkrimtarëve.

Kadare ia kishte hedhur edhe kësaj here. E pamë përsëri në mbrëmje kapur për krahu me Elenën, duke pëshpëritur me një fije nënqeshje të qetë sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Kur u përktheje romani në Francë, kritika e krahasoi me Kafkën dhe Tolstoin, për frymën absurde dhe epizmin e ndritshëm.

Romani «Mossanga» i Fate Velaj - një rshpërfaqje mahnitëse (si askush tjetër) e të vërtetave ekzistenciale të kohës së diktaturës, ja ka arritur që përmes dimensionit të sarkazmës në tejkohësi, narrativës plot «imtësi» befasuese e dinake me pikpyetje e qesëndi të shumta brenda tyre – të konfirmoj talentin e padiskutueshëm të shkrimtarit në hierarkinë e zërave më përfaqësues të prozës së sotme shqiptare. Romani i pestë i Velaj ngjan si shenjim, paralajmërim se proza e një “kohe tjetër” të palexuar më parë, ka mbërritur në letërsinë shqipe.

Ashtu si Milan Kundera me romanin “Shakaja”, Fate Velaj me «Mossanga», ja ka dalë t’i bëjë anatominë diktaturës komuniste dhe po i flet botës shqiptare dhe asaj europiane jo me atë “metodikën” e letërsisë së burgologjisë, denoncimit të torturave e vuajtjeve, por me gjuhën fshikulluese të ironisë, groteskut, thrillerit të pazakontë mbi banalitetin e sistemit komunist, një fenomen i paparë deri tani në anatominë e trupit të asaj diktature. (Çdo «indiferencë» ndaj këtij romani, do të jetë veçse një simptomë e ligësisë nga egomania personale si dhe nga mungesa e seriozitetit ndaj vetes, jo autorit).

Fate Velaj, e di mirë se humbja e kujtesës, më keq akoma (mos o zot: vdekja e saj) në të vërtetë është fundi, fundi i botës, i çdo qytetërimi e kombi. Ai na sjell Mossangën pasi beson tek fjalët e Umberto Eco-s kur paralajmëron humbjen e kujtesës: “Problemi është se asnjë qytetërim (në kuptimin antropologjik të fjalës, i kuptuar si një sistem dijesh, idesh shkencore dhe artistike, mitesh, fesh, vlerash dhe zakonesh të përditshme), nuk mund të ekzistojë dhe të mbijetojë pa një kujtesë kolektive”.

1- Ishte e hëna e fundit e korrikut të vitit 1966, kur në qytetin më të çuditshëm të një vendi të vogël komunist, në Vlorë e detit dhe historisë, mbërritën nëntë fëmijë të vegjël kongolezë, gjashtë vajza dhe tri djem. Vlora shquhet për shpirtin e saj kritik, rebel, kokëmbetësinë, ironinë, qartësinë e turbullt, kuptimin disiplinues të së djeshmes por dhe të tashmes. Mbi të gjitha, Vlora ka aftësinë për të qenë gjithmonë një hap përpara. Nëntë fëmijët me ngjyrë sterë të zezë, ishin nga Kinsasha, kryeqyteti i Kongos, fëmijë të udhëheqësve revolucionarë kongolezë, të përfshirë në një luftë mizore, për triumfin e revolucionit komunist në vendin e tyre. Thashethemnaja e përhapur rrëfente se njëri syresh, Joseph Mossanga, biri i ministrit të mbrojtjes, gjeneral Frederik Mossanga, ishte mik i diktatorit komunist Enver Hoxha. Ata ishin takuar në Bruksel kur Enver Hoxha punonte në Legatën Shqiptare atje dhe më vonë, kur një delegacion i partisë komuniste kongoleze kishte vizituar Shqipërinë. Diktatori komunist Hoxha e kishte pëlqyer shumë gjeneralin Mossanga, tek i cili kishte varur shpresat se do të shndërrohej në një marksist - leninist fitimtar. Por nuk ndodhi ashtu. Revolucionari kongolez dështoi. Ra në diktaturë tjetër: nga e bardhë në të zezë, edhe më çnjerëzore se ajo e kuqe. Nëntë fëmijët kongolezë mbetën në Vlorë. Askush nuk u kujdes për ta, veç komunistëve shqiptarë, administratës së diktaturës Enveriste për t’i edukuar siç «duhej», sipas modelit të njeriut të ri socialist. Një sërë ngjarjesh të pazakonta fillojnë të ndodhin pas vendosjes në Vlorë. Ashtu si në realizmin magjik, që le ta themi me fjalët e kritikut amerikan Seymour Menton se: “...realizmi magjik konsiston në paraqitjen e realitetit të përditshëm me një tingull magjik përmes pranimit pa emocione nga ana e protagonistëve të ngjarjeve të jashtëzakonshme”, Fate Velaj na rrëfen pas çdo faqeje po ashtu, egërsinë shtazarakë, vulgaritetin e kotësinë, pabesinë, fatalitetin, injorancën e mungesën tragjike të prespektivës e shpresës për të nesërmen. “...mesa po kuptoj, kanë frikë të na afrohen. Ndoshta se mos vallë kemi sjellë ndonjë sëmundje afrikane me vete dhe mjekët këtu, jo vetëm që nuk e kanë idenë se ç’është, por nuk kanë as njohuritë për ta kuruar” - thotë Joseph Mossanga në bisedë me bashkatdhetarët e tij, pa e ditur nëse ajo që po ndodhte ishte një realitet, një imagjinim apo dreqi e di se çfarë po ju ndodhte si pasojë e të mallkuari moskuptim. Kjo është saga e tyre. Në fakt, kjo gjetje kaq e mprehtë e mjeshtërore, është në të vërtetë prizmi, kulmi dhe faqet e lëmuara të tij, në të cilat zberthehet në formë spektrale gjithë absurdi komunist, thelbi i tij. Fate Velaj bën fije - fije, në mënyrë më të sofistikuar e inteligjente


# MOSSANGA = ROMANI NDRYSHE I LETËRSISË SHQIPE.

Nga Odise Kote

seriozitetin hipokrit të një regjimi, besimin në të pamundshmen, idolatrinë vrasëse të sistemit, butaforinë e boshësinë e tij, metodikën hileqare e makiaveliste, pa rënë pre e skematizmit propagandistik. Ai është kujdesur mjaft të japë esencën dhe imazhin e regjimit, pa dhënë riprodhimin kronologjik e historik të saj dhe këtë, me një ftohtësi klinike, kur në fakt, rreziku i rrëmbimit prej emocioneve të ndezura ishte prezent në çdo kapitull. «Rritja dhe edukimi komunist» i nëntë fëmijve kongolezë në Vlorë, saga magjepëse e tyre, me peripecitë, ngjarjet, të papriturat, paragjykimet e ngjyrës, e deri tek «përpjekja e shqiptarizimit» sipas modelit edukativ të njeriut të ri, përpos instiktit të mbijetesës është për ta udhëtimit tragjikomik në rrethin e nëntë të ferrit (vini re numrat nëntë). Edukimin e kongolezëve autori e bashkëngjit me «kulturën masive» të bashkëmoshatarëve të tyre shqiptarë. Ai udhëferr i kongolezëve të vegjël, variacion stilistik i mirëgjetur, i ka dhënë romanit ritëm dhe një dinamikë të pabesueshme lëvizjeje e përfytyrimesh groteske. Po e gjithë narrativa ka një pritë ku kullon e filtrohet, është sarkazma e mirëstuduar dhe e organizuar si duhet, deri në detajet më të imta, në mikrofabulat e përditshme të personazheve, në të gjithë rrjedhën kumbuese të saj.

2- Duke u rritur, Joseph Mossanga, fillon të kuptojë e të ndjejë përfundimisht «se Shqipëria mikpritëse, nuk ishte një vend me 28.000 km katror, por vetëm me 333. Një truall toke sa për të ndërtuar një godinë të bardhë me disa qeli të vogla, një dhomë pyetjesh e një torturash.”

Këtë të vërtetë të hidhur ai e provon në lëkurën e vet, në moshë të re, gjatë jetës në Vlorë, në shkollën mjekësore, përndjekjes dhe arrestimit nga sigurimi i shtetit. Pasionet e mëdha, përkushtimi ndaj botës “open -source”, marrin goditje të rënda prej rregjimit që tashmë e kishte holluar së tepërmi maskën e vet. Kamzhikët e rregjimit që kishte provuar në Vlorë, i ndjen dhe në Tiranë, por në kryeqytet ai ndjeu peshën e rëndë, grushtin mizor të diktaturës t’i përplasej në fytyrë. Por sa më tepër rregjimi godiste, aq më e madhe bëhej mirënjohja dhe dashuria e Mossangës për Vlorën dhe Shqipërinë. Kjo dashuri gati profetike, (kudo ku shkonte prezantohej vlonjat, këndonte këngët e Vlorës, kompozonte mbi to, jetonte e fliste po si një vlonjat, ruante miqësinë me ta) e bën Joseph Mossangën të përjetojë një cikël ngjarjesh që kanë peshën e papërsëritshme të një eksperience e përvoja unike. Nga karakteri i vlonjatëve më shumë se skematizmi edukativ i njeriut të ri që kultivohej me zell në konvikte, shkolla e në jetën e përditshme, ai mësoi virtytin e skepticizmit, që nënkuptonte një sens humori të vazhdueshëm, për të vënë në pikëpyetje edhe gjërat në të cilat njeriu beson singjerisht. Ndoshta kjo shpjegonte faktin se në shumë raste, bashkë me miqtë e tij, ai ishte tallur, apo kishte parodizuar, gjeste e gjëra të cilat nuk është se bëheshin me bindje të madhe. Të mos e marrësh kurrë veten shumë seriozisht, i ishte dukur gjithmonë qëndrimi i duhur. Ai e kishte kuptuar më së miri se e vërteta nuk mund të jetë kurrë e njëjtë, sepse ajo ndërtohet sipas një procesi interpretues subjektiv. Nuk



e ngatërronte regjimin as me Vlorën dhe as me Shqipërinë. Por Joseph Mossanga e donte jetën, e donte dashurinë. I këndonte me kitarë në koncerte, mbrëmje vallzimi, në parqet e kryeqytetit. Kongolezi buzatrashë, flokëkaçurel që si shtroi dot asnjëherë, kishte një nur të parezistueshëm. Ka fytyra të shëmtuara që të bëjnë për vete kur i vështron, siç ka fytyra të bukura pa pikë shijeje. Mossanga iu dukej i bukur të gjithëve. Se çdreq kaçurelash ndërlikeshin mbi ballë, vetulla mrekullisht të dendura e të gjata që ndërthureshin me shikimin e butë, rrudhat e holla mbi mollëza, të shtynin të ndjeje, të mendoje, që brenda atij balli duhej të kishte një sasi idesh që vlonin, të gatshme për të shpërthyer në çdo çast prej atyre sysh çuditërisht tejet të ndritshëm e depërtues. «Ai është i mahnitshëm – i tha të nesërmen e mbrëmjes Jasmina, Almës, shoqes së saj. -Ai e ka zërin më të bukur se Sammy që këndon të dielave në RAI». Kulmi mbërriti kur ai e gjen dashurinë e vet, tek një vajzë e emancipuar, mendje hapur, Jasmina, e bija e Lito Goçit, shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë shqiptare. Por si mund të zhvillohej e pranohej prej rregjimit kjo dashuri, midis bijës së një drejtuesi të lartë të nomenklaturës komuniste me një të huaj që përndiqej nga sigurimi shtetit dhe në dosjen e tij mbizotëronin fjalët: spiun i perëndimit, agjent i shumëfishtë, i rrezikshëm, përhapës i veseve e ideologjisë borgjeze në Shqipëri. Por kjo dashuri e tij me Jasminën, kthehet në një monument homazhi i vetë ekzistencës së tij. Kjo dashuri shemb të gjithë idolatritë e paragjykimet. Ligjësia ciklike e ngritjes dhe rënies së idhujve është e vjetër sa vetë sajimi i tyre, por në situatën e Mossangës e Jasminës, shkëlqen pohimi amerikan që një idhull është njëfarë Zoti portativ, gjithnjë i disponueshëm. Ka gjasë që kushtin kësjaj disponueshmërie, t’ia ketë caktuar më bukur se kushdo tjetër shkrimtari John Steinbeck: “...kur një idhull rrëzohet e bie copash, i nuk përgjysmoheta, por përfundon në një varr plehurishteje, duke e bërë të vështirë ringritjen së rishti më këmbë dhe, në e ngritsh mbi piedestalin e tij të vjetër, do njolla që dëftojnë rrëzimin e tij të mëparshëm, nuk i shlyhen që nuk i shlyhen kurrë.” Drama e një ushtaraku madhor, bir i një heroi të luftës antifashiste të lidhur pazgjidhshmërisht me diktaturën, qënie në agoni, në të perënduar, diç që të kujton ekspresionistët gjermanë të stilit të Ernst Ludwig Kirchner, (Lito Goçi ati i Jasminës) për fajin e vetëm se e bija dashurohej me një kongolez, e që Ministria e Brendshme i kishte në përpunim aktiv 2A, mbetet nga skenat unike të romanit. Duke qenë i zhgënjyer me kohën, me veten, me idealin e tij të pamundur komunist, diç që të ndërmend vibrimin e akthit, përsëritshmërinë, një si nostalgji që qan me gjysëm ngashërime, Lito Goçi, i dërmuar prej gjyqit të vartësve e kolegëve të tij në organizatën e partisë, çmendet. Çmendja, marrja e rimarrja e të njëjtave kujtime dëshpërake, hedhja nga ballkoni, është rezonanca manjetike katërdimensionale që autori i bën regjimit. Ashtu fare thjesht, pa bërtitur, pa klithmat hysterike, por me qartësinë e dëshmisë unike të një fati njerëzor që ishte kafshata e rradhës për një diktaturë. Por nuk mbarron me kaq. Donika, gruaja e tij, për të mos shfaqur aprovim me gjestin e të shoqit, çdo mëngjes, dilte në ballkon e veshur me rrobat më të mira, e lyer me buzëkuq e puder faqeve, dhe këndonte si e marrë këngën që vetë Lito, i shoqi i saj kishte kënduar përpara gje gjatë aktit të vetvrasjes, këngën që përlyente më shumë Enver Hoxha. E frikshme kjo skenë por, Fate Velaj, me një mjeshtëri unike, e ka sjellë të gjallë këtë akt funebër. Ngjarja e paralajmëruar, fundi i një personazhi të tillë, është parapritja e qartë e vdekjes, retrospektiva ku po e çonte rregjimi një popull të indoktrinuar, krejt pa sens të duruar e apatik. Pamundësia e jetës, e dashurisë së Mossangës me Jasminën, na rrëfejnë utopinë e lumturisë në një rregjim të tillë.

3- Saga e kongolezëve në Shqipëri është e ndarë dypjesësh, adoleshenca në Vlorë dhe rinia në Tiranë. Episodet rrëfyese të “kujdesit” të regjimit, si pjesë e procesit të edukimit të njeriut të ri, ndonëse të ndryshme, kanë në thelb të njëjtën sarkazëm therrëse, me synim ekspozimin e kalbësisë dhe degradimin e pakthyeshëm të tij. Lehtësisht vëmë re se si komponentët e ndryshëm të rrefimit janë të prirur në thagmën për të nënvizuar kuptimin

## Muzgu i parë

Kur dal në rrugë, në kthesën e vogël në të majtë të pallatit 123, qoshja e të cilit prej vitesh shërben si vendkalim, shoh orën. Është koha, kur sapo bie muzgu dhe kudo të rrethon një qetësi e bukur joshëse. Më pëlqen të dal vazhdimisht në këtë kohë. Në të gjitha ditët e muajve të çdo stine dal sapo bie muzgu. Gjatë pranverës, verës e vjeshtës, por edhe dimrit, kur koha është e mirë, në trotuarin buzë Lanës nisin e shëtisin gra me fëmijë të vegjël dhe çifte, të cilat, me t'u mpiksuar muzgu, futen në lulishten "Rinia". Nuk e di pse muzgjet e vjeshtës më tërheqin aq shumë. Seç kanë diçka prej lamtumirë të dhimbshme, diçka që ka të bëjë me ndarje të gjata, me një përmallim njerëzor.

Në një nga këto muzgje vjeshte kam parë, rënë përmbyss në barin e njomë buzë Lanës, një burrë 40-vjeçar. Iu afrova pranë atij njeriu me frikë e ndrojtje bashkë. E tunda ngadalë supeve dhe ai pasi u kthye më ije, më pyeti se përse nuk e lija të vdiste. Më lër të vdes këtu, buzë Lanës e në këtë muzg, tha. Ata, më shkatërruan, Ata m'i vranë ëndrrat. Ata...

Kronika thotë se atë natë, në përdim të Tiranës, rrëzë kodrave të buta, punohej për hapjen e një grope të madhe. Sipas kronikës, natën e 19 shkurtit 1951, në oborrin e Ambasadës Sovjetike u hodh eksploziv, që shkaktoi thyerjen e disa xhamave. Në mesnatën e 20 shkurtit, u arrestuan 150 intelektualë të kryeqytetit, të akuzuar për veprimtari terroristë e të lidhur me CIA-n dhe Intelejencien Servicen. Më 26 shkurt, vazhdon kronika, Presidiumi i Kuvendit Popullor miraton dekretin 1223. Tre paragrafët e fundit të këtij dekreti:

- Gjyqi bëhet pa pjesëmarrjen e palëve.  
- Paraqitja e kërkesave për falje nuk lejohet.

- Vendimi në masën ndëshkimore më të lartë, ekzekutohet menjëherë pas dhënies së vendimit.

Në një nga procesverbalet e Ministrisë së Brendshme thuhet se, pas kërkimeve intensive, rreth orës 22<sup>00</sup>, u gjet buzë Lanës A.N., vjeç 40, me profesion inxhinier, ish-pjesëmarrës në Luftën Nacionalçlirimtare.

Në datat në vazhdim, thotë kronika, nisi pushkatimi i terroristëve. Pas breshërive të automatikëve, ata ranë në gropën e madhe të hapur mes kodrës së butë me ullinj, në periferi të kryeqytetit. Gjatë kontrollit të kufomave të porsavrara u gjend e pagoditur nga plumbi S.K. njëra nga vajzat e grupit terrorist. Atë e ngritën në këmbë, i raportoi në orën 2<sup>00</sup> pas mesnate komandanti i skuadrës pushkatare shefit të tij, duke ia thyer kokat me kondak pushke. Gjithçka u krye në fshehtësi të plotë, përfundon kronika dhe gropa e madhe me 22 të pushkatuarit brenda, pasi u mbulua, u maskua mirë, duke mbjellë mbi të shkurre.

...I mbaj mend mirë ato ditë të ftohta, gjëmime të thella funddimri dhe vetëtima verbuese, që shfaqeshin pas kodrave të Tiranës. Kur erdhi pranvera, në muzgjet e përflakura të saj, nga brigjet e Lanës kam parë në horizontin e kodrave në përdim, njolla të mëdha e të kuqe. Ato më janë shfaqur vazhdimisht në të gjitha muzgjet e pranverave, që kanë ardhur pas muzgut të përgjakur të pranverës 1951.

## Muzgu i dytë

Isha në gjumë, duke parë ëndërr sikur udhëtoja në fundin e detit, kur m'u bë se dëgjova në fillim të trokitura të ngadalta e më pas më të forta. . . Dola menjëherë nga ëndrra, hodha batanijen mënjane dhe u gjenda në korridor. Sapo hapa derën, ai hyri menjëherë brenda e më pyeti nëse kisha njëri në shtëpi. I thashë se isha vetëm. Mos ka përgjues, tha ai i alarmuar. Pas këtyre fjalëve, mendova se mos ishte çmendur. Shihte i frikësuar përreth dhe fytyra i kishte marrë ngjyrë mavi. Ç'ka ndodhur, thashë. Dukesh i trembur. Pi një gotë ujë ose të bëj një kafe. . . Mos fol me zë të lartë, ndërhyri menjëherë. Më mirë bisedojmë jashtë, shtoi duke vështruar me të njëjtën frikë. Dolëm. Ishte muzg i butë, nga ata të



# ENVER KUSHI

## Kronika muzgjesh

rrallët në fillimet e pranverës. Lana rridhte e qetë, ndërsa në të dyja anët e saj lëviznin kalimtarë të rrallë. I dëgjova lajmet, theu heshtjen ai. Jo, thashë. Asgjë nuk ke dëgjuar? Jo, thashë, asgjë. Unë pres arrestin, tha. Pse, pyeta i shtangur. Përse? . . . Nuk m'u përgjigj. Më shihte në sy e vura re se si nisi të dridhej i tëri. Nuk kisha parë ndonjëherë njeri të dridhej ashtu si ai. S'ishin dridhje frike ato. . . Dridhej burri si purteka në muzgun e butë pranveror të vitit 1956. Ndoshta ata mund të jenë duke më bërë kontroll në shtëpi, tha. Folë, thashë. Pse? Kush janë ata? Vura re se krahun e majtë e kishte të paralizuar, pas plagosjes në operacionin e dimrit të vitit 1944. Edhe ai krah i dridhej. Dridhej i tëri ish partizani i kompanisë së dytë, të batalionit të tretë në Brigadën e Parë Sulmuese. Prej vitesh punonte në Radio-Tirana.

Unë jam agent i jugosllavëve, tha ai. Më kupton? Ti po shoqëron një agent të Titos. Kështu u tha në konferencë. Ai ulërinte si kafshë. Ulërinte, shtoi.

Dhe më tregoi se ç'kishte ndodhur në Konferencën e Tiranës. Mbjaj mend se qëndruam gjatë buzë Lanës, në një nga muzgjet, ku dridhej njeriu që 12 vjet më parë, ndërsa i hiqnin plumbin, ëndërronte për barazinë dhe pranverën. . .

Procesverbali i mbajtur në një nga seancat e Konferencës së Tiranës, gjatë diskutimit të delegatit V.D., mbyllet me fjalët: "Ne në mal luftuam për barazi e liri. Për to e lashë krahun tim. Jam kundër të gjitha kulteve e privilegjeve".

Në orën 17<sup>00</sup>, në një nga pushimet e seancës, V.D. doli nga salla e konferencës. Jashtë ndjeu t'i therte plaga në krah, gjë që nuk i kishte ndodhur prej vitesh.

Në orën 17<sup>15</sup> kërkoi në telefon ish-komisarin e batalionit të tretë, funksionar i lartë në Kryeministri. Jam V.D., tha ai në telefon. Desha t'ju takoj patjetër shoku komisar. Komisar i tha se ishte i zënë. V.D. uli receptorin dhe zëri i komisarit iu duk i ftohtë. Akull i ftohtë.

Pas 20 minutash trokiti në shtëpinë e shokut Veladin Xh., me të cilin e lidhte miqësi e vjetër. Shoku Veladin e këshilloi të bënte autokritikë të fortë bolshevike me shkrim, të kërkonte publikisht falje për ato që kishte thënë, sepse armiku i klasës, i brendshëm e i jashtëm, në këto situata kërkonte të bënte për vete njerëzit tanë, t'i rekrutonte ata në radhët e veta e se vigjilenca revolucionare do t'i dërmonte të gjithë armiqtë.

Kur po ndaheshin shoku Veladin e porositi të mos fliste për takimin me të.

Në orën 19<sup>00</sup>, i vëllai përplasi me forcë derën duke e quajtur V.D., "tradhtar", "agent të Titos", "spion të CIA-s amerikane". V.D. zbriti duke u lëkundur shkallët e pallatit, u ul për t'u qetësuar në katin e parë

dhe atje qau. Qau gjatë . . .


Pas 10 minutash, u ngrit, doli në bulevardin e madh, kalo urën e Lanës dhe nisi të ecte i vetmuar gjatë trotuarit buzë lumit. Po binte muzgu dhe V.D. ndjeu vetmi. Ishte vetmi muzgu, nga ato që të zënë frymën, duke të zhytur në humbëtitra nate. . .

Në orën 20<sup>00</sup> u gjend në varrezat e dëshmorëve, në kodrinën pranë Universitetit të Tiranës. Thuhet që qëndroi gjatë pranë varreve të dy shokëve të tij të ngushtë. . .

...Pas tri ditësh, në karrocerinë e makinës me targë UP 05742, V.D. i mbështjellë me batanie, vështronte i përhumbur natën, që vinte fushës së Myzeqesë, ku do të kalonte vitet e gjata të internimit, i braktisur nga gruaja dhe fëmijët.

## Dy muzgje në një dhe kronikë e hapur

Përpiqem t'i lidh ato ndodhi ndoshta të rastit e të shkëputura në ditë e në kohë të ndryshme, por kur i gjykoj qetësisht mendoj se nuk janë të tilla. . . Jashtë bie shi. I qetë si në ëndërr. Njerëz, që nxitojnë të lagur dhe autobusë, që lëvizin të lodhur. Ngricat e para dhe erërat e dimrit. Varrime midis orës pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë në prag muzgjesh. Ndezja e parë e sobës. OXHAKË, që tymojnë si pleq llullat me duhan të fortë. Pjatat e zakonshme me fasule e turshi mbi tavolinë si në tablotë "Natyre e qetë". Të kollitura të shpeshta, duke mbajtur



radhët e gjata për qumësht në orën tre pasmesnate. Përditë kështu . . . Mos fol. Të lutem, mos fol. Jemi i vetmi vend socialist në tërë rruzullin. . . Mos fol... Si mos të flas? Të lutem, mos fol... Jemi shumë mirë. Jetojmë të lumtur, duke hedhur valle në gojë të ujkut. Armiku i klasës kërkon t'i errësojë arritjet tona në të gjitha fushat. . . Mos fol.

Lajmet e orës njëzet. Komunikata për Plenumet e Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë. Grupe armiqësore në naftë, ushtri, bujqësi, art e kulturë . . .

Pamje fushash të shkreta. Fushata e korrijeve dhe e shirjeve. Filloi mbjellja e grurit... Kanalet kulluese në gatishmëri të plotë. Zëra spikeresh të RTSH-s për arritjet e klasës sonë punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste... Pastaj vetmi. E pjata me fasule dhe turshitë. Dhe shiu, që godet mbi xhama. Dhe procesionet e varrimit midis orës katërmëdhjetë e pesëmbëdhjetë. Fjalime të gjata të kryetarëve të Frontit Demoratik në pragmuzgje varrimesh... Dimra të tërë kështu. Të gjitha stinët kështu. Gri të mbyllura. Muzg... Trokitje në mesditë... Në të gdhirë... Sapo ke ngrënë pjatën me fasule... Në emër të popullit, je i arrestuar. Procesverbale në zyra hetuesish.

I mbajtur sot me datën... për marrjen në pyetje të pandehurit Alban Ali Tushi, i biri i Aliut dhe i Shpresës, lindur e banues në Tiranë, i papunë, i padënuar ndonjëherë, i pamartuar...

- I pandehur! Ç'të lidh me atë njeri?  
- Asgjë.  
- Kur jeni takuar ose njohur për herë të parë?

- Në muzgun e ditës së hënë,  
- Pse në muzg?  
- Krejt rastësisht. Mund të ishte edhe mëngjes, ndoshta edhe mesditë.  
- Pse pikerisht në muzg dhe në urën e Lanës?

- Ç'rëndësi ka kjo? Unë ua shpjegova.  
- Për ne ka shumë rëndësi.  
- Po e përsëris: me të u takova rastësisht. Ai rrinte vetëm e pinte cigare, ndërsa unë iu afrova.

- Pastaj?  
- E pyeta: "A keni shkrepse?", ndërsa ai më tha se kishte edhe shkrepse, edhe çakmak.

- Kjo ishte parulla?  
- Cila parullë? Unë e pyeta...  
- Ju thatë se cigaren ai e kishte të ndezur?  
- Po.

- Atëhere, përse e pyetët "A keni shkrepse?", kur ai e kishte të ndezur cigaren?

...  
- Përgjigjuni!  
- Kaq kisha.

- A pranoi se pas ndezjes së cigares ai u pyet nëse e kishte parë paradën e madhe ushtarake?

- Po. Ai pyeti nëse e kisha parë paradën ushtarake.

- Dhe ju çfarë i thatë?  
- I thashë se e kisha parë.

- Vetëm kaq? Po mendohuni, më tej për çfarë biseduat?

- Nuk mbaj mend.  
- A biseduat për tanket?

- Po. Po. Ai më pyeti se si m'u dukën tanket.

- Dhe ju si iu përgjigjët?

- I thashë se m'u dukën si në filmat sovjetikë, të vjetër e se në një emision të televizionit tonë për luftën në Vietnam, tanket e ushtrisë amerikane ishin moderne.

- I pandehur! Mbrojtja jonë është e pathyeshme dhe në unitetin e çeliktë

parti-popull do të thyejmë kokën çdo armik ose koalicion armiqsh. Ti këron të dobësosh mbrojtjen, të përhapësh panik në popullin tonë ushtar, duke kapitulluar përballë presionit imperialisto-revizionit.

...  
(Kronika mbetet e hapur. Kushdo mund ta plotësojë atë...)

Aktori, që përgatitej të luante Hamletin, në premierën që do të jepej javën e fundit të marsit në Teatrin Popullor, kishte parë në ëndërr qentë, të cilët lehnin pranë dritares së dhomës së gjumit dhe ishte ngritur përgjumësh, duke thirrur: "Ndihmë! Ndihmë! Ata po më kafshojnë". Kur erdha në vete, i tregoi se shoqësitë në nesërmen, kur ajo u kthye nga një shërbim i gjatë në Jug, vërtet diku jashtë lehnin qen. Kam netë që

e shoh këtë ëndërr, i tha aktori së shoqes, gjatë shëtitjes në muze, pas provave në teatër. Ajo e qetësoi duke i thënë se e kishte nga lodhja e tepërt për rolin e madh, që i ishte besuar.

Të njejtën ëndërr, por me dy gjarpërinj, që nxirrnin gjuhët e holla, e kishte parë edhe njëri nga regjisorët e njohur të Teatrit Popullor. Janë dy gjarpërinj të bukur, me rombe në trup, që më vijnë në ëndërr pas mesit të natës e unë ngrihem i llahtaritur, duke ulëritur nga tmërri, tregonte regjisori. Kur e dëgjoi këtë kryeredaktori i gazetës letrare, qeshi, duke thënë se atij i shfaqeshin në ëndërr ujq. Ti e merr me shaka, ose tallesh me mua, dhe i prekur regjisori, ndërsa rrufiste kafënë në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve. Ndoshta më vë edhe në lojë, shtoi ai, duke u ngritur. Kryeredaktori u betua për idealin e partisë se nuk tallej e se me të vërtetë i shfaqeshin në ëndërr ujq. Ndërsa unë kam net që eci në shkretëtirë, tha me ndrojtje, duke u skuqur në fytyrë, gazetari i ri i gazetës letrare. Zgjojhem i tmerruar se më duket sikur kaloj zbatuar mbi gjembat e fiqve të detit. Ka edhe ëndrra të tjera të tmerrshme, ndërhyri në bisedë gazetari tjetër i gazetës letrare dhe poet i ri. Mbrëmë, ndërsa zhytesha në thellësi të detit, m'u sulën peshkaqenët, ashtu si të "Plaku dhe deti" i Hemingueit. Ishte ëndërr e tmerrshme, tha ai duke parë fytyrën e imët të kryeredaktorit dhe gojën që përtypte cigaren...

Sipas kronikës, muzgjet e vjeshtës e të dimrit të vitit 1973-1974 aktorin, që do të luante Hamletin e gjetën në burg, duke thënë me vete monologun "Të rrosh a të mos rrosh". Të njëjtin fat pati edhe regjisori i njohur i Teatrit Popullor, ndërsa kryeredaktori i gazetës letrare si dhe gazetari e poeti i ri, dhjetëra kilometra larg Tiranës, në disa qytete të vogla provinciale të vetmuar pyesnin veten se ç'krime kishin bërë që i syrgjynosën...

*(Kronika mbetet e hapur. Kushdo mund ta plotësojë atë...)*

## Muzgu i pestë në kohëra të reja

Ato më thanë të zbrisja menjëherë, duke treguar shishen e konjakut. Nuk dal, u thashë që nga ballkoni. Por ata ngulën këmbë, duke thënë se do të shkonin te liqeni e se do të bënin qejf. U thashë prapë të njejtat fjalë e hyra në kuzhinë... Prej ditësh rri brenda, duke parë vetëm televizor ose dëgjuar radion. Nuk dua t'ia di as për ditët, as për datat e as për orët, që kalojnë. Të gjitha janë njëlloj me vetminë e shtrirë dhe grinë e qiellit. Vetëm gri e hapur. Asgjë tjetër. Herë-herë vetminë gri sikur e tremb zilja e telefonit, që bie në koridor. Ndoshta është Alba. Ndoshta Maksi. Por me siguri është Alba. E ndiej nga tingulli i ziles, që shpreh padurim për të folur patjetër në telefon. Fol, fol, them me vete. Me zë çjerrës telefoni. Me tingujt gri e fjalë të hirta prej reje.

Si ndodhi kështu? Kam frikë të dal në rrugë e të shëtis buzë Lanës ose në çdo rrugë të Tiranës. Nuk dua ta kujtoj muzgun e të premtes. Me ngjethet mishtë, kur e kujtoj...

Po shkoja në takimin e zakonshëm me Albën (data ishte trembëdhjetë dhe ora tetëmbëdhjetë e njëzet minuta)

Kapërceva urën e dytë të Lanës dhe po ecja në trotuarin e krahut të majtë të rrugës "Donika Kastrioti". Rreth pesëdhjetë metra larg urës, buzë trotuarit, në pjesën me bar të shpatit të lumit, sapo shkela mbi grumbullin e dheut, m'u bë se dëgjova një zë: " Mos shkel!" Kush fliste? Ç'kisha shkelur? Hodha vështrimin përreth, por nuk pashë njeri. Më kanë bërë veshët, mendova dhe hodha hapin tjetër për të ecur më tutje. Dhe sapo këmba shkeli në dheun e njomë, përsëri, dëgjova të njëjtin zë:"Mos shkel! Ku shkel! Nuk e sheh?" Ç'të shihja? Nën këmbët e mia kishte vetëm dhë të njomë dhe fare pranë, ishte një grumbull i madh dheu, në formën e varrit.

...Atëherë vrapova. Vetëm vrapova, pa e ditur se ku më çonin këmbët, ndërsa nga pas më bëhej sikur mëndiqte zëri "Mos shkel! Mos shkel! Mos shkel!" Të nesërmen

i telefonova Albës, lamë vendin e takimit dhe bëmë shëtitjen e zakonshme të muzgut. Ajo e gëzuar për provimin e frengjishtes, fliste pa pushim, ndërsa unë as që e kisha mëndjen në fjalët e saj...

- Dëgjove gjë?- thashë befas unë, duke e kapur fort nga krahu Albën.

- Çfarë? Shtangu ajo.

- Një zë...

- Jo.

- Si jo?

- Ti nuk je mirë.

- Ishte një zë Alba...

- Ti je zverdhur, Fredi...

- Ishte po ai zë, Alba. Po zëri i mbrëmshëm.

- Fred, të lutem qetësohu.

- Një zë varri, Alba. Më beso. Unë shkel mbi varre.

- Fred...

- Është varr Alba. Është varri i dytë, që po shkel.

- Fred, të lutem qetësohu. Nuk ka asnjë varr. Është vetëm grumbull dheu nga të komunales...

Mbaj mend se ajo më tërhoqi me forcë e pasi dolëm në trotuarin tjerët dhe lëvizëm në drejtim të kundërt me grumbullin e dheut, u ulëm për t'u qetësuar...

Dhe pas dy ditësh, pikërisht pas dy ditësh, në mesditë, ndërsa prisja autobusin e Tiranës së Re në qendër, m'u shfaq përsëri një grumbull i madh dheu. Ishte dhe i kuq, përzier me guralecë të vegjël, të bardhë. Dukej si varr, si varr i vërtetë, në qendër të kryeqytetit... Dhe më tutje m'u bë se pashë grumbuj të tjerë dheu. Që atë ditë, nuk guxoj të dal nga shtëpia... Ndoshta janë halucinacione, mendoj. Por zërin e dëgjova mirë. Edhe zëri është halucinacion?

Hap televizorin, por e mbyll menjëherë, sepse në ekran shfaqen varre të hapura, eshtra, kafka të vdekurish... Nuk jam në ëndërr. Bindem se nuk jam në ëndërr. Nuk janë as halucinacione. Tashmë s'marr guximin të dal as në ballkon e të shoh jashtë. Më duket se trotualet, rrugët, bregu i Lanës e më tutje bulevardi, janë mbushur me varre...

Në koridor dëgjoj zilen e telefonit. Bie papushim. Atëherë dal në koridor dhe ngre receptorin. Alo, them. Kush është? Alo. Një sekondë, dy, tre, katër, pesë... "Mos e shkel! Mos e shkel!", dëgjoj zërin, që vjen nga bota e varreve. E ul menjëherë receptorin, ndez dritën e koridorit dhe hedh vështrimin në mur, ku kalendari shënon muajin zero dhe vitin zero. Është një kalendar pa fletë, pa ditë, pa muaj e vit. Duket si varr i kohës.

## Në vend të një sqarimi

Më 10 janar 1993, doli në Tiranë numri i parë i gazetës "Evropa", e përjavshme ART, KULTURË, SHKENCË, botim i firmës me të njëjtin emër. Drejtori i gazetës ishte Frederik Rreshpia, një nga poetët më të mirë të letrave shqipe e më gjerë. Në këtë numër është botuar edhe tregimi im "E hëna e vitit zero". Mbaj mend, që Fredin e takova të nesërmen në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve. U ula pranë tij i ndrojtur, duke e uruar për gazetën dhe falënderuar për botimin e tregimit tim. Ai duke pirë xhin a një pije tjetër të shtrenjtë, më tha se kisha në dorë një subjekt të veçantë e surreal e se ishte gjetje ajo me gjarpërinjtë-lodra, që më pas kthehen të gjallë. Pastaj rrufisi gotën me xhin dhe shtoi se duhej ta zgjeroja tregimin në roman. I thashë se... ai më ndërpreu dhe tha: "Fillo të shkruash romanin. Do ta botoj unë në shtëpinë time botuese me shpenzimet e mia".

Dhe kështu ndodhi. Romani u botua në fund të vitit 1994, me titullin "Hëna e vitit zero", me një format të vogël xhepi, ku të bën përshtypje kopertina dhe grafika e zgjedhur në të. Në vitin 2002, pasi e ripunova, romani u botua me titullin "Koha Zero", nga shtëpia botuese "Baça".

"Kronika Muzgjesh", që po botohen tek "EXLibris", janë pjesë e këtij romani dhe që janë në kapituj të ndryshëm të tij. Këtu ato botohen bashkë. Mendoj që "Koha Zero" do ta rishoh dhe besoj do të botohet më i plotë këtë vit.

*(Vijon nga faqja 11)*

e të parevokueshmes: përdorimi e vetës së tretë apo atë oshilacion të përhershëm midis së tashmes dhe së ardhmes. Takojmë mënyra të tilla konstrukcioni: "Pranë bustit të Patrice Lumumba-s në Alarup, u rreshtuan fëmijët nga Kongo, tre drejtorët, përfaqësuesi kinez dhe inspektori i komitetit të partisë". Fq.135 ose "Me vështrimin e përhumbur tek vrima zanore e kitares, me përqëndrimin më të madh që kishte pasur ndonjëherë kur këndonte ndonjë këngë të re a të vjetër, ai ndjente përgjegjësinë që kishte marrë". Fq.327. Kështu atmosfera e arritur në këtë pikë, parapërgatiste një fat të pashmangshëm që i vinte rrotull protagonistit Joseph Mossanga. Rrëfyesi "di me saktësi çfarë do të bëjë Joseph Mossanga në Tiranë sepse ai tashmë e ka bërë në një ekzistencë të mëparshme, në Vlorë. Kështu, edhe pse rrëfyesi flet shpesh në kohë të ardhme, ai e tregon me një element të vendosur për të kaluarën; është një e ardhme e pashmangshme". Koherenca psikologjike dhe i gjithë realizmi, ndërtohet pothuaj mbi këtë matricë dhe është i krahasueshëm vetëm me Marquez tek "Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar," apo me Carlos Fuentes tek "Shoqëri e Pashpjegueshme: Gjashtë Tregime fantazie - ose gjashtë variante të së keqes". Tablo e kësaj sage, Vlorë - Tiranë që ka mbi krye rrezikun e zotëron shpërthimin e mundshëm, në fundin e saj na çon në zbulimin e mahnitshëm: personazhet janë të ngjizur që prej kohës që jetojnë. Në këtë vepër ndihet pesha e ndryshimit të personazhit dhe kjo, nën trysinë e ngjarjeve ditë pas dite e muaj pas muaji, si një fillim i përpunimit kulturor që lyp letërsia dhe sidomos në artin e fikSIONIT. Sigurisht, nuk është fjala për një konceptim keqdashës të kësaj, apo diçka që i kundërvihet së arsyeshmes letrare, por e kundërta: është grotesku i episodeve i kuptuar si një realitet tjetër, i ndryshëm dhe larg nga metodat shkencore; më pak i kuptueshëm e më pak ndriçues në fushën e njohjes. Pra, marrëdhënia e autorit me gjininë e groteskut është tepër e veçantë. Fate Velaj nuk i drejtohet groteskut si qëllim në vetvete; dmth, nuk e thërret atë si një model që të orientojë mënyrën e tij narrative, të njëkuptimshme. Prandaj, në historitë që rrëfen rreth rritjes së kongolezëve sa në Vlorë e në Tiranë, ndeshemi me modalitete të ndryshme, si në tematikë ashtu edhe në listën narrative. Duke ndeshur një botë të panjohur, shpesh gati – gati të pakuptimtë, tek kongolezët, përmes narrativës së autorit ndeshemi me obsesione të pafundme ku qëndrojnë - identiteti, koha, gjuha, raporti me rrezikun, me hapësirën dhe lirinë. Fiksionet e autorit luhen në tone aq të larmishme, saqë shkojnë sa nga narrativa në surrealizëm, apo nga tregimin gotik në realizmin magjik.

4- «E lirë dhe e shpenguar në sjellje, tek e shihje të shkonte në fakultet apo të shëtiste me shoqet në xhiron e madhe, ishte e pamundur mos ndesheshe me sytë e saj të mëdhenj e ngjyrë gri, në mesin e të cilave, qëndronte një pikë e zezë, më e madhe se ç'është tek njerzit e zakonshëm." Kjo ishte Jasmina Goçi. "Përse je kaq e bukur?" - e pyeti ai përpara se t'i thoshte mirupafshim. Jasmina u skuq. Asnjë djalë nuk i kishte folur në atë mënyrë. Kishte dëgjuar me dhjetëra deklarata dashurie, përgjërime e lutje të pranonte kërkesën e tyre për dashuri, por asnjëri s'e kishte shprehur kaq bukur, kaq thjesht dhe kaq sinqerisht." "Unë jam vlonjati Joseph Mossanga – tha dhe nisi të këndonte. Kjo mbrëmje ishte më e rëndësishmja sepse për herë të parë di t'i këndonte asaj." Në Tiranë e viteve '80, po niste një dashuri gati e pamundur. Hegel-i tërheq vëmendjen që të gjithë burrat janë të bukur vetëm nga e dashura e tyre, jo më nga gruaja. Joseph Mossanga kishte nur në çdo pjesë të trupit, në çdo lëvizje, në buzeqeshje, në mënyrën e të folurit, apo dhe si këndonte. Duhet të jesh në gjendje ta dallosh bukurinë nga nuri. Nuri është një cilësi e veçantë që s'ka asgjë të përbashkët me bukurinë apo shëmtinë. Po ta dinin studiuesit, do të përgadisnin një histori të nurit. Ai ka shumë gjëra të mistershme. Përmban lëvizje të parëndësishme, yçklina apo të tjera dukuri. Historia e dashurisë së Jasminës me kongolezin pediatër, por njëkohësisht dhe vlonjatit e këngëtarin Mossanga, është histori e denjë për çdo roman. Problemi më serioz me të cilin është përballur romancieri Fate Velaj është fakti se kishte në dorë një histori nga realiteti dhe i duhej shumë mjeshtëri për ta përpunuar në mënyrën më letrare dhe me një strukturë dramatike të denjë për roman bestseller. A e ka çuar deri në fund këtë ngasje...? Me bindje të plotë më duhet të them një PO. Ja ka arritur.

5- Në këtë roman, të gjitha të papriturat e protagonistit por dhe zgjidhja e tyre, janë të lidhura me një mosmarrëveshje të rrjedhur nga një fenomen që kërkon shpjegim: një atdhe i dytë që zbulohet "hap pas hapi", një diktaturë mizore që shtyp çdo të drejtë dhe liri, dhe Vlora që protagonistit e dashuron marrëzisht. Edhe kur dëbohen kongolezët (viti 1990), Joseph Mossanga qëndron në Shqipëri. "Jam vlonjat" është refreni i tij. Madje edhe kur është në ditët e fundit të jetës, koha kur tumori i ka përfshirë gjithë trupin, ai vjen nga Brukseli ku ishte vendosur bashkë me Jasminën, (lë klinikën e tij stomatologjike) për t'i kaluar ditët e fundit të jetës në Vlorë. Madje shkon tek shtëpia e Petrit Pemës që e priti i pari me aq dashuri në vitin 1966. Atëherë, çfarë ndodh? Personazhi në roman do të duhet të sqaronte faktet. Joseph Mossanga bën një nga përrnderimet më të ndjera ndaj miteve, legjendave, frymës e traditës mikpritëse të përjetshme vlonjate, që vazhdon të jetë e fuqishme edhe në jetën e pas viteve 1990. Si shpjegohet që letërsia e mirë, arti ka gjithmonë nevojë për të hymnizuar personazhin, për vënë në skenë të bukurën? Mosshpjegimi që vjen nga ky përrnderim përbën esencën e fantastikes. Fantastikja pushton kohën dhe kokën e lexuesit. Përballë kësaj ndodhie të jashtëzakonshme, personazhi - dhe bashkë me të dhe lexuesi - do të futeshin në ndërëdymje: si ta asimilojnë atë që nuk ngjan me veprimin normal të kësaj bote? Pikërisht te ky dyshim qëndron fantastikja. Tentativa për ta shpjeguar ngjarjen, përrnderimin në fjalë, do të thotë ta prishim fantastiken. Tek fantastikja e krijuar mjeshtërisht prej autorit përmes lupës së imët të mikroskopit, dallojmë edhe shkrijren e disa gjinieve letrare. Ato ndihmojnë njëra-tjetrën. Megjithatë syri i stërvitur mirë në lexime, i sheh vijat e holla ndarëse të tekstit rrëfyes, tekstit eseistik, filozofik, habinë e ngrohtë të përrallës, mahnitjen e gjëagjëzave të mprehta, intertekstualitetin që bën lidhjen midis kohëve, por dhe ironinë intertekstuale për të ndriçuar vrimat e zeza të rregjimit. Fragmentarizimi i teskitit, realizuar përmes kronikës rrëfyese, e merr përdore lexuesin, duke e larguar nga realitetet e rëndomta, kakofonia e kotësisë, duke e orientuar e drejtuar drejt artit të madh, përmes magjisë së fjalës dhe strukturës zbatimëse të shndërrimit të ndërtuar imtësisht e me kujdes. Joseph Mossanga e ka kuptuar tashmë plotësisht se e kaluara peshon tmerrësisht, sepse, megjithëse rregjimi komunist ia kishte bërë fërtele fëmijërinë, traumatizuar adolehencën dhe pëgjakur rininë, kishte triumfuar ai, mbi atë. Veçse, ai kishte triumfuar duke sakrifikuar, madje shumë pjesë e kujtime të tij kishin vdekur. Ai mbijetoi vetëm sepse u sakrifikua. Ai kuptoi më mirë se të gjithë se në Shqipërinë e kohës i vetmi qëllim që shpëtonte, ishte qëllimi i sacrificës. Ajo që i mbeti si dashuri, ishte Jasmina dhe Vlora ...

6- Në vend të mbylljes, do të na trokasin ende pikëpyetje për t'u dhënë përgjigje. Por themelore mbetet një: cili është vendi që do të zerë ky roman në hierarkinë kanonike të romanit shqiptar. Kjo histori e romanit Mossanga, ngjan se është "e vërtetë", histori që përvijohet me kthesa të papritura dhe bëma ekstravagante. Me fjalë të tjera, edhe pse këtu nuk përdoret e jashtëzakonshmja, rrethana shkakton sensacionin e së zymtës, sipas stilit më të mirë të narrativës gotike. E zymta e diktaturës është ngjyra e vetme e romanit. Deri tani, në katër romanet pararendëse, Fate Velaj ka shkruar përgjithësisht brenda traditave më të mira e të pastra të romanit. Tek Mossanga kemi ekstravagancë stili dhe strukturë delikate, sarkazëm matanë limiteve, ambicie përkufizimi dhe përgjithësimi, gjallëri epike dhe pse jo, duhet pranuar: një pedagogji të fshehtë mbi letërsinë. Të gjitha këto, në një version të ri të traditës më të mirë të romanit të sotëm, e shprehur përmes një interpretimi të përveçëm të përvojës të romancierëve më të mëdhenj bashkëkohorë botëror.

Poeti ngrihet nga tavolina e punës dhe rri pak mendueshëm, dorën tek mjekra e dendur. Sapo i ka vënë pikën e fundit një vepre të re. Ka nevojë të dalë pak. Hap derën dhe, pak para se ta mbyllë pas vetes, kthen kokën. Buzëqesh pak, si të ketë zbuluar diçka. E kishte nuhatur, por tani i duket më e qartë: kjo botë e vogël aty, me ato pak sende materiale fillon t'i shfaqet sërish, në kurriz të asaj tjetër, të madhes, që e kishte pasur në kokë dhe shkarkuar në letër. Bota reale po rimerr të drejtat e veta. Për ca kohë, në shkrim e sipër, ka qenë i përhumbur në një botë tjetër shumë më të dendur e të errët, të lakmueshme e të paparashikueshme...

Zbret ngadalë shkallët dhe del në rrugë. Sytë i vriten nga drita e bardhë e borës, trembet pak nga kjo dhunë dhe, pa e lutur shumë, kthehet sërish në atë botën e madhe: botën e kujtimeve, ëndrrave, shpresave dhe keqardhjeve, pendimeve dhe gëzimeve, në një botë që tanimë, pas kaq shumë vitesh mbi supe, i duket e vetmja botë e denjë për t'u jetuar. Sepse ajo tjetra, ajo që ia vret sytë dhe e trazon dhunshëm, nuk ka më asnjë pushtet mbi të, nuk ka ç't'i tregojë më, është pa interes. Atëherë duke e strukur pak qafën në jakën e xhupit me kapuçin aty afër për ta izoluar sa më mirë nga bota përreth, poeti shtrohet mirë, edhe një herë, në atë botën tjetër nga e cila s'mund të dalë më: në botën e Tinës.

Poeti e di tashmë historinë e Zhuangzisë, plakut që ra në gjumë dhe pa ëndërr se ishte një flutur, dhe i zgjuar befas nga gjumi, nuk është i sigurt se çfarë është tani, një plak që ëndërron se është flutur, apo një flutur që po ëndërron se është Zhuangzi. Edhe ai e ka provuar këtë: shpesh i është bërë se jeta e ëndrrave është ajo e vërteta, e se ajo ku e sheh veten duke ecur apo u ulur në barin e vet të dashur, është e rremja. Në këtë pikë, ai e di fort mirë se është një vëlla i Pessoa. Dhe e ka bërë zgjedhjen e vet: tani e tutje do të jetë në botën e kujtimeve që nuk i fashiten, por që, çuditërisht, nuk janë fikse, nuk janë të ngurta. E ka pikasur se në këto kujtime pa konture, pa kufij, vijnë të kapërdihen disa vegime që i vijnë nga e ardhmja. Sepse poeti nuk është një përshkrues i thjeshtë i asaj çfarë sheh, poeti nuk është regjistruer i botës, por është një krijues bote, dhe çdo krijim nënkupton një ndërhyrje, në këtë rast të pavull-netshme, të disa imazheve që vijnë vetvetiu nga shumë pika të hapësirë-kohës. Poeti është kështu pikëtakimi i përmytur nga disa behje të së kaluarës dhe së ardhmes që vijnë të marrin një

Shënime për vëllimin poetik "Rapsodia e gjetheve", Buzuku, 2024

# Rapsodia e Abdullah Zenelit për gjetthet

Nga Urim Nerguti

formë tek e tashmja. Kushdo që është rrekur të flasë apo të tregojë për jetën e vet, e ka parë veten të përmytur jo vetëm nga ajo që e ka përjetuar në të kaluarën, por edhe nga disa vegime që i vijnë nga ardhmja, për rrjedhojë të krijuara. Kështu, çdo autobiografi nuk do të kishte asnjë kuptim pa njëfarë doze trillimi. E tillë është dhe Tina, një figurë gjysmë reale, gjysmë imagjinare, që përbën dhe qendrën e botës së poetit të thijnur.

Tina ka ikur. Është koha e vuajtjes, zisë, harresës. Por në këtë botë, asgjë nuk shkon sipas planit. Thënia e stërpërdorur se koha i shëron të gjitha, është një pseudo-ngushëllim, sepse në disa raste ajo nuk shëron asgjë, në mos i acaroon gjërat. Nga vetë ikja e Tinës, figura e saj, përfytyrimi që i bën poeti, mvishet pak nga pak me njëfarë aureole të misterhme e cila e magjeps, mahnit, por njëherësh dhe e ligështon poetin. Çastet e kaluara bashkë të poetit me Tinën gjenden kështu të pajisura me një status të dyfishtë: nga njëra anë, këto çaste kanë prirje të përjetësohen të tilla siç janë, të fiksuara mirë, nëpërmjet kujtimeve vendesh apo emrash të njohur dikur, dhe nga ana tjetër, ato pësojnë goditjen e vazhdueshme të imagjinatës së poetit, duke bërë që këto çaste të marrin formën hibride të një kujtimi të përjetuar dhe ëndërruar, tashmë me një jetë të vetën të pavarur. Tani është ky kujtim-ëndërrim ai që e zotëron poetin, jo më poeti atë. Si të themi, poeti pëson atë goditjen prustiane që e kthen kujtim-ëndërrimin në një genie autonome e cila shpëshillet vetvetiu, duke e marrë madje me vete poetin në një lëshim të pavullnetshëm. Dhe pikërisht këtu lind vepri e vërtetë, në këtë kapërthim mes

ëndërrës dhe realitetit që e kapërcen poetin. Vepri vetëkrijohet, vetëshkruhet, vepri i zgjedh dhe përzgjedh vetë vlerat e veta.

Poeti endet. Nuk e dimë mirë ku është poeti, ku ndodhet ai, në ç'pjesë të botës, dhe ashtu si formulimi i Eisenbergut që nuk na jep njëherësh shpejtësinë dhe vendndodhjen e një thërmije, ashtu dhe ne s'mund ta përcaktojmë vendndodhjen e poetit përdërisa shpejtësia e kujtimeve dhe ëndërrimeve është maksimale. Për poetin, gjithçka ka dhe mbart vetëm një emër: Tina. Rrugët, autobusët, linjat, baret, pemët, katedralet e Prishtinës, Parisi, Frankfurti, në të gjitha këto vende sillet hija e Tinës, herë lozonjare e gjallë aty, e herë një imazh i humbur diku në skutat e kujtesës. Gérard de Nerval, poeti dhe shkrimtari gjenial francez i shekullit XIX, kërkonte Atë, vajzën ideale, tek çdo figurë femërore që i vinte nga kujtimet apo ëndërrimet: Orelia, Silvi, Oktavia, Anzhelika e plot të tjera, që të gjitha formojnë vetëm një, Gruan ideale, Xhenin e cila s'iu përgjigj kurrë, por që Nervali do ta donte dhe adhuronte edhe pas vdekjes së saj. Por si të mos kujtojmë këtu dhe gjeniu amerikan, Edgar Allan Poe, me figurat e tij të paharrueshme femërore, Morela, Ligeia, e sidomos Anabel Li, që poeti madje e përmend në njërin nga këto poezi-botë. Poe, poeti dhe shkrimtari që e kërkonte përmes ëndërrimeve të mugëta e të errëta të mesnatës Gruan e munguar, gruan e dëshiruar, e cila shfrytëzon çdo lodhje apo këputje të kokës së Poes nën avujt e alkoolit për t'iu rishfaqur aty, tek dera e vetmisë, si një hije e butë që afrohet pambarimisht pa mbërritur kurrë. Edhe për poetin tonë të munduar nga pesha e kujtimeve, Tina është gjithmonë aty,

e ëndërruar, e dëshiruar, e xhelozuar, dhe kushedi, mbase dhe e penduar... A nuk ishte Albertina e Kërkimit të Kohës së Humbur që pas largimit nga rrëfyeni, kërkon pak më vonë që të rikthehet të jetojë sërish me të? A nuk është Albertina ajo që e qorton rrëfyenin që përse ka dërguar një ndërmjetës, sepse po t'ia kishte kërkuar vetë, ajo do të kthehej patjetër? Mes rrëfyeni dhe Albertinës kemi kështu një nga ato misteret e dashurisë dhe xhelozisë, tipike prustiane, ku luhatjet e shpirtit janë aq të lehta e aq të pandjeshme sa mund të habitemi pastaj që përse bien gjetthet nga pema, kur nuk kishte kurrfarë ere apo lëvizje ajri?

Po Tina, ku është sot? Në ç'ujëra noton vallë? Tina, e mveshur me të gjitha cilësitë e të gjitha grave të botës, e kthyer në modelin e Gruas së dëshiruar, dashuruar, kërkuar e mbase asnjëherë gjetur, Tina endet në kujtimet e poetit, një Tinë letrare e hollë, e rafinuar, që vrapon pas librarive të Parisit, që shkruan poezi të ndjera e që përvidhet mes vardisësish pa të kapur kurrë, Tina është ajo e poetit, por është dhe e jona, e ne lexuesve, një Tinë që në mos e paçim takuar kurrë, e kemi ëndërruar, lakmuar e mbase dhe krijuar vetë. Ajo e poetit ka pasë dikur një prani fizike, me një lëvizje të saj mund të lëshonte poshtë një gjethe, ndërsa trunghi mbetej gjithmonë aty, gjithnjë e më i vetmuar, me gjetthet që i binin një nga një e që me t'u këputur, jo kurrë nuk do të ringjiteshin më në degë. Sepse, siç thotë dhe Pessoa, vetmitari i madh, është një gabim të mendosh se pranvera u rikthe, apo pranvera rierdhi. Jo, asnjë pranverë nuk kthehet, asnjë gjethe nuk përsëritet, asgjë që ka qenë një herë nuk do të jetë më. Dhe poeti e di fort mirë këtë. Thirrjet e tij për rikthimin e Tinës, nuk janë thirrje për një përsëritje të asaj që ka kaluar, por për një fillim të ri, si një dashuri e cila do ta kishte humbur kujtesën dhe do të ishte e pamësuar me kleçkat e saj. E ashtu si nuk ka dy gjethe njësoj, ashtu dhe kjo dashuri e Tinës do të ishte krejt e re, jo e rilindur, por e lindur dhe pa asnjë frikë për të çelë një shteg të ri, të parratur nga asnjë dashnor i botës, nga asnjë Romeo e Zhyljetë, nga asnjë Tristan dhe Izoltë, nga asnjë Leila dhe Kais që pas refuzimit të Leilës do të marrë emrin Mexhnun, i Çmenduri pas kësaj dashurie në shkretëtirë.


Por Tina nuk do të kthehet, sepse asnjëherë s'ka ikur. Ajo jeton me Poetin, njëherë e përgjithmonë.

1

Ngutem tek po bie shi. Pasdite. Në Prishtinë. Newbornit rrjedhin lot shiu. Lajnë grafitet. Ndonjë nënshkrim të zbehtë. Në ngutje e sipër. Një V qenka bërë Y. Diku shkrimi i paqartë bërë edhe më i paqartë. Rrëmbyeshëm futem në Monaco. Furriku më pret si gjithnjë. Mikpritës. I ngrohtë. Zë e shikoj majtas. Djathtas. Preku me sy fundin. Murali më fton i heshtur. Nga tri tavolina mermeri zë qoshin. Afër kam një prizë. Se i ftohti ka harxhuar baterinë. Më ngutet. Do të më ketë shkruar Tina. Jooo. Tina më ka harruar. Jo. Heshtje e stërzgatur. Do t'i ketë ndodhur gjëkafshë. Ajo që drithërinte muzgjeve. Bulevardeve pa fund të Parisit. Frankfurtit. Berlinit. Qe një kohë tjetër ajo. Nuk dinim gjë për pandeminë. As për fjalët e botës. Sidoqoftë ajo drithërinte. Mbante një të fshehtë. Shumë të fshehta. Pa fund. Sepse ajo qe gatuar për mistere. Kështu janë Tinat. Gjethe vjeshte. Ndaj muzgu duke drithëritur. Nga çfarë? Limontia. Zverdhja. Vjeshta. Dimri që troket me shi. Tek shndërrohet në fjolla bore. Sikur ky i kësaj pasditeje që lag sheshin Medlin Ollbrajt. Bustin e saj. Shifjollat që i rrjedhin syve. Më bëhet se po qante vetë bronzi. Sikur Tina përhumbur të fshehtave të saj. Mes drithërimash. Ja Iphone jep shenjë gjallërimi. Tani do të futem mes të fshehtave të komunikimit. Leximit. Frymëzimit. Shkrimit. Të një rapsodie për gjetthet. Në këtë ndaj muzgu me shi e borë.

2

Tina, gjethe e zverdhur vjeshte, ra nga degë që e rrihte fort era. U soll sakaq u përdroth derisa përqafoi tokën. Lagur nga fjollashiu në një pellg të këmbët e mia. I hodha një sy. Tinagjethe po qante. Rënë nga trunghi mëmë larg rrënjëve, larg diellit, larg reve që i zhdavariste



era. Një frymë e fortë pragdimri. Po Tina, Tina ime ku ka rënë? Ah, ajo s'po bëzuan qyshkur. Harruar diku bulevardeve si atë ditë, oh atë ditë në Champs-Élysées. Ajo para e unë bri saj. Shend e verë. Jo! Tinën e pata lënë të dremitur në nëndarjen e 15-të te Porte de Versailles. Qe shkëputur trunghi që isha unë e qe futur rrëmbimthi në linjën 12. Se nga iku kurrë nuk e mora vesh. Mbete i nemitur si tani tek po ngrohem me ajër Monacoje duke rrëmuar rrjeteve, viberëve, vacapëve. Asgjë as në kutinë e mesazheve. Tina moj, Tinaaaaa, më vjen një klithmë nga brenda e nuk më del dot. Ç'është ky zë kaq i ngjirur? Vjen nga shiborëtimi i ndaj të ngrysurit, apo kujtesa ime e molepsur? Rrëmoj pa fund e ajo nuk më shfaqet askund. Tina ime bjeshkë. Tina ime breshkë. Tina ime pjeshkë. Aromë pjeshke. Zhguall breshke. Gjetthajë bjeshke. Nuk dorëzohem jo, nuk dorëzohem. I bëhem hije drithërimës së saj. E marr me të mirë tundimin tim të marrtë. Këtë të martë. Pasdite vonë. Derisa errësira ka pushtuar tashmë sheshin Madlen Ollbrajt.

3

Tina, Tina moj s'ka si Prishtina. Ja, nga Monaco shoh Memorialin Heroinat. Heroinat moj, heroinat. Përruar dymijeshtatëmbëdhjetën, kur ne po thurnim ëndrrat. Ti tuat, unë këmbadoras të miat. Asgjë për t'u veçuar pos këmbënguljes kryeneçe për ndonjë varg, ndonjë reflektim çasti se jeta vetëm çaste a nuk është, moj? A nuk është? Hë fol! Jepi, siç di ti të shpërthesh. Po, prit pak, prit. Se me Heroinat e kam tani. Seriozisht ta them. A nuk

janë njëzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë medaljone për një portret gruaje HEROINË. Se ato të gjitha, njëzet mijë, moj, njëzet mijë, sa i përllau dhuna në mësymje lufte u gjakosën u njollosën u përllotën për këtë liri që gëzojmë unë e ti. Unë e ti e të tjerë, por që po na rrëmben lakmia. Lukunia. Bezdia. Tina, ti e di mirë Tina, se në mes Memorialit dhe Monacos (ah sa nistore rasti MM, si dy mijë vjet pas Krishtit), është një bli që ende mban gjethe vjeshte. Që bien tokës si flokët e mi të thijnur, si mjekra që m'i ngjan të Tolstoit, atij moj, atij të Anës. Po ti nuk je Ana. As unë Dantesi. Të kujtohet ç'frikë kisha kur zbrisnim nëntokës së Parisit, metrove pa fund, tek të mbaja për krahu. Çuditëse se kisha të ftohtë. Drithërija si ti nga frika mos hidheshe si ajo Ana e zhgënjyer. Tina, të lutem mos u zhgënje me mua. Ti je vetë një Heroinë derisa ke duruar tek e mia. Pasha flokët e mi të dendur të thijnur, nuk të gënjej. Kam pasur frikë të tmerrshme, po atë e kam harruar tashmë, siç harrohet ajo aroma e këtij bliri përballë meje e Memorialit. Çdo mesqershor, dehëse sa s'thuhet. Si dashuria jonë. Jo, moj jo, më shkau goja se unë nuk di të dashuroj. Derisa iu besoj ca si tepër zemrës, ndjenjave, lotëve.

4

Ja, edhe pak e shtuna do të rrokulliset si gjetthet e këtij bliri mes Heroinave e strehëve të urbanit 3 e 4. Ti e di, herë-herë pres 4-shin falë kartës së pensionistit. Jo se përtoj të ec, por shikoj sa andej, sa këtej tek më zgjohet kujtesa skutave pluhurosor.

Tej zgafellës drejt Grandit dikur, ah dikur, shtrihej një shesh si oborr i brendshëm haciendash. Aty diku ishte ëmbëltoja Tropikal. Bënte kafe të mira që ç'ke me të. Espresso që Ismeti, ai çuni i Medvegjes, na i njomte ajkë fshehur padronit. Po për besë. Pinim kafetë pothuaj çdo ditë. Se Pallati i Shtypit afër. Thyenim monotoninë e pushtimit të ngadalshëm. Rezistonim me biseda pa fund, njëfarë qerthulli si ai i monparnasëve. Tekiu, Musai, Xhema, Beqiri, Shaipi dhe verës përherë Bekimi. Odiseu ynë i mendimeve, shpresave. Një Arbor Vitae që kishte lëshuar rrënjë metropoleve, kontinenteve, studiove më prestigjioze. Krenar se përhapte shqiptarinë, gjenin, bukurinë. Tina, ti atëbotë sapo kishe lindur, ku ta dija unë që do të futeshe njëditëzaj thellë në çdo imtë të qenies sime. Mënjatë kjo Tina, të vazhdoj dhe pak me Bekimin. Sapo i ishim futur në Studio Buzuku shkrimit të asaj që do të merrte dhenë. E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme. Po, moj po, qe jeta e tij. Shkruar vetë nga ai në dy gjuhë. Shqipja patjetër! Tani t'i kthehem vetmisë. Iku ajo kohë e stuhishme. Më ikën edhe shumë nga miqtë. Po ti bën më të mirën atje ku je. Rrit filiza. Ushqen gjethe të reja shprese... Çfarë ka kjo linja 4 që vonon? Mua më turbullojnë mendimet. Tropikali ka tretur qyshkur. Më mjafton Monacoja. Gjethet e pakta në degë dhe këto të rëna që shushurijnë si mendimet e mia. Tina, ushqej pak edhe këto pak kujtime. Janë rugëtim yni i një kohe pa kthim. Tina! Tina, moj. Tinaaaa! Tinaaaaa! Tinaaaaaa!

5

Linja 4 po vonon Tina siç po vonon hëna e re të më shfaqet mes reve të zbehta, por kam gjetet që gudulisin këmbët. Tinagjethe pa fund në këtë ndaj natë. Ditë e gjatë Tina ndërsa më vijnë jehe kambanash të Notre Dame. Ceremonia në kulm. Elitë bote në anijatën e saj. Ne i patëm rënë Tina rreth e për qark një muaj para se të ndodhte hataja. A thua qe ters dashuria jonë, jo jo, këtë nuk e them dot. Sigurt Tina. O unë, o ti, o e shtrenjta, e shenja, e sheshta dashuri. Them e sheshta, siç është deti pa erë. E ne vendnumëronim. U harxhua uji, u harxhuan ushqimet, u harxhua koha pritur së koti. Po ti si gjithëherë i merr gjërat me poterë. Dale moj, dale! Mos hesht! Bëju shoqëri organove që jehonin thekshëm, sepse ato nuk e durojnë indiferencën tënde. Tersin, ikjen, arratisjen që veç ti e di çdrejtim more. Tek përpjia koti zgafellës së linjës 12 konturet e tua zbehur si të kësaj hënë që përpëlitet reve të shkripta. Tina, përse nuk shkuam në Paris të paktën për kërkimfalje. Tersin e zjarri që dogji edhe dashurinë time, Tina, për ty, për Notre Damin që tani i rikthehet mrekullisë. Edhe pse unë nuk iu besoj fort mrekullive. Sepse ndodhin si përherë kur ne humbim shpresat. Buka të duhet kur je i uritur, si mua tek pres linjën 4. Por, ajo po vonon, siç po vonon hija jote reve të këtij qielli të shkriфтë. Më bëhet se tokës ti po ia bën lojën e gjetheve që një frymë e lehtë vjeshte të vonë i plandos përdhe, drejt këmbëve të mia. Çudi, dashuri pa bukë, gjethe që gudulisin. Tina, dila nga çeltna tok me hënën, të paktën për një imtë se ja, autobusi i verdhemë, katërshi im shpëtimtar duket se arriti. Është vonë, ka vende të lira sa të duash. Kohë për të marrë veten. Të ngopem së sodituri rrugënaresh drejt shtëpisë (që po stoliset për festat e fundvitit), ku më pret natë e gjatë me pak gjumë ëndrrashumë. Nuk ke nga të ikësh, Tina! Tinaaaa! Tinaaaaaa!

6

Më në fund, Tina, 4-shi ja po vjen. Një ndalesë para udhëkryqit mu pranë BQK-së. Bankës Qendrore të Kosovës moj, aty ku flenë paratë në qarkullim dhe ato që presin fatlumët më 1, 15 e 20 të muajit. Shërbyesve jo vetëm civilë, pensionistëve, moshe, pune e veteranësh lufte që sollën lirinë! Por që shpërblehen si mos më keq. Për pensione nacionale të mos flas Tina, shteti ka të tjera prioritete. Tani a nuk nisin dhe fushatat, premtime pa fund moj, pa

fund. Saora kalojnë katër vjet, po të mos kërset ndonjë hata, mocion, krizë siç qe ajo e dymijenzetës. Ato pesëdhjetë ditë seç mjaftuan për t'u shembur një qeveri! Po, Tina, po! Ti sapo kishe marrë rrugë të largët. Hej, Doruntina ime! Kam një vëlla unë, por edhe një motër. Pa dyshim, do të të gjejnë ku je e ku s'je edhe pas... Jo, jo, nuk do të flas për mordjen. Tani vetëm fjalë të ëmbla. Si sytë e tu, si buzët e tua, si... jo, nuk zbres më poshtë se nuk më lejon etika. Ku e pata fjalën, ah, po, ti ike në kulmin e pandemisë. Unë po i ngjaja asketit ditë e përditë. Mjekra, flokët dhe kurrizi po shfaqnin limontinë. Dhembjen mënjatë Tina, më mjaftonin kujtimet. Jetoja me to çdo ditë, çdo natë, derisa u bënë dhe vite... Duhet të hipi në këtë linjën 4 se pastaj duhet pritur të radhës, ose këmbadoras itinerarit të çdoditshëm. Të ndaloj pak te ish-kinema Rinia. Një Monument Kulture në pritje, pa dyshim. Ti nuk e di me sa ndjesi i kaloj pranë. Më parakalojnë filma e filma. Të cilët a nuk e formuan shijen time për të bukurën? Shije kjo që të tradhton nganjëherë si vetë bukuria jote. Nuk të gënjej Tina, pasha këtë natë plot ndjesi. Ja, shkela brenda 4-shit. Tani do të numëroj bashkudhëtarët me gishtërinjtë e duarve. Janë pak. Shoh dhe dy goca. Sa të ngjan njëra. Je ti, apo...? E bën ti këtë, gjithmonë ke qenë rrush me befasira. Tina, mos luaj me mua. Kush është kjo goca që erëmon parfumin tënd? Tina! Tinaaaa, moj! Tinaaaaa! Fol! Fooooo!

7

Tina, lë pas shpine Rininë, ish-kinemanë. Autobusi merr kthesën në të djathtë. Në të majtë Qafa. Dikur Aleja e Shpëtimtarëve. Bëhej rezistencë me espresso, makiato dhe ndonjë picë, varej nga xhepat me vrimë. Dora, Loriku, Rozafa, Shpati, Gresa, Gallery... Në këtë të fundit ndalonim shpesh me Bekimin. Një foto, nga të paktat që kam me të, na e pati shkrepur dikush me Emën, Ramazanin... të Bogdanëve, që ta dish. Ma kujtoi një ditë kësaj pranvere etnomuzikologu me nam në Tiranë. Tina, tani autobusi bën një rrotullim të beftë, piruetë moj, si ajo e artit të akullit. Sepse ja, edhe unë po drithërij. Kujtime djersë të ftohta, derisa parakalojnë dyqane, kryesisht lagje artarësh. Stacioni Te Plepat. Kishte shumë dikur. Qe Qendra e Pionierëve aty. E pati marrë ndërkohë RTP-ja. Pas lufte AKP-ja. Shtet më vete, moj! Na ropi ne ish-rilindësve. Njëzet përqindëshin na e bëri rrokopujë. Po nejtë... Ah, prit, se harrova. Te Shpati i Shpëtimtarëve pati rastisur të vinte Ibra me Zimmermannin. Dy e më shumë orë zgjati seanca e tyre, aty në separën enkas për mysafirë të zgjedhur. Agi madje ambasadorit ia dhuroi një grafikë nga më të veçantat: Gjeli dhe Hëna. Iku tani kjo... Të kujtohet, moj, ajo unaza me zemër për 8 Mars si dhe diadema. A thua i ke ende në gisht unaze, apo në gjoksin e gufuar? Zgjedhur me nge Aty te Oxa Gold. Ah kjo Oxa! Po tani shkëlqejnë yje të tjera gjaku shqiptar. Dua, Bebe... Rita, ndërsa ngjitur ortari me nam, njëherësh edhe Optika Omega, ku ti kishe nevojë për syza. E mua më vlonin kujtimet për markat e orëve. Maestro Fadili dinte gjuhën e Darwillëve, Omegave, Omikronëve, Tissotëve. Serkisofëve të xhepit gjithnjë e më të rrallë. Me qostek. Zemerëkrishtë... Roskopët nuk i pranonte. Gjuhën e orëve ruse nuk e donte. Si unë çajin e rusit që pirë kurrë nuk e kam. Tina, po të bezdis me sa po kuptoj, por edhe mua po më bezdis kjo pritje e gjatë në semaforin pranë Parkut Arkeologjik. Majtas ajo fosilja e vjetër e komunizmit: Vëllazërim-Bashkim. Tutje Parlamenti. Tani i përditësuar: Multietnik. Me parti e lista. Me pozitë e opozitë. Ngreh e mos këput. Falje, nuk di pse, seç më kap nganjëherë kolla! Të shkruaj nesër Tina, Sheherzadja ime! Tina! Tinaa, moj! Tinaaaa! Tinaaaaaa!

8

Jo moj, jo! Kolla nuk më erdhi nga vitet, por sikur ndiej se është diçka që e shkakton. Sigurt jo e kuqja e semaforit, mbase... ah! E gjeta! Ngrehina gllabëruese e quajtur Komuna e Vjetër. Kërthi vija me prindin për të regjistruar lindjen e një vëllai a motre. 1962, 1964, 1966... E di ti ç'ishte viti 1966? Pak muaj pasi lindi Ilku theu qafën Numri 2. Ai Viç, Kryeviq që e shqeu Numri 1 si të qe një sanduiç. Nuk bëj shaka, moj, qe hata. Ende më rri në kokë skrivania e pjerrët. Një bishtpendë, kallamari e certifikata krejt



Foto © Gani Bytyçi

cirilicë. (Vonë, shumë vonë, kur dukej se erdhi liria, l-ja u bë ll, përcudnuar emri i tim vëlla). Ftesa, urdhëresa, pagesa dënimesh gjithfarëshe. Ti u rrite në tjetër kohë, kot të flas. Edhe gjetet e kanë kuptuar tek lirshëm shushurijnë, jeshilohen thua se pispilloren me grim pranvere a vere. Por, ja vjen vjeshta, shiu, pragdimri. Bie grimi, pason shkundullimi. Shoh në pritje të të gjelbrës së këtij semafori numrash në rënie, si të qe autobusi një anije kozmike me komandën 9, 8, 7, 6...! Ja e verdha, shndriti e gjelbra! Mua më tundet mejtimi. Iku 66-ta, iku cirilica, ikën ndëshkimet, para më shfaqet Muzeu! Me madhësi dritash e majtas mrizon, tej girilash e kurora drunjsh zburkruues, një sarkofag, zbuluar dikur në vendlindjen time. Disi në mjegull më kujtohet emri i Omonisë apo Harmonisë... kështu disi. Llapi im me damarë të nëndheshëm pa fund herë njomur e kishte, por edhe dheu fshehur jo më pak se mijëra vjet. Po, moj, po! Pranë një mozaiku. Gjysma e të cilit diku u tret, iku. Tina, mos ngrys sytë, mos rruadh buzët, mos lësho ato pak vetulla. Ç'të duhen masat, grimasat... kthehet një ditë e Orfeut i kthehet kostumi dalldi. Si të qe hyjni. Tina, të lodha Tina, por ja, e tillë është Prishtina. Kosova. Shqiptaria. Shqiptaria thashë, jo Shqipëria. Meqë ra llafi, në mesnëntor mora rrugë për truallin arbëror, me një krah shpresash, librash, dorëshkrimesh drejt miqve të shumtë, por ti askund Tina! Tina, moj! Tinaaaa! Tinaaaaaa! Tinaaaaaa!

9

Tina, nënta është magji më vete, edhe pse magjisë nuk i besoj edhe aq. Por, nganjëherë kur diçka shkon ters, edhe më vete mendja se ka diçka. Ka moj ka, siç na shkoi edhe ne... mua në të vërtetë, se ti je mirë derisa nuk bëzan. Dikur, ah dikur, ta ndieja frymëmarrjen kodër më kodër, por ti më more për lodër. Jo moj, jo! Nuk jam unë pelushi i ëndrrave të tua, dije këtë, lozonjaria ime. Tani, të vazhdoj ku mbeta mbrëmë së mejtuari derisa prisja të gjelbrën. Unë çava drejt e te Muzeu, Parku Arkeologjik. Sarkofagu... Po janë moj, janë tri faltore rresht. Para të mëdha u dhanë për restaurimin e tyre. Zgjati ca si shumë, madje u fol për abuzime, sidomos për këtë të parën. Por unë s'e ndaj dot drejtësinë, ka kush merret me të. Që ta dish ti, në meremetim e sipër, tek e madhja, thuhet të kenë hasur dhe eshtra njeriu. Me një kaaafkë dhe me shenja dhune... u hesht ky fakt. A nuk të shkon mendja te Pjetri i 1689-tës? Treqind vjet pas rënies së Dardanisë falë tradhtisë së aleatëve të rremë. Tina, sa gjumë kanë bërë në këto faltore ati e gjyshërit e mi. Ta them troç. Në të parën që viti 1948, vit ters, moj, ters. E thashë që në fillim. U prishën aleanca të reja, u krijuan më të reja. Ndodhi dhe Goliotoku. Im atë punëtor me mëditje, rrëmihte themelet e Teatrit. Çudi, edhe sot është shndërruar në punishte. Më

kujton Rozafatin. Punonte ditën, i ri, sapo kishte lindur ime motër. Unë do të vija në jetë pas katër vitesh. Ai flinte natën në faltore e lutej shqip që të nesërmen ta merrnin në punë. Sa gëzim të ndihmonte familje e farefis në mbitokën e sarkofagut, mozaikut, Vendenisit moj. Për gjyshërit do të flas nesër, Sheherzadja ime. Kam shumë për të thënë e ti gjethe e paventur, evergrini im, të dua shumë, duhet të kesh goxha durim. Halorja ime! Tina! Tinaaaa, moj! Tinaaaaa. Tinaaaaaa!

10

Tina, duket se jashtë ka pushuar era, tek nuk bien gjethe mbi sarkofag, as mbi eksponatet radhitur kryq e tërthor, një lëshim moj shekujsh guri e mermeri. Ndonjë rreze drite neonësh përvidhet degëve, gjetnajës së tejrralluar, e tëra në përgjim. Po, moj, po, një lapidarium disi në gjumë. Më larg qelqnaja e odeonit. Rrallë shoh aktivitetet. Ndonjë kolonë mermeri do t'i bënte nder, mbase me ndonjë projekt edhe bëhet tjetër herë. Po drithërij Tina, më sëmure me atë drithërimën tënde elegante. Por, unë vërtet drithërij tek dëgjoj lutje megafonësh. Të tri faltoret bëjnë një trio bend që të ngjethin, s'bëhet fjalë për drithërimë e mua më fluturon kujtesa. Gjyshi 1 (koincidencë me Prindin 1, mos qesh!) dhe Gjyshi 2 (nuk thashë Prindi 2, moj!) dikur futeshin në vetizolim në muajin e shenjtë të tyre. Kur njëri këndonte kuluvallahin, unë a nuk recitoja Po shkrihet bora, dimni po shkon. Kur Gjyshi 2 këndonte salavatit, unë ia krisja Në mes tuaj kam qëndruar. Secili lutjet e veta. Po s'e harroj dot që me tepsidovën e fatihen unë me Perëndija bukuroshe! Ty të falem e të lutem... Më vjen në gji të të futem... Nuk e kam me ty, Tina, Mos ke! Qenë kohë kur gjyshërit po ngrynin jetën. Gjyshi 1 me një bjeshkë vuajtjesh ushtari perandorak. Disa vjet Manastiri, që nga nëntëqindeteta. Vit ky i Alfabetit, moj. Pastaj Ballkanika e Parë. Dezertimi. Nuk po e zgjas, kalimthi. Ballkanika e Dytë. Botërorja e Parë, Botërorja e Dytë. Taliani. Gjermani. Partizani. Gjithë deri në Pranverën e '81-shit kur mbylli sytë! Gjyshin 2 gjithnjë si në mjegull, me një liber në dorë. E ruante si sytë e ballit. Për të ishte i shenjtë. Qindra herë lexuar, rilexuar, interpretuar. Bekuar. Ç'magji kishte kurrë nuk e mora vesh. Se unë po merrsha me magjitë e mia. Robinsonin. Guliverin. Afërditën. Nga jeta në jetë... nuk ma lejuan. Është pesimist, më thoshin, e unë s'e kisha haberin për atë fjalë. As frikën e leximit. E përpiva Gjon Zaverin, shenjtorin tim. Tina, mos më thuaj se jam i lojtur. I ndrojtur mbase dhe po. Që ta dish, me lexim kurrë ngopur. Sa pak rrugë e kaq mendime. Urbani merr një kthesë të vogël mu te Kulla e Sahatit. Shtatit të tij ndriqnëshumë ngjyra. Si të ylberit, thua. Jo. Si të LGBT-ve? Mbese. Gjithçka... Hahaha. A nuk e tha ai shenjtori im Bylbyl, ky shekull or e ças ndrohet: bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet; Dëgjoj kumbime në unison me ato të Katedrales, me emrin e këndshëm shenjtoreje: Dang. Daang. Daaang. Daaaang. Daaaang. Daaaang! Tina! Tinaaaa, moj. Tinaaaaa! Tinaaaaaa. Tinaaaaaa!

Për krijues si dom Nikollë Mazrreku, veprën e të cilit po e përcjellim me ribotimin e poetikës së tij, nëpërmjet poemave *Dukla* e *Sapjana*, duhet të flasim e shkruajmë sado shkurt për një dukuri të shfaqur në artin e kulturën tonë, pas vitit 1990; konkretisht, për atë që prej vitesh u quajt e vijon të quhet *letërsi e burgjeve*, një term që as ka lindur e as është ushqyer vetëm nga realiteti shqiptar, por ka origjinë të vjetër, që nga fillesat e artit në antikitetin grek e romak. Lidhet kjo me emrin e poetit romak *Ovidi*, i cili jetoi gjatë sundimit të perandorit August, dhe u internua larg Romës prej tij, në brigjet e Detit të Zi, në *Tomis* (Konstanca e sotme, Rumani) ku dhe vdiq, duke shkruar veprat e veta.<sup>1</sup>

Edhe gjatë Mesjetës ka pasur shkrimtarë e poetë, që janë burgosur dhe kanë shkruar në qelitë e tyre; në kohët më të vona e deri në shekujt modernë, janë dënuar artistë, si nga juntat ushtarake të Amerikës latine: Meksikë, Kili, Argjentinë; në kontinentin e vjetër, janë ndjekur e përndjekur figura të njohura në degë të ndryshme arti, jo vetëm në letërsi në Spanjën republikane dhe frankiste, në Itali e Gjermani, gjatë shekullit XX, ashtu si në perandorinë komuniste të Rusisë (BS). Mbrojtja e lirisë së njeriut, që gjendet në ADN-në e artistëve, u ka kushtuar jetën mjaft figurave të shquara.

Edhe në vendin tonë, brenda atij shekulli, ka gjeneruar, në ato kushte shpyrjeje e frike, një *letërsi e burgjeve*, i lidhur ky term me rrëzimin e diktaturës së rëndit e me emrat e P.Arbnorit, P. Kalakulës, V. Zhiti, H. Nelës, G. Lekës e V. Blloshmit, M. Kokalarit e B. Xhaferrit e të tjerë. U arrit të shkruhej kjo letërsi në kushte çnjerëzore të gulagëve, të shpëtonte e të nxirrej pjesë-pjesë në fshehtësi, shpesh, edhe të humbte. Pati ndonjë që, pas lirisë së fituar, *rrnoi për me tregue* dhe mori e shkroi kujtimet rrëqethëse të dënimeve e torturave në masë.... Tek këta radhitet edhe dom Nikollë Mazrreku, që kishte shkruar letërsi atdhetare e polemike në të mirë të Atdheut, para Luftës II Botërore e gjatë saj, por që u shpërblje me vite vuajtje të gjata burgimi dhe fshatrave me punë të detyruar nga Maliqi, Tepelena deri në Lushnjë. Veç burgjeve të Shkodrës, ai provoi edhe Burrelin e tmerrshëm. Këmbëngulja e tij dhe, ndoshta rastësisht, e ndihmuan t'i nxirrte jashtë qelisë shkrimet e veta, mbështjellë në copa letre e rroba që i merrte e motra Marije, në takimet e rralla me të dhe që i ruajti, për të parë dritën e botimit, me kujdesin e P. Zef Pllumit, para 24 vjetësh.

\*\*\*

Në këtë botim të ri të përmbledhjes që paraqesim sot, janë sjellë dy poemat e autorit: *Dukla* dhe *Sapjana*. E para, është një krijim romantik në vargje, që lidhet me temën e lirisë ku ngjarja vjen e zhvillohet në një principatë shqiptare mesjetare, diku në zemër të Shqipërisë, në një organizim mikroshteti të modelit *Dukat*, ku endet si kallëzim poetik qeverisja dhe drejtimi aq popullor dhe i drejtë i princit *Llezhder Gjika* me djemtë e vet, qëndresa deri në vdekje për mbrojtjen e principatës së tij nga armiqtë, dhe ngjarjet tragjike që ndodhin me princin e ri *Vasë* e vajzën e dashuruar prej tij: *Dukla*, me emrin e së cilës quhet edhe poema. Në të gjithë veprën autori i thur lavd lirisë dhe jetës së lirë të njerëzve, marrëdhënieve vëllazërore dhe harmonisë së një popullate brenda hapësirës që zotëron Dukati i Gjiksë, por, krahas kësaj, lexuesi do të njohë edhe anën negative të jetës: prirjen për tradhti e puç sundimi e pabesi, sidomos pas vdekjes së Princit. Lexuesi do të gjejë tek *Dukla* përshkrimin plot dashuri që u bën autori njerëzve të varfër, njerëzve të punës, botës së madhe e të pasur shpirtërore të tyre, thjeshtësisë së jetës, pa kreni e mburrje; ai idealizon në thelb marrëdhëniet e shtresës së ulët me natyrën, në harmoni me bukurinë e saj. Përfundimi i ngjarjeve e bind lexuesin se dashuria midis njerëzve duhet të drejtojë e të mbushë me jetë njerëzimin. Në përmasat e këtij zhanri, si një poemë ekzotike në përmbajtjen e saj, *Dukla* është një vepër letrare e thurur me mjeshtëri arti, me gjuhë të zgjedhur, me strofikë të pasur e metër shumë të rregullt; përgjithësisht e frymëzuar e mund të radhitet ndër krijimet më të qëlluara të kohës kur u shkrua.

Poema *Sapjana* është një zgjedhje e rrallë, si motiv: autori merr përsipër të na sjellë në poezi jetën baritore e blegtorale të fshatrave të Zadrimës: nga krahu i majtë i derdhjes së vjetër të lumit Drin – prej Vaut të Dejës deri në qytetin e Lezhës, pra, hapësirën e një fushe aq të begatë, ku shtrihen edhe sot 30 fshatra dhe që, për nga juridiskioni fetar, i përkasin (dhe

1 Publius Ovidius Naso (20 mars 43, para Krishtit - 17/18), i njohur si Ovidi, ishte një poet romak, bashkëkohës i Virgjilit të vjetër dhe Horacit, me të cilët shpesh renditet si një nga tre poetët kanonikë të letërsisë latine. Vepra e tij kryesore është poema epike *Metamorphoses*, shkruar në heksametra, në 15 libra, pasuar me *Heroidet*, *Medicamina Faciei*, *Ars Amatoria* etj.

# RIBOTOHET VEPRJA E DOM NIKOLLË MAZRREKUT

Nga Prof. dr. Tefë Topalli

i përkasin në vijim) Dioqezit të Sapës, që i jep edhe emrin vetë poemës. Nëse poema *Dukla* ka një vijë rrëfimi, dhe nis prej përshkrimit të një shtëpie të varfër (që na kujton përherë fillimin e poemës "Andra e jetës e Ndre Mjedës), me dy pleq e një vajzë me bukuri të rrallë, të cilët rrojnë në shenjtërinë e tyre, me të vetmën pasuri - një tufë të vogël dhensh, *Sapjana* e dom Nikollit ka për objekt përshkrimin e gjallë me aq shumë detaje e ngjyra të një principate mesjetare, të kohës paraosmane. Edhe këtu kallëzimi poetik nis me përshkrimin e një banese të varfër, ku gjithçka vjen e drejtohet nga nënë *Lezja*, një grua e ve, që atë ekonomi e ka ngritur me thonjtë e duarve, me bashkëshortin Gjon, që nuk rron në. Gjithë jeta e saj tashmë mbushet me dashurinë që ka për dy djemtë, nuset e tyre dhe fëmijët; janë tre breza që punojnë e gëzojnë në harmoni e vullnet pune me njëri-tjetrin. Krijimi i autorit, ashtu siç ka mundur të dalë nga vendi i dënimit, ashtu pjesë-pjesë dhe i segmentuar na vjen në njësinë e poemës, e cila, në thelb, është pasqyrë e bukur e jetës së fshatrave zadrimerë, me tablo të ravijëzuara nga lojërat e rritja e fëmijëve, tek prindërit e tyre, që mbjellin e korrin, vjelin dhe i gëzohen punës. Poeti ndërton disa rrëfime, të përshatshme për edukimin e të vegjëlvë për bindjen, dëgjuesën, premtimin, respektin për të mëdhenjtë, fjalën e dhënë, sinjeritetin, dashurinë për mjedisin dhe për kafshët shtëpiake. Hartuar prej një meshtari, të gjitha na duken se marrin vlerën e ushtrimeve katekistike. Është shumë tërheqës kallëzimi i tatë Lekës për *Cukun* e *Zinën*, *Marinin* e *Shaqen*, *Zanën* dhe gjithë kafshët e pyllit: korbë e dhelpra, gushaspeci dhe grishëla, fazani e gjeli kokot, kaprolli e gomari, kukuvačka dhe orlli, pëllumbi dhe këlyshi laraman, që i japin "dënim" djalit *kryegur* me emrin Cuk, por edhe e ia falin gabimin, pasi ai premtim të ndërrojë sjellje. Fabula për fëmijët përcillet me ngjarjen tragjike të mbytyjes në valët e përroit të rrëmbësishëm të një vajze të re. Po kështu, edukimi për punë ndiqet me aq interes edhe në tregimin *Kolë dëmbeli*, që nuk e donte as arën, as kopenë e dhenve; fëmijët bëhen dëgjues të rregullt të rrëfimit *Princ Vidali*, *Kanga* e *Valjanës*, kallëzimi i hallë Katrinës, historia e *Kasildës*, e të tjerë. Është për t'u shënjuar që autori ka përshkruar me shumë vëmendje hallet dhe lëngimet e banorëve, e njerëzve në moshë dhe atyre pa mbështetje, duke bërë thirrje që ata të ndihmohen në të mbjella e të korra, në muajt e vapës dhe dimrit të ftohtë, siç veprojnë me grishjen e kushëritit, Gaspër që vuan nga astma e i duhet klimë fshati e jo në qyteti.

*Sapjana* nuk ka tituj as për rrëfimet e gjata që thur poeti, ne i kemi emërtuar ata, sepse na

duken si poema të vërteta edhe në vështrimin sasiar, si janë: Kanga e Ndre Gjekës, ajo e rapsodit Kokli që u bën jehonë luftërave për liri në kohën e Gjergj Kastriotit, ka tregime edhe për fatin përulës dhe diskriminimin e grave fshatare e malësore, si fati i rëndë i Dilës së Ndokës, e cila keqtrajtohej prej të shoqit; mbreti i Shorëve është ndër më të goditurit, intermezot e ndryshme, si pauza midis kallëzimeve të gjata, por fabula - poemë më e mira e penës së autorit është *Sheta jetime dhe Lulokja*, e cila edhe mbyll veprën poetike të dom N.Mazrrekut. Kjo vepër e fundit e tij është më e arrira, jo vetëm lidhur me përmbajtjen dhe vlerën edukative për fëmijë, por edhe në anë artistike, e shtruar në vargje monokolonë e me gjuhë të zgjedhur, figura të thjeshta dhe e kuptueshme për moshat e reja, një kallëzim i ndjeshëm, me skena të dhimbshme e pak gëzime, siç ndodh e ngjan në jetën e gjithë brezave njerëzorë. Një synim më vete ka pasur dhe ka arrirë autori, kur sjell brenda veprës së tij ngjarje që evokojnë *Motin e shkuar*, kohën kur populli ynë i vogël, u përball me sulmet e mëdha e të gjata të një perandorie, siç ishin pushtimet e falangave turke, që u futën deri thellë Europës.

Poetika e dom Nikollë Mazrrekut në letërsinë tonë është e panjohur, sepse kështu mbeten, të mënjnauar jo pak shkrimtarë e poetë përgjatë disa dhjetëvjeçarëve, por kur i hyn brenda saj, tërhiqesh jo vetëm prej përmbajtjes së shpirtit shqiptar, por edhe nga forma e saj, që të shtyn ta perceptosh si vepër arti. Ai nuk pati kohë t'u kthehej shkrimeve të veta,

nuk kishte mundësi të bashkëpunonte me redaktorë dhe poetë, por trashëgimia e tij, na vjen ashtu e pastër dhe pa artifice, me gjuhë të shtruar të rrëfimit, me vargje ashtu siç i ka ndërjer ai, pa përsëritur sekuenca narrative, por me një vijë të qartë, për t'u përvetësuar e për t'u mbajtur mend. Vetë koha prej më tepër se gjysmë shekulli e gjenerimit të veprës së dom Nikollë Mazrrekut, tregon se ai ishte një talent i lindur, që doli mbi vështirësitë e jetës edhe në artin krijues në poezi e prozë, duke mbetur një bari shpirtëror i devotshëm dhe i paharruar për të gjitha ata që e kanë njohur në shërbimet meshtarake e më gjerë, në Malësi, Tiranë dhe në Dioqezin e Sapës, këtu në famullinë e Vaut të Dejës.

\*\*\*

Përveç romanit dhe dy poemave, bashkë me shkrime të tjera në periodikë të kohës, para e gjatë Luftës II Botërore, në veprat e dom N.Mazrrekut, alias Nikë Barcollës, lexuesi ka mundësinë të njihet edhe me një traktat polemike të jashtëzakonshëm, ndryshe një

ligjëratë shkencore e historike, gjuhësore dhe etnografike, me titull "Skandali Cordignano", shkruar prej këtij autori, midis 4 broshurave të tilla, hartuar si reagim ineletkual e aq atdhetar që u bënë në vitin 1941, kundër revistës italiane "Albania", botuar në Milano prej misionarit të njohur në vendin tonë, Fuvlio Corçignano. Ai erdhi e sherbeu në Shqipëri vite të gjata si profesor në Kolegjin Saveriane dhe me Misionin Shtetitë, hartoi gramatika e fjalorë dhe u njoh me identitetin dhe etnografinë shqiptare, por, se ç'ra në pozita ahistorike dhe një moment, në pranverën e vitit 1941, botoi një artikull jo shkencor për historinë, vijimësinë e shqiptarëve, gjuhës sonë të vjetër dhe racës epike të prejardhjes ilire! Ai shkoi përtej të papriturës, kur e paraqet Skenderbeun si vasal të mbretit të Napolit dhe zbeh qendresën e një populli kundër Perandorisë Osmane! Ishin nga Shkodra ata intelektualë që iu kundërvunë me fakte e prova, shembuj dhe studime europiane: së pari prof. Filip Fishta, i dyti dom Nikollë Mazrreku, të tretët: gjithë profesorët e Gjimmazit të Shkodrës dhe, në fund, polemikën më të hidhur, në vargje madje, e shkroi dom Ndre Zadeja ! Kush ka mundësinë t'i njohë të gjithë kto traktate apologjike, do të dallojë çfarë horizonti shkencor dhe me literaturë historike, na sjell në argumente të vetat Nikë Barcolla; logjika e tij e veçantë na kujton veprën e madhe të Imzot Frang Bardhit – Ispeshkëv i këtij Dioqezit, para 4 shekujsh, kur merr e mbron shqiptarësinë e Gjergj Kastriotit, kundër një frati boshnjak që e nxirrte Heroin tonë Kombëtar, me origjinë serbo-boshnjake! Polemika e bazuar në burime të cituara e vë dom Nikollin ndër intelektualët më të përgatitur të kohës në fushë të njohjes albanistike, për periudhën e gjysmës së parë të shekullit XX.


\*\*\*

Gjatë mbylljes së librit dhe dërgimit në shtyp, prifti i ri, dom Emiljano Paloka, famullitar i sotëm në Blinisht të Dioqezit të Sapës, na njofton se po kërkon dhe po gjen edhe disa krijime poetike e në prozë, shkruar nga dom N.Mazrreku në vitet kur ishte student

Teologjie në Romë e më vonë, deri në vitet 1944. Po u lëmë vend në këtë vëllim, edhe këtyre poezive të autorit, ku gjenden edhe dy sonete të bukura prej dy stinëve të motit "Vjeshta" dhe "Dimni", një lloj letrar në vargje, kur tingëllima aq të mrekullueshme, në ato vite, shkruante vetëm Ndre Mjeda e fort pak të tjerë. Gjithashtu, me to, le të shtojmë edhe dy novelizat "Neper hije të Skanderbegut" dhe "Sogje". Ai ka pasur bashkëpunime botimi me rivstat e njohura "L.E.K.A.", "Hylli i Dritës" dhe më vonë me disa shkrime te "Kumbona e së Dielles". Dëshiroj ta falënderoj dom Emiljanon për kujdesin dhe zellin që po tregon, për të nxjerrë në dritë figura me rëndësi e tregues të vërtetë të kulturës sonë, jo vetëm për trevën e Zadrimës, por edhe në rrafshin kombëtar, kur të njihen e të promovohen si *Opera omnia* e shkrimtarëve, poetëve dhe përkthyesve si: dom Jak Zekaj, dom Nikollë Mazrreku dhe dom Ndue Suma. Trashëgimia e tyre, që krijuan letërsi në kushtet e burgosjes, internimit dhe salvimit të gjatë, vetëm e vetëm se ishin klerikë katolikë, na bën thirrje ta publikojmë jo veç në planin shpirtëror e të merituar, por, në radhë të parë, edhe për ndihmesën që ata kanë dhënë për ruajtjen, lëvrimin dhe pasurinë e gjuhës amtare. Vepra voluminoze e dom Nikollit na shfaqet si prozë romanore, drejtuar historisë sonë kombëtare, ndryshe, figurës së Gjergj Kastriotit, hartuar në kushtet e qelive të burgut, dhe e botuar postume. Këtë roman po e sjell për lexuesin, sot, dom Emiljanoja, me kërkesë të përhershme të tij te ky institucion i lartë shkencor i vendit !!!

Më jepet ta përgëzoj përsëri, famullitarin e censhëm në lëmë të vlerave kulturore e gjuhësore, letrare e dokumentare, një klerik i ri, që po ndjek traditën e shkrimtarëve të vjetër të Sapës, si: Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Zarishi, Leonardo de Martini, Gasper Gurakuqi, Vincens Prendushi e të tjerë, që kanë shërbyer në fshatrat e Zadrimës e më gjerë, me vepra baritore në Malësinë e Veriut. Le të përkulemi me nderim ndaj këtyre figurave të shquara, duke iu publikuar veprat e hartuara dhe kujtuar herë pas here në përvjetorë, siç po bëjmë këtë vit me ish-famullitarin të kësaj kishe, poetin e historianin, publicistin e polemikun, përkthyesin dhe oratorin, poliglotin dom Nikollë Mazrreku.

Asgjë nuk ndryshuan në gjuhën e autorit, me qëllimin e mirë që lexuesit apo edhe studiues të mundshëm, të njohin verbën e përdorur të shkrimit të asaj kohe, kur shkrimtarët shqiptarë dhe rendi i intelektualëve përparimtarë, bënin përpjekje për njësimin e gjuhës letrare, jo veç si gjuhë administrate, por edhe variant i përparuar e i lëvruar në shkencë e letërsi....



Kur isha i ri, po edhe sa herë kam gjetur ngenë, kam shkruar dhe për kulturën e gjuhës në skenë e në ekran. Për pasion dhe për profesion. Përpos tekstit universitar për lëndën "Kulturë gjuhe" në degën e dramës e të regjisë skenike që jepja në Universitetin e Arteve, nuk kam mënauar të shkruaj dhe kumtesa a shkrime vlerësuese të "Drita", të "Gjuha jonë" e në organe të tjera dhe sidomos te revista "Skena dhe ekrani". Mjerisht ajo revistë nuk del më. Por një hapësirë pranuese për shkrime kësodore duhej. Falënderoj botuesin e gazetës "ExLibris", zotin Bujar Hudhri, dhe redaktorin e ri e të pakundshoq për nga mirësjellja, Andreas Dushin, që tregohen derçelë e pranues sa herë u jam drejtuar për "strehë" në faqet e kësaj reviste, tashmë nga më të lexueshmet.

Mbrëmjen e datës 17 janar, ishte premiera e filmit "Pasaporta" një film nga Eduart Grishaj. Filmi do të shfaqet në të gjitha kinematat e kryeqytetit. Një film i ri, bazuar në ngjarje të vërteta.

Eh, sa fjalë e çuditshme kjo pasaporta. Dikur e dikund shqiptohet dhe **pashaporta**, prej saj dhe **pashaportizimi** që do të thoshte të regjistrohesh si banor në një qytet, në zyrën e gjendjes civile. Por, pajisja me pasaportë e me vizë për të udhëtuar jashtë shtetit ishte dikur "mollë e ndalueme" për masën e gjerë të shqiptarëve. Pasaportë e pajisje me vizë nga ambasadat përkatëse kishin vetëm diplomatët dhe punonjësit e ambasadave e familjarë të tyre.

Mbas shndërrimeve superstrukturore e shtetërore të viteve '90, pasaporta do të bëhej e gjithkujt, por do të mbetej problem viza nga ambasadat a zyrat konsullore të përfaqësive të shteteve të huaja përkatëse. Ndërkaq, dëshirat për të udhëtuar jashtë shtetit, jo vetëm do të shtoheshin, po edhe do të shoqëroheshin (për fat të keq) dhe me daljen e grupeve kriminale e të strukturuar, që shisnin (e shesin akoma) pasaporta me viza të rreme (të falsifikuara) me çmime të shtrenjta, sidomos për ata që synonin largim nga Shqipëria për punë e jetë më të mirë në Amerikë e në Kanada etj. Dhe, keqbërësit që merren me këtë veprimtari, pak ta quash kriminale, janë bërë edhe më të këqinj se tregtarët e sklevërve të dikurshëm.

Kjo është dhe tema që shtjellohet në indin e filmit "Pasaporta" të regjisorit Eduart Grishaj. Dy vjet më parë, sikundër dihet, ai i dha publikut filmin "Sofi", me të cilin ai dëshmoi se, tashmë, përveç realizimeve si regjisor i programeve të suksesshme televizive, po bënte dhe një hap të parë, sa të madh e të sigurt, aq edhe kureshtjendjellës duke trajtuar një nga temat më të thekshme të fisnikërisë e të traditave të pavdira të malësorëve të Veriperëndimit. Figura e **Sofi Lekes**, do të hynte me atë film në njësinë e grave të shquara të letërsisë e filmit shqiptar, si **Lokja** e filmit "Toka jonë", si **Nica** te "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", si **Nënë Pashakoja** etj. Kam folur e shkruar më parë për atë film, së pari, në një intervistë me gazetarin Mustafa Nano në "Arnautistan", pastaj në artikullin vlerësues me titullin "Një film me vlera të mëdha artistike dhe me kumte shumë të rëndësishme", duke kundruar edhe disa dukuri të individualizimit e tipizimit gjuhësor në filmin "Sofi", po edhe me shqyrtime e theksime përgjithësuese për ligjërimin në skenë e në ekran. Një parashtrësë të thukët për vlerat edhe ligjërimore të filmit "Sofi" e kam përfshirë dhe në ribotimin e librit "Pesha e fjalës shqipe", që del së afërmi nga shtypi. Dhe, ja që, bashkëvendasi im, regjisor Eduart Grishaj, me mirësjelljen që e ka edhe nga vetja, po edhe nga tradita bujare e një familjeje fisnike si ajo e Grishajve të Malësisë së Madhe, ma dërgoi ftesën me emër, për mua dhe Leonorën, duke na bërë pjesë e atij përrurimi të bukur

# FJALË PËRURUESE PËR FILMIN "PASAPORTA" TË REGJISORIT EDUART GRISHAJ

Nga Akademik Gjovalin Shkurtaj



e të gëzueshëm në mbrëmjen e datës 17 nëntor. Pra, i meriton dy fjalë përuruese e përgëzuese për këtë film të ri, apo, si do të thuhej në ligjërimin profesional **për këtë ndihmesë të re e të vyer.**

Filmi "Pasaporta" vjen si një hap tjetër i sigurt, por tashmë me një temë aktuale, realizuar në mënyrë sa mbrësëlënëse e me theksime të aktualitetit të dhimbshëm të ployës njerëzore e shpirtërore që shkakton largimi në masë i të rinjve nga Shqipëria e nga trojet shqiptare. Një dukuri të cilën e sjell në film me mjeshtërinë artistike dhe gjetjet aq të bukura regjisoriale e të mishëruar në interpretimin nga një kast aktorësh shumë meritore, si ata që luajnë rolet kryesore, po edhe të gjithë të tjerët. Mjafton të themi se aty pamë (natyrisht me mall e adhurim) edhe artistë të mëdhenj, si Alfred Trebicka, Marjeta Ljarja, Romir Zalla e të tjerë, më të rinj, por të përzgjedhur me kujdes e tashmë edhe meritore e me përvojë, si Indri Shiroka, Kaona Matoshi, Akil Varfi.

"Pasaporta", duke u mbështetur, sikundër pohohet qysh në nëntitullin e filmit "në ngjarje të vërteta", na del si një vepër artistike me ide të rëndësishme e me theks të fuqishëm aktual e mirëfilli kombëtar shqiptar, me mbrujtje tematike e dramatike e gjetje artistike të gdhendura aq mjeshtërisht, saqë, nuk mund të mbetet vetëm me kaq. Ai është një film, në të cilin, me mjetet e sotme e me gjuhën filmike të zotëruar aq mirë nga Eduart Grishaj, **i bëhet jehonë e re një thirrjeje të hershme e të përhershme të shqiptarisë.** Ashtu si qortonte me të drejtë Atë Zef Pllumi, duke e vënë gishtin në plagën shekullore të

shqiptarëve si "armiqtë të vetvetit", regjisor i ri në moshë, por tashmë i rysur mbarë e thellë në idenë e shqiptarisë e të dashurisë për atdheun e vendin e vet, lëshon edhe ai, me mjetet e filmit, një kushtim të fuqishëm, duke u thënë të rejave e të rinjve shqiptarë të mos ikin, të mos ia kthejnë shpinën atdheut. Mbi të gjitha, duke ua hapur sytë që të shohin mirë e sidomos të mos bien pre e rruftanëve e grupeve kriminale, që për fitime të paskrupullta mashtrojnë e shpien drejt emigracionit jo vetëm të paligjshëm, po më së shpeshti, edhe drejt vdekjes apo, në rastin më të zakonshëm, në një punë të dorës së dytë, sikundër del kjo në rrëfimin e Edonit, personazhit kryesor të "Pasaportës", realizuar me interpretimin pak të thuasht të shkëlqyeshëm të aktorit Indri Shiroka. Në një çast reflektimi e vetëndjerjeje, natyrisht, jo vetëm i dëshpëruar, po edhe i penduar thellë, ai bën një monolog shumë kuptimplotë e ndikues. Mbi të gjitha shumë prekës e drithërues e me një intonacion e interpretim që të ngulet thellë në shpirt. Sa mirë që kemi aktorë të tillë dhe paçim sa më shumë.

Dhe, përtej këtij rrëfimi, në rastin e pranishëm, vjen në kundrim edhe rrethana se edhe vetë Indri është një aktor shqiptar i rritur në Itali, i cili ka ndërtuar një karrierë të suksesshme në kinematografi dhe teatër. Përpos dhuntive e zotësisë së tij të lojës si aktor, natyrisht, atij i shërben edhe njohja e përvoja vetjake, sepse edhe për një artist të tillë, në vend të huaj, "gaveta" është e rëndë. Edhe atij i vijnë në mendje fjalët e pavdira të atdhetarëve të Rilindjes "ku të duket balta, më ëmbël se mjalta, në Shqipëri."

Edhe realizimi i dialogut ishte në

shkallën më të lartë. Me shumë hijeshi, në thurimën ligjërimore që mbahet në një truall kryesisht të gjuhës bisedore dhe së folmes qytetare të Shkodrës, pjesërisht edhe me disa elemente të përzgjedhura nga e folmja e Kosovës, si p.sh. shqiptimi Kanadë për Kanadë e ndonjë dukuri tjetër në ligjërimin e Verës (interpretuar aq këndshëm e bukur nga Kaona Matoshi), shikuesi sheh se sa më ëndje është sjellë individualizimi e tipizimi i personazhve me anën e mjeteve gjuhësore. Ashtu si thoshte edhe interpretuesi i shquar italian, Vittorio Gazman "Aktori duhet të jetë i zoti të mendojë në dialektin përkatës e të shprehet në gjuhën artistike sa më kuptueshëm e natyrshëm".

2. Pasaporta është një fjalë gjithësi e re, më saktë një term i burokracisë zyrtare, por tema e filmit shkon edhe në shtratin e një brengje të hershme të shqiptarëve, në atë të kurbetit e të kurbetlinjve, na kujton dhe emërvende tipike të asaj dhimbjeje shoqërore që shkaktonte ikja e meshkujve në vende të huaja e të largëta, si "**Lëndina e Lotëve**" (në qytetin e Korçës), ku ndaheshin duke qarë familjarët nga djemtë e rinj e burrat që niseshin për kurbet. Me shumë përmallim, kjo plagë e shoqërisë shqiptare ishte trajtuar qysh te kënga "Qeraxhiu i Grebenesë". Teksa shihnim filmin me time shoqe, na erdhën në mendje edhe vargjet prekëse të asaj kënge:

"Qeraxhi të plastë kali, o mor qeraxhi, / na ndave nusen nga djali, o mor qeraxhi!"

Natyrisht te "Pasaporta" trajtohet "kurbeti modern", kurbeti i drejtuar dhe i organizuar nga ata që me një togfjalësh të kohës sonë quhen "grup kriminal i strukturuar" e që përbën një nga aspektet më shqetësuese, siç është shpopullimi apo largimi i të rejave e të rinjve dhe, për pasojë, shkretimi i fshatrave e krahinave në Veri e në Jug.

Me mjetet artistike të filmit dhe në një realizim mjeshtëror mahnitës (natyrisht edhe befasues, po të kemi parasysh moshën ende të re të regjisorit Eduart Grishaj), "Pasaporta" qëllon fort, bukur e ashpër dhe godet në shenjë. Ai padit dhe dëshmon se çfarë dëmi të pariparueshëm po i sjellin Atdheut e kombit shqiptar ata gjakpirës e keqbërës të quajtur "bosë" të mërgimit të paligjshëm.

Filmi duhet parë, po edhe riparë, duke menduar se çfarë mund (e duhet) të bëjnë shoqëria shqiptare, shteti dhe institucionet përkatëse për ta shmangur e çrrënjësuar atë lloj veprimtarie kriminale.

Dhe, sigurisht, ky film, përtej vlerave mirëfilli artistike, shërben mjaft mirë edhe për të dhënë një shtim të ndjeshmërisë (sensibilizimit) të opinionit publik dhe si thirrje e ligjshme në përkrahje të organeve të policisë e të shtetit kundër tyre.

3. Tema e largimit nga atdheu apo e internimit, pavarësisht prej shkaqeve, gjithmonë është konsideruar si një nga të këqijat më të mëdha. Në fjalët e urta të popullit tonë thuhet: "Vendin e huaj ta lëndofshin, por ti me këmbët tua kurrë mos

(Vijon në faqen 19)



## 1.

Lleshi mori sëpatën në dorë dhe filloi të zbrësë drejt Bredhit të Madh. Kishte nevojë të ishte vetëm, të mos dëgjonte asgjë, të ulej aty e të mendonte, të mendonte, të mendonte. Pas mendimeve do të vinte veprimi. Nuk shikonte ku i hidhte këmbët. Në tokë lloçaçet e formuara nga shiu, lëshonin shkëlqime të kuqërremta në ngjyrë myshku. Ai nuhati. Çdo gjë e njihhte prej erës. Ndjeu erën e rrëshirës së re, diku duhej të ishte prerë ndonjë pishë.

"Ah, e shkatërruan këtë pyll të bukur, e prishën! E pse, or të mallkuar i bini në qafë këtij vendi kaq të bukur?! Ç'ju ka bërë?!"

Ngadalësoi hapat, sikur t'i vinte keq të takohej tani shpejt me drurin e prerë që ndoshta do të ishte akoma duke derdhur lotë. I erdhi kaq keq sa s'thuhet. Ndaloj të dëgjonte ndonjë goditje sëpate apo rrëzimin e trungut, por asgjë. Vazhdoi më tej. Po i afrohej Bredhit të Madh. Përpara pa bagëtitë duke kullotur, pa edhe një grumbull degësh të shpërndara andej – këtej pa rregull, pa edhe cungun e prerë të pishës. Ngriti kokën lart. Vendi ishte bosh. Zemërimi iu rrit.

"Po ç'keni mor, që na shkatërroni kësaj! Këta drurët e shkretë s'ju kërkohet as të hanë e as të pinë! Ata janë streha e zogjve, e kafshëve dhe e... - ndaloj pak, u mendua, - ...e imja! Edhe këtë gëzim do të ma merrni?! Ah, pisha ime e gjorë, sa herë ke qenë mikja ime në netët e gjata! Sa gëzime e hidhërime kam ndarë me ju! A nuk erdha dhe u mbështeta në trungjet tuaja atë ditë kur pas varrosjes së Franit nuk mund t'i mbaja dot lotët kur shihja të tjerët duke vajtuar e kur po më këpusnin shpirtin lebetitë e nuses së re, po kur Frroku më pruri fjalët që ishin hapur për Martinen se po mëkatonte, a nuk erdha prapë këtu mes jush dhe fillova të mendoja se ç'duhej bërë?! Akoma e hapur ishte plaga e tim vëllai! Ah! Po kur më vranë Markun, po kur erdhën diversantët dhe fëmijët u fshehën këtu midis jush, ndërsa unë bëra pushkë; po kur Prendi dërgoi njeri të më kërkonte se i kishte shkuar Pandi në kullë për kooperativën, a nuk isha këtu, po kur..."

Befas sytë iu lëngëzuan. Ishte e dyta herë brenda asaj dite. Kaloi dorën mbi cungun e prerë të pishës dhe iu lag.

"Edhe pemët lotojnë, edhe ato kanë shpirt e ndiejnë dhimbje, - i shkoi ndërmend. Dhimbja e tij nuk ishte e vetme. Ja dhe pisha po lotonte, vajtonte fatin e saj. E mbështeti më mirë dorën mbi pishën trungprerë. Kaloi pak ashtu i kapitur dhe e ndjeu veten të poshtëruar. Duhej të vepronte. Kishte aq dëshirë të ngrihej, të ecte, të shkonte fluturimthi në shtëpinë që po ndërtohej dhe të prishte, të prishte, të prishte gëzimin e atyre njerëzve që po shkatërronin gëzimet e tij. Edhe ai kishte pasur shumë gëzime në jetën e tij dhe ato ia kishte dhënë kjo luginë. Po tani s'kishte më. Ato ia kishin prishur ata që ai i donte, që u kishte dhënë zemrën. Kishte gisht edhe ai komisar Pandi në këtë shkatërrim që po vinte ngadalë dhe e kishte shigjetuar me fjalë të ëmbla pale, dhe i kishte thënë se... Jo, jo, në qoftë se do të kishte edhe disa vjet të tjera për të jetuar, se i dukej vetja sikur kishte njëqind vjet mbi shpinë, ato po i shkurtoheshin. Kaloi dorën në fytyrë dhe mbi të i mbetën shenjat e lotëve të pishës.

"Pishë, o pishë e prerë, - tha ai, - ty po të drejtohem e askujt tjetër, o pishëza ime e gjorë! Ty të vranë tani, mua kanë filluar të më vrasin ngadalë. Jeta jote ishte e shkurtër, të prenë për të të përdorur diku, do t'u hysh në punë, do të mbash kulmin e shtëpisë, do të presin copa nga trupi yt dhe mbi to do të vendosin tjegullat, do të kesh një peshë të madhe ti që ishe mësuar të mbaje vetëm peshën tënde dhe të zogjve e gjinkallave në ditët e nxehta të korrikut e gushtit, mbaje këngën e tyre dhe unë i dëgjoja e çlodhesha këtu nën hijen tënde, i harroja brengat. Ata që të prenë e shpejtuan vdekjen tënde siç po shpejtojnë edhe timen. Si do të durosh o pishë trungprerë që të mbash mbi vete pesha të huaja?! Si do të mund të qëndrosh dot pa cicërimat e zogjve, pa shoqet pranë, pa blerimin, pa dritën jetëdhënëse të diellit?! Përgjigjmu, o pishë e gjymtuar! Unë nuk mund të jetoj dot, nuk mund të jetoj dot me njerëz të tjerë pranë! Nuk mund ta shoh si shkelet blerimi, se si në tokën e kafes së papirë

## ODHISE ÇERKEZI

## Vija e verdhë

(fragmente nga romani)

*Ky roman me temë nga trevat e Veriut është rrjedhojë e jetës dhe punës sime si mësues në vitet '70 në rrethin e Mirditës, duke filluar nga fshati Lufaj në kufi me Matin, Kurbneshin, Kaçinarin, Bulsharin e Oroshin, Dom Gjonin e Fanin, Rasfikun dhe trevat e tjera ku bëra shumë miq dhe vola një material shumë të pasur, ku u njoha me kanunin, me mikun e besën, me gjakmarrjen etj. Të gjitha këto gjejnë shtratin e tyre në këtë roman, por edhe në një seri tregimesh e novelash me një përfshirje kohore shekullin e njëzet. Njerëz dhe drama të mëdha njerëzore janë heronjtë e këtyre veprave.*

të vendosen njerëz, të vendosen gjakësit e mi, të shoh shkeljen e gjakut të Sutajve, të Franit!

"Më fol, o pishë e madhe, o cung i mjerë, më trego a nuk janë të padrejta të gjitha këto që më punuan mua dhe të punojnë ty?! Pse hesht, o pishë cungprerë, ty po të drejtohem! Ti ke parë shumë gjëra, ti e njeh mirë gjithë jetën time. Ç'është e ç'ka ndodhur në këtë botë ti e ke parë vetë dhe e ke të shkruar në mendjen tënde. Më thuaj, o pishë! Të lutem, më thuaj..."

"Si e durove sëpatën e tyre në trupin tënd?! A nuk të dhemb zemra kur ajo filloi të ta zhvoshkë trupin copa - copa?! Mua më dhemb, ja mu këtu (tregon kraharorin) më dhemb! Duhet të bëjmë diçka!... Eh, mos i mbaj mbi supet e tua tjegullat që do të të vendosin, shembe kulmin që të mos ketë jetë në atë shtëpi... Atje nuk duhet të... Më dëgjon, o pishë, rrëzoje kulmin, ler vetëm muret, muret e porsangritura që t'i rrahë shiu dhe era e të mbulohen nga myshku, të këndojë në to qyqja dhe të bëhen strehë e bufit, e lakuriqëve të natës, të mos ngrenë fole dallëndyshet... Si thua ti, o pishë?!... Unë të lutem, bëje këtë o pishë trungprerë... Bëje për mua dhe për veten tënde, për vuajtjet tona të përbashkëta!

Asnjë përgjigje nuk merr dhe zemërimi fillon e ngre krye përsëri brenda tij, kësaj radhe edhe ndaj kësaj pishë mosmirënjohëse, por mundohet ta zotërojë veten dhe i drejtohet me fjalë lajkatare:

"Unë e di, ti diçka bluan, ashtu siç bluj unë! Ti do të veprësh ashtu siç do të veproj edhe unë! Mua mos m'i fshih mendimet e tua, ne jemi tanët. Njeriu s'i thotë dot të gjitha dhe asnjëherë nuk duhen thënë me zë të lartë gjërat që nesër mund të të sjellin telashë! Ka gjëra që nuk i thuhet dot as evlatit tënd, por ti unë t'i them ashtu si do të m'i thuash edhe ti!..."

Delet kishin ikur tutje dhe ai nuk i shihte. U ngrit dhe eci nëpër vrugat e tyre.

## 2.

Frroku u nda nga prifti pasi i premtoi se sido që të ndodhte dhe çfarëdo që të bënte do ta bisedonin prapë në mbrëmje. U var tatëpjetë i gëzuar. Ishte nisur të shkojë nga Lleshi. Kur po i afrohej fshatit të ri, mendoi të kalojë vjedhurazi dhe të mos takohej me asnjëri, por këshëria për të parë më nga afër se ç'bëhej aty, nuk e la. Shkoi drejt atyre që punonin. Iu afrua mureve dhe filloi t'i prekë me dorë. Kur e pa se tërhoqi vëmendjen e të tjerëve, i përshëndeti:

-Puna mbarë dhe ju lumshin duart! Mur të mirë keni bërë!

-Mbarë paç! - ia kthyen përshëndetjen.

Frroku vështroi përreth me këshëri, s'pa asnjëri që t'i prishte opunë. Vetëm brigada e ndërtimit ishte aty, as Mëhilli nuk ishte. Më tej po hapeshin themele të reja.

-Po ata ç'bëjnë aty? - pyeti.

-Themele po hapin.

-E kush do të banojë në atë shtëpi?

-Fëmijët.

-Çfarë? Çfarë?

-Është kopshti dhe çerdhja.

-Aha!...

-Nuk do të na ndihmosh edhe ti, xha Frrok?

-ia bëri një i ri dhe i shkeli syrin shokut përbri.

-Patjetër, - ia ktheu dhe qeshi me djallëzi. -



Po ndonjë kurban në themele që të qëndrojnë muret, keni bërë?

Të tjerët ngritën kokat për një çast nga puna që bënin dhe e panë të habitur, pastaj panë njeri - tjetrin dhe qeshën.

-Kurban?!...

-Muret qëndrojnë edhe pa kurbane.

-Jo, jo, - tundi kokë e dorë njëkohësisht. -

Në kohën tonë kur ndërtonim ndonjë shtëpi, më përpara bënim ndonjë dash a diçka tjetër kurban në themele. Gjaku i forcon muret. Pastaj zakon ka qenë që në themele të varroseshin edhe kokat e ndonjë stërgjyshi të fisit. Vetëm atëherë fillonte ndërtimi i kullës se ndryshe muret nuk qëndronin. S'keni dëgjuar ju për kullën e Prengë Frrok Lleshit të Lulashëve që e ndërtoi kullën tre herë dhe të tre herët iu rrëzua se në themel të tyre nuk ishte bërë kurban. Vetëm kur u bë zakoni dhe u varrosën kokat, muret qëndruan dhe janë akoma edhe sot. Është ajo kulla atje në krah të Majës së Kërçollës, s'ka mbetur më asnjëri nga ajo familje.

Të tjerët dëgjonin me vëmendje, duke i hedhur njeri - tjetrit vështrime në të cilat përzihej habia dhe pyetja bashkë. Simoni mendoi ta ndërpresë njëherë, fjalët e Frrokut po e nxehnin, po e la. "Si tha Kadriu, ta lëmë gjarprin të nxjerrë këmbët", - mendoi.

-Po historinë e kullës së Gjonikajve, e dini?

Të tjerët ngritën supet.

-As ti, or Dedë, - iu drejtua pastaj një ustai të kaluar nga mosha, po tjetri nuk e ngriti kokën nga cigarja që kishte nisur të dredhë. - Edhe Gjonikajt vendosën të ngrenë një kullë të re. Filluan punën mirë e bukur, po ndodhi ajo që s'e mendonte asnjëri. Ditën ndërtonin muret, ndërsa kur shkoni në nesërmen në mëngjes i gjenin të rrëzuara, rrafsh me tokën i gjenin. Kjo punë disa ditë. Vunë edhe roje natën, por vinte mesnata dhe dilnin disa hije veshur gjithë me të bardha dhe i prishnin. Ata që ruanin, ato çaste e humbitnin gojën dhe nuk mund të lëviznin as këmbë, as dorë. Një natë njëra nga hijet foli: "Këto mure nuk do të qëndrojnë dhe në to do të derdhet gjak nga Gjonikajt!" Kaq tha dhe u zhduk. Të nesërmen filluan ta ndërtojnë përsëri murin e prishur. Kishin bërë goxa, kur prapë rrëzohet dhe zuri një nga fëmijët e Gjonikajve...

-Përralla! - nuk duroi më Simoni. - Me të tilla përralla gënjehen fëmijët në netët e dimrit.

Frroku e pa me përçmim. Nuk ia mbushte synë ai djalë i Pjetër Përndrekës, paçka se në fshat e mburrnin.

-Për ti le të jenë përralla, për ne që na i kanë thënë prindërit tanë e që i kemi parë me këta sy, janë të vërteta. Ju bëni si të doni, veçse - dhe këtu e zgjati më tepër zërin - të mos thoni se xha Frroku nuk na paralajmëroi!

Mori rrugën për në kullë, por ndaloj dhe shtoi:

-Kemi jetën ne pleqtë, prandaj dëgjojeni ndonjëherë fjalën tonë.

Si iku Frroku, filloi diskutimi mbi sa tha ai. Disa përkrashnin Simonin, po kishte edhe nga ata që i kishin futur në mendime sa dëgjuan. Me të dytët ishte edhe Ndoka. Diskutuan pak, por Simoni nisi punën, kështu që e lanë edhe të tjerët. Herë pas here i hidhte sytë nga Ndoka, i hidhte edhe nga kulla e Sutajve. Të djeshmen e kishin lënë për t'u takuar me Delinën. Ai e kishte pritur, ndërsa ajo as që ishte dukur. Megjithatë edhe shumë nuk e priti, se kishte punë e tjera.

"Do të më ketë pritur ajo, - mendoi. - Kushedi si do ta ketë bërë shiu.

Që kur erdhi në mëngjes, dhe kishte ardhur i pari, i hodhi sytë nga kulla, i pa të gjithë, por atë jo. Kjo e shqetësoi më tepër. Mendoi njëherë të shkonte deri atje, bile bëri edhe disa hapa.

"Budalla, - e qortoi pastaj veten. - Ku do të shkosh apo do që të prishësh punë!

Shqetësimi sa vente e i rritej, por e mbloodhi veten shpejt kur e pa të hynte në oborr. I hovi zemra, po u mundua ta përmbajë gëzimin që e pushtoi për të mos tradhtuar veten para të tjerëve që kishte përreth.

Edhe Delina gjatë gjithë kohës e kishte Simonin në sy. Ndiente një faj të lehtë që s'kishte pasur mundësi ta lajmëronte një natë më parë dhe kushedi sa do ta kishte pritur. Po ashtu ishte puna e saj dhe ai duhej ta kishte marrë me mend se ku ndodhej.

Mori rrugën për në Luadh. Lehonën dhe dy kërrthijtë i kishte lënë mirë, do të rrinte pak dhe afër mesditës do të shkonte përsëri t'i shikonte. E lodhur ishte, pothuajse s'kishte mbyllur sy gjithë natën aty te Brukajt, pot nuk i flitej. Të shikonte njëherë andej, ta takonte Simonin dhe pastaj kthehej e pushonte. U nis me Gjetën përdore. Kur pa që Simoni kishte ngritur kokën dhe vështronte nga ana e saj, i ngriti dorën për ta përshëndetur. Nuk e vuri re fare Frrokun që vinte përballë, por ai e kapi shenjën e saj dhe, kur iu afrua, i nguli një vështrim që vajzën e përcëlloi, por u qëndroi atyre syve.

"Do t'ia them edhe këtë Lleshit, - mendoi Frroku dhe kaloi pa e përshëndetur.

Sa iu afrua shtëpisë së re, Gjeta i shpëtoi nga duart Delinës dhe vrapoi të ngjitej në skelë. I zgjati duart Simonit, që e ngriti peshë dhe e vuri pranë vetes. Sytë e tyre u takuan dhe ata i buzëqeshën njeri - tjetrit.

-Delinë, shko na sill pak radion, - ia bëri Simoni dhe ajo u kthye e u nis për në kullë.

Me sy ndiqte Delinën, por nga mendja nuk i hiqej Frroku. Diçka deshtë të thoshte me ato fjalë ai, po çfarë?! Këtë s'mund ta gjente. Lëvizte duart vetvetiu dhe vriste e vriste mendjen. Edhe vështrimet që shkëmbyen Frroku me Ndokën i kishte kapur. Mos kishin gjë midis tyre ata?! Po mbrëmë atë s'e panë të shkonte në qelë. Mos i kishte thënë ashtu kot ato fjalë?! Mos po i binte kot në qafë?! Jo, jo, i ta pas një çasti vetes, nuk duhet të jetë njeri i mirë. Si i kishte thënë Delina: Kokë më kokë me Frrokun kishte qëndruar kohët e fundit, edhe natën para se të shkonte në qytet me të kishte qenë! S'është njeri i mirë ai, diçka po kurdis, duhet parë...

Delina e solli radion dhe ia zgjati. Ai e vendosi mbi mur dhe e hapi volumnin deri në fund. Pas disa këngëve spikeri lajmëroi orën dhjetë dhe filloi transmetimi i lajmeve. Të tjerët lanë punën dhe u afruan. U afrua edhe Ndoka, megjithëse nuk i pëlqenin të gjitha këto. "Gënjeshtër janë këto që thonë, - kishte thënë prifti dhe atij i pëlqente t'ia përsëriste vetes herë pas here ato fjalë. Po nuk bënte të ndahej se binte në sy për këq.

“Kooperativistët e F... po i bëjnë të gjitha shërbimet kulturës së misrit dhe zotimi i tyre është... Filloi puna për mbjelljet e vjeshtës... Kolektivi punonjësi i uzinës... Filloi prodhimi i disa pjesëve të këmbimit për traktorë që më parë importoheshin dhe kjo u arrit me punën këmbëngulëse të... Kolektivi i ndërmarrjes... e realizoi planin vjetor dy muaj e tetë ditë para afatit... Mirë paraqiten edhe ndërmarrjet...”

“Të rinjtë janë hedhur në aksione konkrete kundër zakoneve prapanike e fesë. Kështu të rinjtë e shkollës së mesme “R...” prishën një tyrbe të shenjtë ku për vite me radhë faleshin njerëzit. Në të gjetën kockat e një kali...”

“Vazhdojmë me lajmet e jashtme.

“Vendosmëri e punëtorëve grevistë të hekurudhave në SHBA... Shtojnë shpenzimet për armatime... Këto ditë në Vjenë u zhvillua një raund tjetër i pazarllëqeve mbi “pakësimin e trupave dhe armatimeve në Evropën Qendrore...”

Ndoka nuk dëgjonte më. Lajmi për fenë dhe aksionin e të rinjve, e kishte tronditur. As vetë nuk e kuptonte ç’ndiente atë çast. Ndjeu vështrimin e Simonit në fytyrë dhe u mundua të mos e japë veten, megjithëse edhe ishte për t’u tronditur. U mundua të buzëqeshë, por i doli një ngërdheshje e mjerë. Simonin nuk po ia hiqte sytë.

“Ç’t’i bëj dom Ndoci unë, pa do të ta kisha gjetur anën, mendoi dhe tashmë e kishte mbledhur veten plotësisht. – Po do të të vijë radha! Do të ta gjej anën me Lleshin unë...”

Biseda e gjallë që u ndez pas lajmeve, e shkëputi Ndokën nga mendimet e veta. Hapi veshët të dëgjojë më mirë, por vetë nuk mori pjesë në bisedë, sikur e kishte stepur ai vështrimin e Simonit.

“Njerëzit i faleshin një kali! Një kalë i shenjtë, - mendonte me vete Simonin, por këto fjalë i tha me zë dhe e dëgjuan të gjithë. – Paska qenë një kalë i shenjtë...”

Tha kështu dhe qeshi, ndërsa me vete të tjera gjëra mendonte.

Edhe Mëhilli i dëgjoji lajmet. Të tilla arritje e suksese e emocionojnë gjithmonë njeriun. Edhe ai u emocionua dhe në vesh iu duk se i erdhi një lajm tjetër i thënë nga e njëjta spikere: “Në rrethin M... u inaugurua fshati i ri Lezan. Brenda një kohe shumë të shkurtër, në luftë me gjithçka të vjetër që pengonte, u ndërtuan shumë shtëpi të reja, veprat social – kulturore...” Qeshi me këto mendime. “Ja, shtëpia e tij po hidhte shtat, pas saj do të ndërtoheshin të tjerat dhe brenda vitit i gjithë fshati. Sa gëzim do të ishte”. Ai vërtetë i gëzohej kësaj që po ndodhte. Vetëm kur kujtoi Lleshin dhe veprimin e tij të një dite më parë, kur i kaloi pranë dhe ndërsa ky i foli, ai ktheu kokën nga ana tjetër, gëzimi sikur iu platit pak. Të gjithë të Sutajve e aprovinin këtë, kishin ardhur në këtë vend, kishin dhënë ndonjë ndihmë për ndërtimin e shtëpisë, vetëm Lleshi... Po dhe ai do të mësohet, ndryshe s’ka si të bëhet... Mirë kishin bërë që s’e kishin bërë për fjalë mbushjen e themeleve. Lleshi duhej të kishte gisht në të...”

–Një ditë do të flitet në radio edhe për këto që ndërtojmë ne, - tha ai ngadalë, por që u dëgjua mirë.

–O burra, që kjo ditë të vijë sa më shpejt, - ia bëri një tjetër dhe përsëri nisi puna.

“Mos ardhhtë kurrë ajo ditë!” – mallkonte Ndoka dhe nuk e pa ku e vuri këmbën. Shkau dhe u rrëzua. Guri që mbante në dorë i shpëtoi dhe i goditi kërcirin e këmbës.

“O, o! – lëshoi një klithmë dhe e kapi me të dyja duart. Dy veta që i ndodheshin më afër e ngritën dhe e vendosën më tej, i ngritën pantallonat dhe u munduan t’i ndalojnë gjakun.

–T’i thërrasim Delinës, - tha njëri prej tyre. Ndoka u mundua ta ndalojë, por Delina ishte afuar vetë.pasi e pa plagën, nxitoi në shtëpi të merrte sa i duheshin për ta mjekuar. Ajo ishte mami, por edhe këtë gjë mund ta bënte. Sytë e Ndokës u takuan përsëri me ato të Simonit dhe iu duk se ai po e qesëndiste. Mbylli sytë më tepër nga kjo se sa nga dhimbja. Delina u kthye shpejt. Filloi të fashojë këmbën, të tjerët ikën njeri pas tjetrit në punët e tyre. Ndoka i buzëqeshi, ndoshta ishte e para herë që ai po buzëqeshte me të vërtetë. Kështu i gjeti Kadriu.

–Kujdes, ta bëjmë punën, po të mos vritemi ama! – ia bëri ai.

–Si është Lleshi, Delinë? – pyeti pastaj.

–Mirë, mirë, - ia bëri ajo dhe e pa në sy. Pastaj u ngrit dhe e ndoqi pas. – Nuk nxjerr fjalë nga goja, veç diçka bluan me vete. Si do të vejë puna me të...”

–Këto ditë do të vijë edhe Toma me ekipin e punëtorëve, - ia ktheu Kadriu dhe hoqi xhakëtën. U përzie edhe ia bashkë me të tjerët.

### 3.

“Mirë më dolën në shteg!” – mendonte Frroku rrugës për te Sutajt. Delinës nuk deshtë t’i fliste, megjithatë e pa ashtu rreptë dhe i dha të kuptojë se diçka kishte nuhatur ai, nuk ia shkonin dot nën rrogos atij. Kur iu afrua kullës, i ngadalësoi hapat si për të fituar kohë para se të takohet me Lleshin. Filloi të mendojë se si ta hapë bisedën. Në oborr ishte Mara që po merrej me pulat dhe një derr që e kishin të lidhur në kolibe. Frroku u afrua, e përshëndeti dhe pasi i hodhi një sy derrit, tha:

–E keni të mbarë sivjet, patjetër që do të nxjerrë njëqind okë mish e vjamë.

–Erdhi i mbarë, - ia ktheu Mara dhe e ftoi të ngjitet në kullë. Frroku nuk e pyeti për Lleshin, duke kujtuar se do të ishte brenda. Hyri në odë dhe u ul, priti Lleshin, por hyri Ija duke mermëritur:

“Në këtë qiell çdo krijesë ka yllin e vet. Delja, lopa, macja, miu, ujku, qengji, milingona, unë, ti, të gjithë kanë nga një yll që shkëlqen. Edhe Frani im kishte një yll. Të gjithë kanë nga një yll, përndryshe qiellin nuk do ta mbulonte ky shkëlqim dhe s’do të kishte kaq shumë yje. Qielli hambar me yje! Ha, ha, ha! Në këtë hambar është edhe ylli yt. Ja, shikoje. Ai shkëlqen fort. Edhe imi shkëlqen shumë, edhe i atij të mallkuarit Lleshit tim që s’i mori hakun yllit të Franit që u shua, shkëlqen shumë. Shiko si vallëzojnë yjet. Zihen midis tyre. Kështu ziheshin edhe atë natë para se të vritej ai. Shih, shi, një yll u këput! I kujt të jetë vallë?! Ishalla i atyre që vranë djalin! Ishalla, o Zot! Shih, shih ylli luhetat e lëkundet, do të këputet! Sikur të jetë ylli im! Sa mirë, do të vete pranë Franit dhe gjithë të mive! Sa mirë, sa mirë!”

–Nuk është yti, nanë Ije, nuk është! Do të jetë i atyre të mallkuarve! I atyre është patjetër! – i foli Frroku.

–Ja, ja erdhi, erdhi! – ia bëri Ija dhe hapi krahët për të përqafular dikë.

Frroku u ngrit, me plakën s’mund të bisedohej gjë. Në këmbë e piu edhe kafen.

–Nga Bredhi i Madh do të jetë, me berret, - iu përgjigj Mara dhe ai mori rrugën për atje.

Prendi ishte ngritur herët, leqë ai pothuajse gjithë natën nuk mbylli sytë nga gëzimi. E përcolli Delinën deri përtej vathës duke e falënderuar për kujdesin që kishte treguar për të renë e fëmijët. Flori të ka Lleshi, i tha.

–Po ç’bëra unë, lalë Prendi, ia ktheu e turpëruar Delina nga lëvdatat që i bënte.

–Bëre, bëre! Borxh ta kam! Po do ta shlyej në dasmën tënde. Po ç’bën akoma Lleshi, e?! Mirë, mirë, mos e ul kokën ashtu, do ta bisedoj me Lleshin unë, janë punë burrash këto!

–Ditën e mirë, - përshëndeti Delina dhe u mat të ikte.

–Prit, i thuaj Lleshit të më presë, të shkojmë bashkë andej nga Luadhi, se u turpërova fare unë...”

Kur mësoi nga Delina se Lleshit as që i flitej me gojë dhe se këtë të gjithë e kishte nga ato që po ndërtoheshin aty, Prendi u nxeh, shau, bile shau rëndë. Shau edhe Lleshin, edhe veten.

–Si, si, pa thuajma edhe njëherë! Nuk ka shkuar asnjëherë atje?! Edhe është ankuar?! Turp, për besë turp i madh!

Tundi kokën dhe u kthye i menduar në kullë. Të ndodhin gjithë ato gjëra dhe ai të mos ishte bërë i gjallë fare. Inat kishte me Lleshin, por më tepër me veten. Nuk i takonte Lleshit të kundërshtonte... Po matej të dilte, kur në oborr u dëgjuan zëra dhe lehja e qenit.

–A do miq, o i zoti i shtëpisë!

I foli qenit dhe doli të priste të ardhurit. Ishin njerëzit e nuses.

–Të na rrojnë! – u dha sihariqin pa u takuar mirë. – Dy çuna të bukur...”

(Vijon nga faqen 17)

e shkëlqsh!”Apo, edhe më qartë e bukur: “Guri i fortë në vend të vet.”Po, më mirë, le të kujtojmë sa shprehte Faik Konica te “Malli i Atdheut”:

“Duhet të jesh jashtë Shqipërisë e të jesh larg, për të kuptuar se ç’forcë e ç’bukuri të ëmbël ka kjo fjalë: Shqipëri.”

Gjithë ai arsenal i urtësisë gojore e letrare është shfrytëzuar me shumë zotësi në mbujtjen e dialogut të filmit “Pasaporta”. Shikuesit i mbeten në mendje, jo vetëm thëniet e anëve të Shkodrës e me tharmin e këndshëm të homorit shkodran, po edhe përmendja në ata dialogë e citimeve të vyera nga Atë Zef Pllumi. Në fakt, sikundër e kam përmendur edhe gjetiu, te libri “Rrno për me tregue” i Atë Zefit dhe në “Visaret e Kombit” e në botime të tjera, që kohët e fundit po ribotohen me kujdes nga Françeskanët, mund të gjenden tregime që janë si “minierë floriri” për krijuesit që marrin përsipër të tregojnë bëmat e mëdha dhe shpirtin bujar, besën e burrërinë e shqiptarëve.

“Pasaporta” është një film i kohës së re, një film i Shqipërisë së epokës së elektronikës dhe i mjeteve të komunikimit on-line dhe ato janë përdorur me shumë efekt në realizimin e filmit me një cilësi aq të lartë profesionale. Bota e madhe vjen e tëra në atë film dhe, për aq minuta sa zgjat shfaqja e tij, shikuesve iu duket se po bëjnë një udhëtim të pakundshoq në të gjithë kontinentin dhe, për një mrekulli, që mrekulli nuk është, por është një e vërtetë e madhe, gjithandej sot ka shqiptarë dhe vese e virtyte të shqiptarëve, që jepen të kapërthyerat e të gërshetuara aq liksht edhe në këtë film artistik, ashtu siç kanë qenë e janë në krejt përditshmërinë dhe ecurinë e popullit tonë në rrjedhë të kohërave.

Në film, duke pasur në zotërim mjete e elektronikës së sotme, na jepet, ndër të tjera, figura e një prej bosëve të kimit me përmasa të papërfytyrueshme më parë, si ajo që jep Alfred Trebicka, i cili, qysh prej këndeje Adriatikut, diku në një mjedis të rehatshëm e duke gjerbur me elegancë gotën e uiskit, me zërin e tij (me atë timbër të mahnitshëm e të bukur), i prin veprimi që duhet të kryejnë “çifti i sajuar”(Edoni dhe Vera). Ai i ndjek dhe i drejton ata në dyert e hyrje-daljeve të aeroporteve apo në pikat e kontrollit, që janë më të tmerrshme se rrathët e “Ferrit” të Dante Aligierit.

Në film, në interpretimin e Marjeta Ljarjes, edhe një herë, shikuesit kanë rastin të adhurojnë e të dëgjojnë sa madhërishtë e realizon ajo përgjërimitin e një nëne tipike shqiptare zemërplastë, që i lutet të birit të mos e marrë udhën e mërgimit, të mos e lërë kërcunë e të vetme te shtëpia.

Dhe, pikërisht duke qenë edhe një film i kohës sonë, një film i epokës së “pushtetit të katërt” apo i fuqisë së mediave, “Pasaporta” mbyllet dhe më një intervistë të gazetares Anila Hoxha, një prej zërave më të autoritetshme të gazetarisë shqiptare. Ashtu si në gjithë përditshmërinë e saj tashmë shumëvjeçare, zonja Anila Hoxha, edhe si personazh “ex-uffizio” i filmit “Pasaporta”, na solli po atë zonjë të fjalës së thënë qartë e bukur, po atë mjeshtrë të fjalës së shqiptuar qartë, thjeshtë dhe prerë e pikërisht ashtu si i përket një stili të lajmit zyrtar. Hera e mbarë e pruri që, mbas filmit, u pamë me Anilën, ish-studenten time, së cilës, ashtu si dikur **notën dhjetë** në lëndën e “Kulturës së gjuhës” nuk mund të mos i jepja edhe vlerësimet meritore për figurën e gazetares serioze e gjuhëshpatë që ajo përfaqëson.

Dhe, si qershia mbi tortë, natyrisht, në mbyllje të filmit nuk mund të mos ishte dhe Arbana Osmani, si gjithmonë në rolin e vet të patejkalueshëm, me hiret e shqiptimit të qartë e të bukur dhe me atë pamjen e saj që i shkon përshtat Eduartit si hardhia e rrushit të kuq në qandren e lartë e të fortë.

Dialogu dhe krejt ligjërimi i filmit “Pasaporta” është realizuar në gjuhën shqipe, po, duke pasur parasysh dhe interesimin e ndjekjen edhe në mjediset joshqipfolëse, është bërë edhe përkthimi në anglisht me të shkruar. Edhe në këtë anë duhet të vëmë re një vlerë të shtuar të filmit, që parasheh edhe të kuptuarit e filmit në diasporën shqiptare e arbëreshe, si dhe nga të huajt. Por, mbi të gjitha, duke i dhënë përparësinë e duhur interpretimit në gjuhën shqipe. Me fjalë të tjera: shqip e shqiptarisht për publikun shqipar e shqipfolës, anglisht për ta kuptuar edhe ata që nuk janë shqiptarë. Mjaf më me praktikën e mbrapshtë të disa veprimtarive që bëhen në Shqipëri, por flitet anglisht vetëm pse aty marrin pjesë edhe disa të huaj. Atyre duhet t’u bëhen të gjitha nderimet e duhura dhe, si pjesë e mikpritjes dhe e mirëpritjes, organizatorët duhet t’u sigurojnë përkthimin nga shqipja në gjuhën përkatëse. Ashtu si veprohet në të gjitha shtetet e vendet e qytetëruara.

Udhëtim të mbarë e pëlqyeshmëri filmit “Pasaporta” dhe suksese të tjera në vijim regjisorit Eduart Grishaj, me krenari të ligjshme se është një bir i denjë i Malësisë sonë të Madhe “Nderi i Kombit”, që po jep filma të bukur e me thekse të fuqishme atdhetare e kombëtare shqiptare.

Tiranë, 19 janar 2025



## RRENË ASHT MOLLA E ADAMIT

si një zonjë e trathtuar në të zeza, ikën nata  
i tmerron dritaret tue i pështye zi e zi në ikje  
unë e ti karrige druri, rrimë çele guri gojën  
ti qenia kravatëlidhur, flokëkrehur  
I ke shqye t' gjitha buzëqeshjet si letrat e dashnisë

provoj të flas, të të lus por të gjitha kordhat e zërit  
si kokrra breshëri më bien në dyscheme  
e nis e fshijë kujtesën me fshesën e troshave  
derisa ti ikë pa ofshamë dhe i pasy

një kollë e keqe s'paku të dëgjohej  
në këtë mort të dashnisë  
t'mos mbetem kafshata e vetme e vetmisë  
këtë natë që as shi s'bie as era s'troket dyerve t'mbyllura  
e fjalët si flokë shtrigash në fund t'pusit kanë ra

rrëshqas akullnajës së vetmisë si mes thikash  
molla e Evës para këmbëve më bie, rrotullohet  
rrenë është se e kafshoi Adami  
atë ditë ai kishte dhembje dhëmbësh  
tutje do ta ketë hedhur  
si na dashninë sot.

## TASH NDIHEN TË MARR TË GJITHË

Sa keq që vdiq i marri i qytetit  
hetonte udhët rrugicat  
me mëngjes u merrte erë si ndonjë bime aromatike  
i uronte ulëset e parkut ulej këmbëkryq  
në trotuarin e pafshirë shtronte bukën dhe  
ftonte qytetarët me zemërgjerësi  
me hap kali ecte qytetit se i dukej arenë kuajsh  
mbushej frikë si të binte në rrjetë merimangash  
klithte hera herës  
sa të lumtur ishin qytetarët që ai ishte ndryshe nga ta  
se atëherë dukeshin më të madhëruar lumturoheshin  
derisa ai vraponte pas fustaneve të vashave si pas fluturave  
të gjithë kanë veshur pikëllimin që vdiq i marri i qytetit  
ju ndihmonte të dukeshin paqësor të urtë

kur ai sot s' kalon më me lumturinë e çartur  
me lumturinë me fytyrë fëmije  
janë të pikëlluar dhe ndihen të marrë të gjithë

## NJERËZIT EDHE JANË TË ÇMENDUR

Njerëzit lexojnë Spinozën shetisin parqeve me Enkidun  
Tallen me vdekjen e Sokratit mureve antike ngulin sytë  
Si të dashurave mërzinë amforave të lashta ju fshijnë  
pluhurin  
Dashurohen në kokën e trupin e Afërditës të Herës i bëjnë  
dashnore  
Në muskujt e hedhësve të shtizave dashurohen  
E në ëndërr shohin statujen e Zeusit  
Të gjithë e mendojnë veten aktorë të Bylisit  
Leni krejt më mirë besoni se  
Janë të krisur në zemër i duan mëkatet i hymnizojnë  
Shumë vdesin të marrë e të evidentuar si të padijshëm  
Anipse i dinë gurutë i këndojnë lirikat popullore të dash-  
nisë  
Provojnë ta shtrydhin frikën ta ndrydhin ankthin  
Tërë jetën me gurin e shpresës nën gjuhë jetojnë  
Këndojnë urata udhëtimeve të gjata e vdesin të padi-  
jshëm  
Të mashtruar si fëmijët e kopshteve të cementë mbesin  
S'i përcjellin fluturimet e zogjve vdesin pa u bërë valë  
deti  
besoni janë edhe budallenj, vrasin mushkonja minj fëmijë  
vrasin gra me gjoksa t'bukur si koka e Lybotenit, këm-  
bëdrejta si lisat e Sharrit  
Njerëzit janë të çuditshëm askush s'ju bie n'fije janë edhe  
budallenj  
O sa budallenj të dashur janë disa nga ta

## AS KËTË VERË

As këtë verë nuk e mbolla bredhin  
Tek varri yt, nanë  
Ishte verë që kam ngrënë thonjtë



Dije Demiri-Frangu

Rrenë asht  
molla e  
Adamit

poezi

Deri në gjakosje të gishtave  
Si në filmat fantastik  
Më patën rënë qepallat për tokë  
U bënë gjethe çetinë që i barte era  
Disi u mbusha frikë për vete  
Si bocë baruti u bëra  
Po t' kallxoj  
As në Konferencën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e  
Grave  
Nuk shkova  
Duke pritur diçka që kisha nisur moti ta prisja  
E që s'kishte zë e që s' më jepte dritë

Këtë verë beso nanë, u fol për shumë vdekje të reja  
Të çuditshme si në romanet e Agata Kristit  
-nuk u kujtova hiç për ty  
E një gjumë i rëndë nuk më shkoqej ditë as natë

Pastaj, u zura keq me të dashurin  
Në kafenenë më të frekuentuar të qytetit,  
Në një vend pa drita  
E putha të dehurin e qytetit  
beso nga mëshira

Shumë ditë më iknin duke menduar  
Ta varja veten në një lis  
Apo në fijet e kujtesës

Nuk e vizitova varrin tënd  
Dhe nuk të mbolla lule rreth tij  
Këtë verë nanë  
Ka nis bota po më ngjan  
Në një varr të madh të tharë.

## GRATË

Grijnë, ziejnë  
Ziejnë e grijnë  
Tërë jetën qepë  
Patate mishra  
Në temperaturë të lartë  
Vetëm dashninë e ziejnë  
Ngadalë në zjarrin e zemrës  
E kurrë s' kryhet vala e saj

## LIDHUR ME BOMBA

Dita vjen si qen i rrahur për ngordhje  
Nga gjumi mes tajfunesh bombash  
E spiunësh  
S' bëhet gjumë në këtë shekull  
E të iket në një shekull tjetër s'ka mundësi  
Se edhe ata ishin të përgjakur, të sëmure me të vjella  
Me barkqitje me migrenë e ku të shkosh o njeri  
Lisa të mbjellë në dyshek gjymtyrët  
bëjnë hije të stërzgjatura ku mund t'mrizojë frika  
dritat e teknologjisë të gjelbra të kuqe të verdha  
sinjalizojnë se jam e lidhur me bomba,  
me tajfunë e me spiunë  
Edhe me shpirtin fikur kur jam  
Më mbajnë lidhur me dhembjen e dheut  
Me dhembjen e ujërave

E dita vjen e rrahur si për vdekje  
Nga gjumi mes tajfunesh bombash  
E spiunësh

## BOTA PËR UJË PI LOTËT E MARIA MAGDALENËS

Ishte zgjuar Juda atë mëngjes  
Pa pikë uji për t'i larë sytë e era frynte ranë  
Pa lule përreth për të freskuar mushkëritë  
Me gjithë muskujt e shpirtit ishte zgjuar rrëmbyeshëm  
E kishte gjuajtur si gur pështymën e tij nga dritarja  
Andej kah udha të qonte në Romë

Bënte lojën e puthjes e dizajnonte me qeshjen e thatë  
Zogjtë që fluturonin nëpër qiell me krimba në sqep i  
kërcënonte  
Atë ditë i dha puthjen në faqe Jezusit e  
Papandehur mbiu lebroza në fytyrën e njerëzisë  
Shëmnia u ngul në zemrat e sëmura shpalli mbretërinë e  
saj  
Lumenjtë nisën të rriten nga lotët e Magdalenës  
Morën ujë e ujë e ujë që me shekujt t' mos shternin  
Lotët e Magdalenës rrjedhin pafundësisht edhe sot  
Bota nuk e di që për ujë  
Nëpër gjithë këta shekuj pi lotët e saj

## NERONI SËRISH SHËTIT ROMËN

Neroni sërish shëtit Romën  
Urinon udhëve të botës e  
Me kapelën funerale të vënë anash mbi sy  
Shoqëruar me dy prostituta krahëve gajaset  
Shëtit e më vështron deri në palcë më sheh  
Bota ngopur me urrejtje gogësinë çdo çast  
Ndot ajrin me gogësimën e saj  
Kot mëngjeset provojnë të vjellin  
vrerin e ëndrrave të këqija  
Të shpëtojnë nga zjarri nga ndotja e thellë  
Nga shurra dhe pështyma e Neronit

## NDËRTESTAT E VJETRA

si kristale akulli hy me taka të reja  
ndërtimeve të lashta eci kujdesshëm  
nëpër atë botë mbushur tinguj të tharë muzike mbushur  
frikë që ngjajnë në mote të vështira në gropa të zeza  
në ëndrra të zhbëra në shekuj të grimcuar ngjajnë  
e kam pak frikë  
nga ballkonet e tyre vazhdimisht dikush kollitet e pështyn  
gjak kollë e egër kollë toke dëgjohej  
nga kati tretë dëgjohej Shekspiri  
si i numëron llojet e vrasjeve të tij  
e çdo çast mund të më bie ndonjë shpirt i vjetruar fytyrës  
të më grith si brejtës i arave  
ndonjë shpirt që ende flet për dashninë për luftën e  
Trojës  
mund t'piskas në moment frika ime  
si nënë e vështirë mund t'piskas  
në gjithë gjuhët e dheut  
e t' bien mbi lulet e trotuarit e mbi mua  
gjithë ata shekuj të marrë  
të sëmure me gjak me të vjella  
era kujtesë ju vie ndërtesave të vjetra

**HIJET E DRUNJËVE TË PRERË**

Ja e shoh sesi shtëpinë përsëri e kthjem në thertore,  
tutje hëna përbuzëse fshih atë dritëz që na bën pjesë  
të botës.  
Thyhen degët e drunjëve në të mbramin çast teksa  
plandosen mbi tokë,  
thyhen si të jenë eshtra të gishtave që sa vite rrënjët  
ujitëm,  
me gjithëfarë kuje e gëzimesh, me gjithëfarë lindjesh  
e gjamash,  
me gjithëfarë pyetjesh që bart era dhe ne fillonim nga  
fillimi.  
Tani, për të fundit herë, trupat fundosen në ajrin e  
rënduar  
me një "gëlldum" shurdhuese sikur dallgët e detit  
mbi fytyrën time shllihen dhe shtrënguar mbaj sytë.  
Hijet e tyre t'paana i ikën vdekjes  
dhe që atëherë prehen mbi fytyrat tona,  
e ne sorollatemi nëpër rrugë pa fjalë, pa gjeste,  
me gishta që na kërcasin...  
Asnjë nuk gëzohet se në rrënjët tona dikund sythi i ri  
po shpërthen.

**LETËRSIA, KJO SHPËTIMTARE**

Cili yllmbledhës na shtroi rrugën me dritë hëne i pari?  
Cili sytë e tij më pas i bëri rrugë të kthimit?  
Cili qe ai, që veten në flakë e flaku,  
zjarrin bëri shërues të njerëzimit?  
Për cilin këto shkronja qenë veç zëra të ngjirur  
që nga e largëta botë vinin për të rrëfyer,  
për të rrëfyer boshtin e botës vetë duke u vërtitur.  
Cili përdori historitë për tu njohur me veten,  
e cili nga vetja e vet dha pakuptimësinë e saj?  
Cili letërsinë e pati derë,  
derë për të hyrë në bark të nënës?  
Cili mendoi se botën mund t'ia bënte më të bukur asaj,  
se historitë do ta bënin "atë më me përvojë",  
dhe ai do të gjente përsëri kërhizën e prerë  
dhe do të shkonte atje kur ishte veç ide.  
Por, kjo kujtohet derisa letërsisë fillon e i përket.  
E veç yje ruan në xhep.

**ASGJË NUK LA SHENJË**

Gjithë çfarë kam,  
Zoti ma shkërmoq para syve,  
si një fëmijë kryeneç që  
gjithë ditën ndërton e thërrmon  
një kështjellë prej rëre...  
Zot,  
e kujtimet?  
Shfaqen si fotografi të zvetënuara në diell,  
tek-tuk ndonjë fytyrë akoma qesh.  
Sa u kam besuar!  
Ha ha sa kam besuar!  
Fuqinë me të cilën kam besuar!  
Kam kaluar male me një hap,  
kam notuar duke ëndërruar,  
kam fluturuar rrugëve  
duke u mbajtur për bishtit të së tashmes...  
A dëgjoj një këngë nga larg?  
Se atëherë çdo gjë erëmonte përreth nesh,  
por tani nuk ndjej asgjë... nuk flet kush,  
teksa unë ronitem  
nën zgërdheshjen e një fëmije,  
që dërrmon rërën e kështjellës nëpër duar...

**RUAJ PAK VDEKJE**

Ruaj pak vdekje kur t'i shoh ata sy,  
tingëllimën e mbrame kur ta dëgjoj atë të qeshur,  
mbyllur në brendinë e kupolës së qiellit  
sikur një mijë gota qelqi thyhen përnjëherë...  
aty pak vdekje fshih dhe ajo...

**NURIE EMRULLAI****Letërsia, kjo shpëtimtare***poezi*

Ruaj pak vdekje derisa pëshpëris të dua,  
që as ajrin përreth nuk e dridhin,  
vetëm të të shoh të patrazuar në djepin ku përkundesh...  
teksa engjujt t'i mëkojnë krahët mbi kurriz...  
se unë nuk lejoj asgjë të të afrohet,  
as hunda, as goja, as syri, as dora, as vetulla, as floku yt  
të mendojë që mund të jetë i vdekshëm... askujt të mos  
i shkojë në mendje.

E ruaj pak vdekje, veç pak edhe brenda vetes..  
Se dashuria do të shpërhapet veç pas kësaj jete,  
ajri do ta dridhë anë e më anë tokën  
duke rrokur tingujt njëri-tjetrit  
kur shiu do të sjellë shkronjat nga e para  
se në këtë jetë rrojtëm me pak vdekje...

**DRITËZ SË VAGULLT**

Dritëz e vagullt  
që përthith ashklat e imta të ditëve pa emër,  
pluhurin e sendeve të ndenjura në tra të shtëpisë.  
Që na jeton fëmijërinë e pajetuar,  
disqet e gjata me pyetjet e padurueshme,  
dhe gjithë përgjigjet e gënjeshtërtë.

Dritëz që rron në mua,  
që vagëllon dashurinë e mbledhur,  
që mbledh thërrimet e dritës që m'u mohua,  
fjalët që ndërrouan drejtim,  
ngatërrimin e smirës për mirësi,  
shtypjen e mbinjeriut...  
urinë e vulosur të fëmijërisë,  
përbuzjen e dorës që shtrëngon.

T'i ruash brenda vetes gjithë këto ndjesi  
dhe të kesh guxim të ecësh me kokën lart,  
edhe kur të tjerët brenda teje shohin veç një guralec  
të detit...  
a një llambë të thyer.

**DIMRA TË TRISHTUAR***Frederik Rreshpjes*

Tash e sa dimra  
një zog i trishtuar përplaset në dritare,  
që dikur një poet e ushqente në poezinë e tij.  
Çdo prag dimri ai rreh krahët  
para dritares sime  
si për të thënë  
nuk më kap as ti brenda poezisë,  
a ndoshta avitet për të thënë  
që vetmia është rreshpe që bie në zemrat e poetëve.  
Dhe kur ai ik,  
trëndafilat e lënguar mbulojnë parvazin.

**SI ZGJATET JETA?**

Jeta është shprishja e një trikoje  
që në një kënd i ka dalë një fije...  
Ajo fije zakonisht hiqet padashje  
dhe nyjet kapërcejnë pandal njëri-tjetrit  
dhe ajo fillon e shkurtohet,  
peri fillon e tërheq veten,  
derisa të kthehet në topt.

**ZOGU FËMIJË**

Është një zog  
që luhet prej teli në tel,  
fëmijërisht,  
pa menduar rrezikshmërinë e lartësive  
dhe rrotullohet në vetvete  
për të ngrohur trupin imcak  
që tashmë i duket i papërballeueshëm  
për peshën që ka,  
dhe hidhet tel më tel,  
në ditë të ftohta me borë,  
kërcimi i tij lë njolla gjaku.

Forca e përfytyrimit nuk është a priori si format e të menduarit tonë, por "a posteriori". Forca e përfytyrimit ka nevojë për kujtimin, që të kuptojë të tashmen, pa kujtimin për të shkuarën e tashmja do të ishte një ngjarje e pakuptimtë që del nga asgjëja dhe fundoset brenda asgjësë. Por meqenëse asnjë e tashme nuk përputhet plotësisht me të shkuarën, atëherë forca e përfytyrimit nuk shfaqet pa aftësinë për të krijuar asociacione midis ngjashmërive, pa këtë aftësi ajo nuk do të mësohej me të tashmen si dhe pa logjikën, e cila krijon vetëm vijimësinë e kohës përmes lidhjes së shkakut me pasojën. Nëse kujtimi, asociacioni dhe logjika janë pak a shumë veglat, me të cilat punon forca e përfytyrimit, atëherë asnjëra nga këto vegla nuk është e mundur pa forcën e përfytyrimit. Ato janë vetjake për forcën e përfytyrimit. Kujtimi, i cili transportohet në të tashmen nga forca e përfytyrimit, është një e kaluar e shndërruar nga forca e përfytyrimit, dhe jo vetëm ajo: Forca e përfytyrimit ruan brenda nesh vijimësinë e përjetimit pikërisht përmes logjikës së saj vetjake, por përfshin edhe të mundurën aq shumë sa që e mundura heq atë që ka ekzistuar – vërtetë. Nëse diçka do të kishte ekzistuar vetëm në mënyrë të mundshme, atëherë në kujtim ajo nganjëherë është më e rëndësishme sesa ajo që ishte e vërtetë, kështu që e mundshmeja në të kaluarën ngatërrohet shumë lehtësisht me atë që ishte e vërtetë. Jo vetëm ideologjia e shtrembëron historinë, edhe më shumë e shtrembëron forca e përfytyrimit. Nëse kujtimi është themeli, atëherë mundësia është arena e forcës së përfytyrimit. Kënaqësia e saj për tu tërbuar, ngadhënjën mbi detyrimin për të qenë i saktë. Por meqenëse forca e përfytyrimit nuk është drejtuar vetëm prapa, nga e kaluara, pra i përket kujtimin, por shpallur fuqinë e saj akoma më të madhe kundrejt së ardhmes, dhe meqenëse kjo ende si e pavërteta nuk është gjë tjetër veçse mundësia e kulluar dhe e mundshme mund të ketë kuptimin si gjithçka e dëshirueshme ashtu edhe si gjithçka e padëshirueshme, atëherë forca e përfytyrimit bie jashtëzakonisht lehtësisht në kundërshtim me veten, shpresa dhe frika janë njësoj të forta, dhe arrihet në një ndalim, prandaj edhe kjo që për ne është e sigurtë në të ardhmen, vdekja, luan shumë pak rol në ndërgjegjen tonë. Këtu jemi ballafaquar si asnjë kohë përpara nesh me të vdekurit, në fakt me fantazmat e tyre: filmat e vjetër për shembull, që shfaqen në televizor, janë plot me të vdekur. Shpeshherë llahtarise, kur shikoj aktorë që kanë luajtur në pjesët e mia dhe kanë vdekur prej kohësh, dhe në filma shfaqen skena masive, mendoj, kush jeton ende nga ata? Çaplioni del gjithmonë nga asgjëja, Merlini Monro, Hemfri Bogart, Klark Gebell, sa shpesh vijnë nga mbretëria e të vdekurve, jemi mësuar me fantazmat. Por edhe me ato të politikaneve. Hitleri bërtet sërish dhe tund dorën, Çerçilli bën shenjën e tij të v-së, Stalini shikon poshtë masat parakaluese. Ne largojmë vdekjen. Jetojmë sikur të ishim të pavdekshëm, megjithëse atë e takojmë gjithmonë.

Sjellja e tij kishte qenë si përherë, mua dhe gruas sime nuk na ra asgjë në sy, po festonim vitin e tridhjetënjë të martesës sonë, dhe u bë vonë, një mik kishte ardhur nga Gjermania, ai diskutonte për politikën, dhe unë rashë në mendime, jashtë në natën e butë të tetorit të dyja kafshët vinin rrotull ose qëndronin shtrirë, qenujku plak, i cili ishte plogështuar tashmë, dhe bushtra e re, njëmbëdhjetë muajshe. Qeni hyri brenda vetëm një herë dhe vulli ujë, jo shumë, gruaja ime fshiu dyshtemë prej guri, tha "por, por, e po çfarë po bën", nuk u shqetësua më shumë, mbyllëm dyert rrëshqitëse në taracë, mora pjesë edhe në diskutim, hapa një shishe të re vere. Më vonë dëgjova një ose dy herë bushtrën të kuiste shkurt, pastaj ra sërish qetësi, dhe kur mysafiri ishte larguar u futëm brenda në shtëpi në agun e dritës dhe u ngjitëm lart në dhomën e gjumit, vura re se në kafazin e shkallëve ishte vetëm bushtra në strofkën e saj. Zbrita poshtë në kuzhinë dhe në kopësht, pastaj dola në rrugë, edhe këtu nuk mund ta gjeja, u ngjita në atelienë time, në dhomën time të punës, zbrita sërish në shtëpizën në kopësht, ku kishim biseduar natën, asgjë, kontrollova në tërë shtëpizën në kopshët, derisa, si rastësisht, pashë diçka të ndritur midis gjetheve të një shkurreje pranë taracës. Qeni kishte mihur një gropë dhe qëndronte brenda saj i ngordhur, ai ishte futur vetë në dhe. Lajmërova gruan time, e cila ishte shtrirë tashmë në krevat. U ngrit doli e veshur me një robdëshambër në mëngjesin e përhimtë, e ndoqa. Në qiell mund të shikoje ende disa yje të ndritur, mbi liqen nderej një shirit i bardhë mjegulle. Gruaja ime u ul në gjunjë pranë qenit. I vuri përsipër një mbulesë ngjyrë të gjelbër të errët, sikur të kishte frikë se ai mund të ngrinte. Ai e kishte ruajtur atë gjithnjë me besnikëri të veçantë; një natë kur po e kaloja duke shkruar, ai ishte shtrirë përpara shtratit të saj, aty nga mëngjesi hyra në dhomën time të gjumit, e pashë të ngrihej e të kalonte përmes derës së veshur me tapiceri, erdhi drejt meje duke ecur ngadalë nëpërmjet derës së dhomës sime të gjumit për në strofkën e vet. Megjithatë ai ishte një qenujk tejet i fuqishëm dhe vetëm vitet e fundit ishte bërë i plogësht. Mora në telefon Hans Lihtin, të zotin e hotelit "Rocher", për një çerek ore mbërriti te ne. Ime shoqe u ngrit, i hoqi mbulesën, ndërkaq mjegulla nga liqeni i ishte ngjitur malit, mëngjesi ishte vagëlluar e kthyer në gri dhe sërish kishte perënduar. Lihti ngjiti shkallët duke mbajtur kufomën e rëndë. E futëm në bagazh dhe udhëtuam në një mëngjes, i cili, sa më lart


# Friedrich Dürrenmatt

## Takime

Përktheu nga gjermanishtja  
Dr. Elda GJANA-BORIÇI

Romancieri, dramaturgu dhe piktori zviceran Fridrih Dyrrenmat ka lindur më 5 janar 1921 në qytetin Konolfingen të kantonit të Bernës. Në vitin 1946 mbaroi studimet për filozofi, për shkencat e natyrës dhe për gjermanistikë në universitetet e Bernës dhe të Cyrihut. Në vitin 1956 u bë shumë i njohur, si në Zvicër ashtu edhe jashtë saj, me komedinë "Vizita e zonjës plakë". Veprat e Dyrrenmatit në prozë kanë të njëjtën famë botërore si edhe veprat e tij dramatike. Duke përdorur ironinë, satirën, hulumtimet në jetën e përditshme dhe fantazinë, ai, sikurse shprehet kritika, "skalit kryevepra sa të jashtëzakonshme aq edhe interesante dhe është bërë i famshëm si shkrimtar antikformist". Me talentin e tij, Fridrih Dyrrenmati është quajtur njëzëri si mjeshtër i prozës gjermane bashkëkohore dhe, duke nisur që nga viti 1948 e deri sa vdiq, më 14 dhjetor 1990, është vlerësuar lart me çmime të shumta letrare e me tituj nderi.

ngjiteshim, aq më shumë prarohej. Unë ngisja makinën, pranë meje Lihti, i heshtur, i vrazhdë, me dinjitet. Në Montmolin, në një fshatth të vogël të kantonit të Jurës doli dielli. Po mundoheshim të gjenim punishten e rrjepjes së lëkurëve. Zgjati një copë herë derisa përbalë nesh erdhi dikush, të cilin mund ta pyesnim. Më në fund rrugën e morëm me mend vagëllimthi. Mbërritëm në një rrafshnaltë, pas saj ngrihej një kreshhtë mali e pyllëzuar e errët. Duhet të pyesnim sërish te një shtëpizë roje hekurudhe, pastaj ecëm drejt pyllit, në fundin e të cilit gjetëm punishten e lëkurërrjepësit, ishte gjysmë kantier fabrike e gjysmë kasolle, me një skarpatë të madhe. Ndriçimi i diellit ishte verbues, gjithçka dukej si një skenë tejet e ndriçuar, pylli si një kulisë. I ramë borisë, ecëm rreth kantierit. Më në fund u afrua duke çaluar një burrë, i përgjumur, turivarur, ne nuk e dinim se nga kishte prejardhjen në të vërtetë. Sollëm një qen, i thamë. Na tregoi i heshtur skarpatën, u largua duke çaluar sërish, u zhduk diku. Lihti e



Friedrich Dürrenmatt (Autoportret)

hapi bagazhin dhe e ngriti qenin mbi skarpatë. Tanimë ai qëndronte i shtrirë aty, një kafshë e madhe e zezë, pjesa e poshtme e trupit dhe ajo e bishtit ishin të bardha, këmbët ngjyrë okër, të dyja njollat në ballë dhe në të dyja anët e noçkës kishin ngjyrë të njëjtë. Qeni qëndronte i shtrirë aty, siç kish qëndruar shpeshherë në gjumë, por mungonte diçka dhe pamjen e bënte të tmerrshme. Brenda meje depërtoi një habi e pamasë, për një çast, i cili u duk se zgjati përjetësisht, pikërisht një çast vdekjeje – edhe në çastet shumë më fisnike, as kur kisha parë prindërit e mi të vdekur nuk e kisha këtë ndjenjë, këtë ndërprerje të papritur të kohës –, gjithashtu nuk e di se përse e kam këtë ndjenjë në këtë punishtë të shkretëtë lëkurërrjepësi dhe qysh atëherë jo më, as kur pashë Varlinin e vdekur, tri javë më vonë. U ulëm në kuzhinë te gruaja e tij. Diku në shtëpi kuiste qeni i tij. Një mjek më çoi te dhoma e vdekjes. Ai ishte i shtrirë në arkivol. Mjeku i hoqi çarçafin. Një krijesë e egër po më vështronte ngultas, goja e çapëlyer, sytë e futur në zgavrat e errëta. Dukej, sikur jeta, e ngrirë në të tashmen e vdekjes, po përqshte krijesën. Pastaj diçka u ngjesh midis këmbëve të mia, u zhduk në errësirën e dhomës, ishte qeni i tij. Ndoshta prandaj një javë më vonë në "Rocher" deri natën vonë nga kujtesa kam skicuar një vizatim të kësaj kufome të papërmbajtshme dhe vizatimin e fundit e pikturova me kafënë që po pija. E ndjeva që në kujtimin tim midis asaj dhe meje qeni u shtri si simbol i vetë vdekjes mbi skarpatën e punishtes së lëkurërrjepësit, dhe tani ai ruan gruan time të vdekur, por ai ishte qeni i saj. Në dhomën e saj kisha hyrë nëpërmjet derës së veshur me tapiceri, sepse mendova që ajo po flinte – e kisha dëgjuar të merrte ende frymë qetësisht – dhe doja të shuaja qiririn, që ajo e kish lënë të ndezur. E gjeta gruan time gjysmë të ulur në shtrat, të rrëzuar anash, me sytë e mbyllur dhe fytyrën paqësore. Nuk isha i shqetësuar. Mendova se mos i kish rënë të fikët, e kisha gjetur shpesh kështu. Tensioni i saj i gjakut ishte i ulët, dhe herë pas here ajo kishte simptoma të sheqerit të ulët, dhe tani kish patur një grip të rëndë, edhe pardje e kishte patur temperaturën mbi tridhjetëenëntë gardë, ndërkohë që diskutoja me dy dramaturgë të teatrit mbi Achterloo. Ia mbështeta këmbët lart, kokën poshtë, ia masazhova, telefonova mjekun tim në Bernë, i cili më dha këshilla, i bëra sërish masazh, e godita në faqe, trupi i saj ishte i nxehtë, edhe kur i telefonova një mjeku në Neuchatel, dhe kur ai mbërriti, nuk isha shumë i shqetësuar. – Regardez doctor, i thashë, – elle est comme morte. – Elle n'est pas comme morte, u përgjig ai pasi i hodhi një vështrim të shkurtër gruas sime. – Elle est morte. Pastaj e vizitova me kujdes. I rashë rreth e rrotull dhomës së gjumit dhe nuk po e besoja. Mjeku heshti, i erdhi keq që duhej të konstatonte vdekjen. Shkuam në dhomën ngjitur, mjeku kishte edhe disa pyetje, mbushi një formular, shfletoi një fletore që e kishte sjellë me vete, tha se po kërkonte emërtimin zyrtar, një emër të vdekjes – edhe vdekjet kanë emrin e tyre –, dhe kur mjeku ishte larguar, e telefonova edhe disa herë mjekun tim në Bernë, nëse gruaja ime nuk kishte vdekur klinikisht. E preka sërish. Ajo u ftoh më shumë, por jo aq shumë sa ç'e kisha përfytyruar. Por nuk isha trembur. Ajo që kish ngjarë, kishte ndodhur midis dy njerëzve. Me gjithë pikëllimin e natyrshëm mu duk sikur gruaja ime donte të më inatoste, sikur të më kishte luajtur një rreng, i cili kishte shkuar shumë larg kundër qëllimit të saj. Pastaj e admirova sërish, sepse arriti të vdiste shumë pa dhembje, një "vdekje sekondash", siç më kishte shpjeguar mjeku. Jo se mungonte frika, sidomos ditën tjetër, në mes të janarit, një diell që shkëlqente rreth mesditës, kur gruaja ime ishte e shtrirë në arkivol, kur krahët e saj kishin mbetur të ngrira në ajër. Duhet t'i ngjeshje brenda në arkivol. Për të kuptuar se gruaja ime kishte vdekur, ndodhi diçka groteske: Të dy burrat e zyrës së varrimit, një i shëndoshë trupmadh dhe një trupvogël i dobët, sikur kishin dalë nga një film i vjetër, duhet të mendoja për të shëndoshin dhe idiotin. Ata po mundoheshin ta zbrisnin arkivolin poshtë në kafazin e shkallëve, ai herë qëndronte mbi kokë, herë mbi këmbë, por e gjithë kjo i përkiste botës mizore midis njerëzve. Edhe ajo që ndodhi ishte pa pikëllim, një jetë kishte mbaruar, dhe e vdekura po hynte atje brenda, atje ku ai, që mbetej mbrapa, do të vihej edhe një herë në radhë. U përmbush një rregull. Por vetëm në dukje. Nga jashtë. Nga brenda: unë lëviza në pavërtetësi. Nuk u çlirova nga përfytyrimi, gruaja ime do të largohet me shpejtësinë e dritës prej meje, me treqindmijë kilometra në sekondë, tetëmbëdhjetë milionë kilometra në minutë, më shumë se njëmijë milion në sekondë, por ajo nuk u largua vetëm prej meje, edhe unë u largova nga vetja ime, ramë të dy me shpejtësinë e dritës, u rrëzuam poshtë së bashku në kujtim, dhe pastaj isha unë përsëri, që u largova, i flakur nga stuhia e kohës. U sula përpara, drejt së ardhmes, në vend që ajo të turrej drejt meje. Ajo që mbeti ishte kujtim i kristalizuar: një grua dhe një burrë, të cilët dikur ishin dashuruar dhe që tanimë ishin e kaluara. Por prej kohësh e kam shmangur atë që nuk mund të tregohet, ndjenjat nuk mund të përshkruhen, vdekja mund të tregohet vetëm nga jashtë dhe paraqitet vetëm nga jashtë, qoftë si re e largët e ngjashme me karafilët me petale të ngrëna, në yllësinë e demit, mbetja e një dielli, qoftë si copa të thyera të bardha vazoje prej balte në një thes plastik, përmbajtja e një urne, qoftë si një qen i ngordhur mbi skarpatën e një punishteje të mënjeluar lëkurërrjepësi.

Si dëgjuat për herë të parë mbi vjedhjen e Mona Lizës nga Vincent Peruggia?

Po lexoja një pamflet lidhur me historinë e muzeut të Luvrit dhe aty, në një fjali, ishte përmendur, por mbeti brenda meje dhe më mbërtheu imagjinatën: ideja se dikush kishte vjedhur *Mona Lizën* pikërisht nga brenda muzeut!

A mendoni se interpretimi juaj i ngjarjeve mund të jetë i vërtetë?

U bazova aq sa munda në faktet, artikujt e gazetave mbi vjedhjen dhe historianët e artit që kishin teori të ndryshme, por kur vjen puna te romani, ajo që më pëlqen më shumë është të shpik histori dhe skenarë që mund të kenë ndodhur.

Luke dhe Smith-i kanë një partneritet jo të zakonshëm. A kishte diçka të veçantë që frymëzoi besimin e kujdesshëm dhe sigurinë midis tyre?

Së pari, marrëdhëniet e tyre bazohen në nevojë; ata nuk mund të arrijnë të vetëm atë që duan. Pas një farë kohe ata fillojnë të respektojnë inteligjencën dhe përkushtimin e njëri-tjetrit. Kam menduar shumë mbi këta dy burra, se si ata erdhën nga mjedise të ashpra dhe duhej të krijonin vetveten, të bëheshin njerëz të rinj, një diçka që shumë prej nesh e bëjmë që të ecim përpara, disa herë edhe për të mbijetuar. E pashë këtë si një lidhje të mundshme midis tyre sepse ata shihnin diçka nga vetja në personin tjetër. Për mua kjo është një nga cilësitë më të rëndësishme të qenies njerëzore: aftësia për t'u simpatizuar me të tjerët.

Ju vetë jeni artist dhe replikator. Si ndikoi kjo përvojë në dhënien formë të këtij libri?

Duke qenë se kam shkruar në shkollë arti dhe vërtetë jam piktor, kjo më ndihmoi që të kuptoja Luke-n dhe dëshirat e tij, po ashtu edhe ato të falsifikuesit të artit në këtë libër, Yves Chaudron.

Kam vizatuar kopje të veprave të njohura artistike për koleksionues të artit, për më shumë se dy dekada. Megjithatë unë nuk jam përpjekur kurrë që t'i kaloj ato si origjinale ose të spekuloj me to. Unë bëj ç'është e mundur që të krijoj kopje të sakta të tyre ndërkohë që u qëndrojnë strikt rregullave ligjore lidhur me kopjimin e veprave të artit: unë ndryshoj madhësinë apo mjedisin, përdor mjete artistike bashkëkohore që mund të zbulohen nga një shqyrtim i imët shkencor dhe, së fundi, unë gjithnjë nënshkruaj emrin TIM nga mbrapa. Duke prodhuar vepra "të rreme" kjo më ka dhënë një pasqyrë të jashtëzakonshme mbi botën e brendshme të falsifikimit të artit, se si, në një farë mënyre ti futesh nën lëkurën e artistit punën e të cilit ti po kopjon dhe sa emocionuese është që ta kesh këtë pikturë të mbaruar që duket plotësisht si ajo e të famshmit Picasso apo Manet, por që e ke bërë ti.

Kur vajza ime ishte rreth dhjetë vjeçe, ajo më pyeti pse nuk i shisja riprodhimet e mia si origjinale. Unë i shpjegova pse ishte e jashtëligjshme të kopjoje veprat e artit të të tjerëve dhe t'i shisje ato si veprat e tua. Ajo e kuptoi por akoma mendonte se unë duhej të përpiqesha të shisja kopjet e mia si vepra origjinale.

Cilat janë keqkuptimet e zakonshme lidhur me falsifikimin dhe kopjimin e kryeveprave të artit?

Besoj se shumica e njerëzve mendojnë se falsifikimet e veprave të artit mund të zbulohen lehtë, por kjo nuk është e vërtetë. Shumë falsifikues i shpëtojnë zbulimit për dekada të tëra duke mashtruar muzetë, shtëpitë e ankandit dhe ekspertët. Përfundimisht ata bëjnë një gabim (si kur përdorin aksidentalisht një pigment që nuk ishte zbuluar disa vite *pasi* ishte prodhuar piktura që po falsifikojnë), dhe kjo është e gjitha — ata kapen. Por ka plot falsifikime në koleksionet e mirënjohura të artit dhe në muze kudo në botë që presin të zbulohen.

Si i ndërtoni personazhet e juaja? A ka ndonjë nga shokët apo të njohurit tuaj që kanë përfunduar në faqet e librave që shkruani?

Për mua, personazhet vijnë në jetë në faqet e librit. E kam një ide lidhur me personazhet por akoma nuk e di realisht se cilët janë ata derisa filloj të shkruaj për ta. Pas kësaj më duhet të mendoj se si ata duken, si flasin, çfarë i motivon ata, etj.. Dhe ata ndryshojnë vazhdimisht. Unë gjithnjë rilevoj dhe mendoj për ta. *Kështu pra nuk do ta thosha kurrë këtë*. Disa nga shokët e mi, me atributet e tyre, futen fshehurazi, por në shumicën e herëve, personazhet e mi bëhen vetvetja e tyre dhe unë prirem të

# Jonathan Santlofer

## Misteri i fundit i Mona Lizës

Përktheu Vladimir Bica

*Nga autori i njohur për romanet kriminalistike dhe artisti i vlerësuar, Jonathan Santlofer, vjen një rrëfim magjepsës mbi vjedhjen e Mona Lizës në vitin 1911 nga Luvri, falsifikimet që pasuan dhe të fshehtat e botës së sotme të artit.*

**Gusht, 1911:** *Mona Lisa është vjedhur nga Vincent Peruggia. Saktësisht çfarë ndodh në dy vitet përpara rikthimit të saj mbetet një mister. Ekzistojnë shumë kopje të Mona Lizës, dhe shumë historianë pyesin veten nëse piktura që është kthyer në Luvër është e vërtetë apo falsifikim, ndërruar në vitin 1911.*

**Ditë e sotme:** *Profesori i artit, Luce Perrone, kërkon të zbulojë të vërtetën për paraardhësin e tij të famshëm, Peruggia. Kërkimi i tij tërheq një detektiv të Interpol-it me një mision për të përmbushur dhe një grua të panjohur, por që ofron ndihmë në mënyrë të çuditshme. Shpejt, Luce zhytet në botën e artit dhe të falsifikimeve, një terren i obsesionit dhe rrezikut.*

mendoj mbi ta si njerëz të vërtetë, që ekzistojnë vërtetë. Ndoshta ndonjëri ka ndonjë copëz prej meje meqenëse unë jam ai që i krijon.

Me cilin nga personazhet jeni më i lidhur? A keni ndonjë prej tyre më të parapëlqyer, për të cilin shkruani?

Në këtë libër, më i afërt jam me Luke-n. Ai është më i ri, më i gjatë, më i hijshëm, më i zgjuar dhe më i talentuar se mua. Megjithatë, për cilindo që shkruaj, në

atë moment ai është më i parapëlqyeri. Mua më pëlqen të shkruaj edhe për djemtë e këqij dhe psikopatët, sepse unë gjithnjë përpiqem të shoh se ç'i bën ata të shpërthejnë. Njerëzit e tmerrshëm janë kaq argëtues në libër sa edhe të tmerrshëm në jetën reale!

Smith-i i përshkruan koleksionuesit privat si hajdutë që e mbajnë artin larg nga pjesa tjetër e botës. A jeni dakord me të?

Jo. Kjo kishte kuptim për personazhin e një punonjësi të INTERPOL-it, që të mendonte kështu, por shumica e koleksionistëve të artit që njoh unë janë njerëz që e dashurojnë artin dhe duan ta mbushin jetën e tyre me të. Nëse do të kisha mundësi do të bëja të njëjtën gjë.

Si mund të shpërndahet arti në mënyrë më të drejtë?

Muzetë janë vendi më i mirë, po ashtu magazinat publike që kujdesen për kryeveprat e vogla e të mëdha. Unë sapo isha në *Metropolitan Museum of Art* të Nju Jorkut dhe ky është një nga vendet më të bukura të botës. Ti mund të harxhosh ditë të tëra duke imagjinuar vetveten veshur me një armaturë të lashtë ose të ecësh rrotull Tempullit Egjiptian të Dendurit ose të shohësh pikturat e impresionistëve — çfarëdolloj arti që ty të pëlqen është atje.



Por ka gjithfarë "artesh". Ti mund të kornizosh një bllok me pulla (ashtu siç bëra unë me pullën e fundit të Marvin Gaye), ta vendosësh në mur dhe do të duket mjaft bukur, me koston e vetëm pullave.

Vëzhgimet e shumta e bëjnë komplotin nervozues dhe sidomos kur kërkimet e Luke-s marrin kohë në vazhdimësinë e tyre. Si e balanconi befasinë, suspansën me padurimin në ritmin tuaj?

Padurimi i një personazhi nuk ka të bëjë me ritmin e librit, i cili është një gjë e veçantë që ti, autori, e kontrollon. Lexuesi mendon, *Nxito Luke*, sepse ai është para tij dhe i shqetësuar, dhe kjo është që unë dua sepse kjo e rrit padurimin.

A keni ndonjë këshillë për shkrimtarët që aspirojnë, veçanërisht për ata që janë të interesuar në histori dhe thriller?

Unë them gjithnjë, *lexo*. Gjërat të vijnë kur ti lexon dhe nuk ka si ndodhë ndryshe. Plus, ti mëson nga shkrimtarët e tjerë. Nëse do të shkruash një thriller lexo sa më shumë prej tyre dhe zërbërthe disa që të shohësh se si autori e ka konstruktuar një komplot. E njëjta gjë me romanet historike. Inspirimi im fillestar për të shkruar këtë libër erdhi nga dy romane, *Possession* dhe *The French Lieutenant's Woman*. Natyrisht që unë lexoj kaq shumë romane me krime sa që një pjesë e trurit tim vazhdimisht mendon, *Ku është misteri?* Dhe në cilindo libër mundohem të mësoj: *Cili është "motori" që lëviz këtë histori?*



*Karikaturë nga Arben Mexsi*

